

## **Status Raport**

### **Zbatimi i Planit veprues për përmirësim e gjendjes së romëve dhe sintive në rajonin e OSBE-së**

**Giorgia Demarchi**

**Shkup, dhjetor 2010**

Ky raport është përpiluar nga eksperti ndërkombëtar, Giorgia Demarchi, në bashkëpunim të ngushtë me Ramadan Berat, Asistent për çështje romë në Misionin mbikqyrës të OSBE-së në Shkup dhe me ndihmën e Znj. Mabela Kamberi nga Ministria për punë dhe politikë sociale.

Eksperti ju shpreh falemnderim të dy institucioneve për përkrahjen e tyre të vlefshme, në veçanti ministrit Nexhdet Mustafa, Koordinator kombëtar i Dekadës dhe Strategjisë së romëve.

Status raporti është përkrahur nga Ministria për punë dhe politikë sociale dhe është financuar nga Misioni mbikqyrës i OSBE-së në Shkup.

## **PËRMBAJTJE**

<b>Mirënjohje</b> .....	1
<b>Shkurtesa</b> .....	4
<b>Përmbledhje</b> .....	5
<b>I. Hyrje</b> .....	6
Plani veprues për përmirësimin e gjendjes së romëve dhe sintive në rajonin e OSBE-së (2003) .....	6
Status raporti për zbatimin e ‘Planit veprues për përmirësimin e gjendjes së romëve dhe sintive në rajonin e OSBE-së në shtetin nikoqir të Misionit mbikqyrës të OSBE-së në Shkup .....	7
Metodologjia.....	8
<b>II. Ku gjendet shteti tani?</b> .....	9
Progresi që nga miratimi i Planit veprues të OSBE-së .....	9
Gjendja aktuale e zbatimit .....	12
Tejkalimi i racizmit dhe diskriminacionit .....	12
Legjislacioni dhe zbatimi i ligjit .....	12
Policia.....	19
Mediat.....	22
Trajtimi i çështjeve socio-ekonomike .....	24
Kushtet banuese dhe jetësore .....	24
Problemet e papunësisë dhe ato ekonomike .....	26
Kujdesi shëndetësor .....	29
Përmirësimi i qasjes në arsim .....	33
Përmirësimi i pjesëmarrjes në jetën publike dhe politike ...	45
Romët në krizë dhe situata pas krizash .....	51
<b>III. Mësimet e mësuara dhe prioritetet për të ardhmen</b> .....	54
Çfarë e ka ndihmuar dhe çfarë e ka penguar zbatimin .....	54
Si të vazhdohet më tej.....	58
<b>IV. Konkluzione dhe rekomandime</b> .....	58
Konkluzione.....	58
Rekomandime.....	60
<b>Referenca</b> .....	70

## MIRËNJOHJE

Në emër të ekspertit ndërkombëtar, Znjsh. Giorgia Demarchi, Misioni mbikqyrës i OSBE-së në Shkup dhe Ministria për punë dhe politikë sociale, ju shprehin falemnderim personave vijues për përkrahjen, këshillimin dhe komentet e tyre gjatë përpilimit të këtij raporti specifik për shtetin, lidhur me zbatimin e Planit veprues për përmirësimin e gjendjes së romëve dhe sintive në rajonin e OSBE-së:

### Institucione kombëtare

MINISTËR PA RESOR:	Ministri Mustafa, Nexhdet
MINISTRIA PËR PUNË DHE POLITIKË SOCIALE:	Ministri Bajrami, Xhelal Aleksovski, Mirjanka Frçovski, Mladen Grozdanova, Elena Kamberi, Mabera Kazakovska, Irena Minovski, Dushko Saliu, Mirdita Trajanov, Stojan
MINISTIRA PËR ARSIM DHE SHKENCË:	Rexhep Ali Çupi Spasovski Ljupço
MINISTRIA PËR TRANSPORT DHE KOMUNIKIM:	Bajkova, Lençe
MINISTRIA PËR DREJTËSI:	Ibrahimi, Ibrahim Karamandi Ljubica
MINISTRIA PËR PUNË TË BRENSHME:	Stankovski, Toni
MINISTRIA PËR SHËNDETËSI:	Memedi, Senad
ZYRA E AVOKATIT TË POPULLIT:	Mustafa Bajramovska, Vaska Pirovska, Uranija
AGJENCIA KOMBËTARE PËR PUNËSIM:	Dimitrieva, Violeta Juran, Veljka
KËSHILLI KOMUNAL KUMANOVË:	Qazimovski, Zekret
KOMUNA E DELLÇEVËS:	Memedova, Xhulieta
TELEVIZIONI KOMBËTAR MAQEDONAS:	Selman, Atixhe Petrovski, Daniel
AKADEMIJA PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE PUBLIK:	Arnaudova, Aneta

## Organizata ndërkombëtare

MISIONI MBIKQYRËS I OSBE-SË NË SHKUP:	Ambasadori, Drozd, Natalya Albonetti, Domenico Ansedo Luna, Lola Berat, Ramadan Emurli, Aqim Fert, Ismail Garcia Tapia, Ticiana Herbst, Kristoph Popovska, Zaneta Schustereeder, Johann Tran, Nathalie Valles, Jaime
OSBE / ZYRA PËR INSTITUCIONE DEMOKRATIKE DHE TË DREJTA NJERËZORE:	Mirga, Andrzej Doghi, Dan
DELEGACIONI I KOMISIONIT EVROPIAN:	Ali, Elvis
FONDI I KOMBEVE TË BASHKUARA PËR FËMIJËT:	Foyouzat, Foroogh Lazovski, Aleksandar Stojanov, Zoran
PROGRAMI PËR ZHVILLIM I KOMBEVE TË BASHKUARA:	Stojkovska, Mihaela Imeri, Aferdita
KOMISIONERI I LARTË I KOMBEVE TË BASHKUARA PËR REFUGJATËT:	Vasilevski, Vladimir Nikolovski, Tihomir Kalanoska, Maja Lujiç, Vesna
INSTITUTI DEMOKRATIK KOMBËTAR:	Henshaw, Chris Çaparoski, Filip Marjanoviç- Panovska, Sladjana
FONDACIONI INSTITUT SHOQËRI E HAPUR MAQEDONI:	Lazarevska, Spomenka Memet, Ajsel
USAID:	Jakovlevska, Lela

## Shoqatat qytetare

ALEANCA PËR MAQEDONI PA DISKRIMINIM:	Postolovska, Natasha
AMBRELA:	Sikovska, Ljatife Mustafovska, Aida

QENDRA PËR TË DREJTA NJERËZORE DHE ZGJIDHJE TË KONFLIKTEVE:	Najçevska, Mirjana
OJQ DROM / QENDRA INFORMATIVE ROME KUMANOVË:	Jasharevski, Ahmet
ASOCIATA PËR EDUKIM SHËNDETËSOR DHE HULUMTIM (HERA):	Carovska, Mila
INICIATIVA PËR NDRYSHIM SOCIAL (InSoC):	Bojaxhieva, Aleksandra
KOMITETI MAQEDONAS I HELSINKIT:	Nestorovska, Gordana
INSTITUTI MAQEDONAS PËR MEDIA (MIM):	Saraçini, Petrit
KRYQI I KUQ I MAQEDONISË:	Personeli i Komunitetit /Qendra edukuese Shuto Orizari
MESEÇINA:	Toçi, Muhamed
QENDRA KOMBËTARE ROME (NRC):	Elezovski, Ashmet
OPEN GATE / LA STRADA:	Rajkovska, Jasmina Todorovska, Marija
QENDRA INFORMATIVE ROME SHUTO ORIZARI:	Skender, Ramadan Ahmed, Serhan
ROMAVERSITAS:	Osmanoski, Ajet
SUMNAL:	Bajram Fatma Dimkovska Stançe

#### **Ekspertë të tjerë**

Ançevska, Biljana – Instituti maqedonas për shëndetin e nënave dhe fëmijëve, Shkup

Bisson, Donald – Ekspert juridik, OSBE SMMS, Vlerësim i kapaciteteve të Qendrave informative rome për të dhënë ndihmë juridike falas për komunitetin rom

Friedman, Eben – Ish drejtor i Qendrës evropiane për të drejtat e pakicave, Shkup

## SHKURTESA

AHRPR	Asociata për të drejta njerëzore dhe mbrojtje të romëve
AP (PV)	Plani veprues i OSBE-së për përmirësimin e gjendjes së romëve dhe sintive në rajonin e OSBE-së
EZHA	Enti për zhvillimin e arsimit
CAG	Grupet këshilluese të qytetarëve
CPRSI	Kontakti për çështjet e romëve dhe sintive
OJQ	Organizata joqeveritare
BE	Bashkimi Evropian
FOSIM	Fondacioni institut shoqëria e hapur Maqedoni
ID	Dokumente identifikuese
IDP	Persona të zhvendosur brenda vendit
InSoC	Iniciativa për ndryshim social
LGI	Iniciativa për pushtet lokal dhe reforma të shërbimit publik
LPC	Këshilli parandalues lokal
MC.DEC	Vendim i Këshillit të ministrave
MASH	Mnistria për arsim dhe shkencë
MIM	Instituti maqedonas për media
MKD	Denarë maqedonas
MPPS	Ministria për punë dhe politikë sociale
MSH	Ministria për shëndetësi
MPB	Ministria për punë të brenshme
MTK	Ministria për transport dhe komunikim
TVM	Televizioni kombëtar maqedonas
NDI	Instituti kombëtar demokratik
NRC	Qendra kombëtare rome
ODIHR	Zyra për institucione demokratike dhe të drejta njerëzore
OFA	Marrëveshja kornizë e Ohrit
OSBE	Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë
OSI	Instituti shoqëria e hapur
PDD	Seksioni për zhvillim të policisë
REC	Rekomandim
REF	Fondi arsimor rom
RIC	Qendra informative rome
RMUSP	Programi i bursave universitare Roma Memorial
SIOFA	Sekretariati për zbatimin e marrëveshjes kornizë të Ohrit
SMMS	Misioni mbikqyrës në Shkup
KB	Kombet e Bashkuara
UNDP	Programi për zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNHCR	Zyra e Komësariatit të lartë të Kombeve të Bashkuara për refugjatët
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për fëmijët
UNIFEM	Fondi i Kombeve të Bashkuara për zhvillim të grave
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për zhvillim ndërkombëtar

## PËRMBLEDHJE

Ky Status raport, specifik për shtetin ofron një shqyrtim të detajuar të gjendjes aktuale lidhur me zbatimin e OSBE zotimeve të cilat i ka ndërmarrë shteti nikoqir për ta përmirësuar gjendjen e komunitetit rom. E thekson progresin, si dhe mungesat në përbushjen e rekomandimeve specifike, duke i ranguar nga çështjet e përfshirjes sociale, deri tek pjesëmarrja politike dhe diskriminimi. Gjatë trajtimit të këtyre çështjeve, raporti i përvijon përpjekjet e institucioneve shtetërore, aktorëve ndërkombëtar dhe shoqatave qytetare për të sjellë ndryshim pozitiv në gjendjen e një nga grupet më të prekshme në shtetin nikoqir.

Vlerësimi i zbatimit të Planit veprues të OSBE-së fillon me analizën e gjendjes aktuale në sferën e diskriminimit, legjislacionit dhe zbatimit të ligjit. Pastaj vazhdon me vlerësimin e gjendjes socio-ekonomike të komunitetit rom, duke i trajtuar sferat e banimit, punësimit dhe shëndetit dhe çështje lidhur me arsimin. Analiza pastaj i trajton çështjet e pjesëmarrjes së qytetarëve romë në jetën publike dhe politike në vend. Më në fund e shqyrton gjendjen e romëve të zhvendosur, kryesisht të arratisur gjatë krizës kosovare përpara një dekade.

Secili veprim i rekomanduar në Planin veprues të OSBE-së gjendet në nivele të ndryshme të zbatimit dhe shfaq progres dhe pengesa specifike. Progresi më i madh gjendet në sferën e legjislacionit dhe në disa aspekte në arsim, ndërsa pengesa të mëdha ende ka në zhvillimet përgjat çështjeve socio-ekonomike.

Megjithatë, mund të përcaktohen disa konkludime të përgjithshme lidhur me situatën më të gjërë të politikave të cilat i prekin romët.

Së pari, shteti nikoqir ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në krijimin e institucioneve, strategjive dhe legjislacionit, të cilat synojnë përbushjen e detyrave ndërkombëtare dhe trajtimin e çështjeve të ndërlidhura me komunitetin rom. Ende ka mungesa të mëdha mes zotimeve dhe praktikës për shkak të koordinimit të dobët, kapacitetit të kufizuar të institucioneve dhe vepruesve, si dhe financimit joadekuat.

Së dyti, progresi në dimensionet socio-ekonomike, që nga miratimi i Planit veprues të OSBE-së, është i neglizhueshëm: cikli i varfërisë nuk është thyer. Përpjekje të përforcuara janë të nevojshme në përpilimin e politikave gjithëpërfshirëse, të cilat do ta trajtojnë përfshirjen sociale dhe varfërinë. Në këtë kontekst, më shumë vëmendje duhet t'ju kushtohet aktiviteteve në terren dhe qasjeve nga poshtë, që deri tani kanë qenë të papërfillura nga ana e institucioneve. Fokusi duhet të jetë mbi aktivitetet të qëlluara në rritjen e vetëdijes mes komunitetit rom dhe përforcimi i tij për të marrë pjesë në jetën sociale dhe ekonomike, në aspekt të ndryshimit pozitiv dhe të qëndrueshëm.

Së treti, mekanizmat e mbikqyrjes dhe vlerësimit janë të dobta, mu për shkak të mungesës së të dhënave zyrtare, mapimit sistematik dhe aktiviteteve për vlerësim të nevojave në nivel lokal, si dhe komunikimit të institucionalizuar në mes vepruesve. Këto mekanizma duhet më tej të përforcohen për krijimin e politikave të cilat do të jenë të qepura sipas nevojave të komunitetit rom në vend.

Analiza e zbatimit të Planit veprues të OSBE-së thekson disa faktorë të cilët e nxisin ose e frenojnë progresin e gjendjes së popullatës rome në shtetin nikoqir. Në aspekt të këtyre dhe të zbratirave të identifikuara në realizimin e Planit veprues, jepen edhe rekomandime për veprime të mëtutjeshme. Këto mund të jenë në dobi të institucioneve shtetërore, si dhe aktorëve ndërkombëtar dhe të gjithë vepruesve të tjerë gjatë krijimit të politikave dhe qasjeve specifike shtetërore të cilat mund dukshëm ta përmirësojnë situatën e komunitetit rom në vend dhe përfshirjen efikase të tij në shoqëri.



## I. HYRJE

### Plani veprues për përmirësimin e gjendjes së romëve në regjionin e OSBE-së (2003)

Që nga thelemimi i saj, Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë e ka çmuar vlerën e shoqërive inkluzive të cilat e nxisin paqen dhe sigurinë në ambientin e tyre. Dimensionin njerëzor i sigurisë, të cilin OSBE-ja e praktikon është zhvilluar nga përpjekjet e shteteve anëtare për të promovuar mundësi të barabarta dhe përfundim të grupeve të marginalizuara gjatë tejkalimit të ç'kyçjes sociale dhe varfërisë. Duke e marrë parasysh këtë, Zyra për institucione demokratike dhe të drejta njerëzore (ODIHR), institucioni për dimensionin njerëzor në OSBE, ju përgjigj sfidës dhe u zotua që t'ju kushtojë vëmendje të posaçme çështjeve të romëve dhe sintive.

Themelimi i kontakt pikës për çështjet e romëve dhe sintive (CPRSI) në 1994 dhe miratimi i Planit veprues, nga Këshilli i ministrave në Mاستriht (2003), mundësuan që gjendja e romëve dhe sintive të përfshihet në agjendën e kësaj organizate. Vendimi i Këshillit të Ministrave në Helsinki (MC.DEC6/08) dhe vendimi i Këshillit të ministrave në Athinë (MC.DEC8/09) tregojnë se ka përkushtim të vazhdueshëm sa i takon kësaj çështje përgjatë 2008 dhe 2009. Ato kishën për qëllim që ti përforcojnë përpjekjet e OSBE-së në zbatimin e Planit veprues dhe ta sigurojnë integrimin e qëndrueshëm të romëve dhe sintive. Këto dokumente e theksojnë vetëdijen e shteteve pjesëmarrëse për nevojën për veprime gjithëpërfshirëse, të koordinuara dhe urgjente, për ta përmirësuar gjendjen e romëve dhe sintive në Evropë.

Duke pasur për qëllim që të 'ti mundësojë romët dhe sintit të luajnë një rol të plotë dhe të barabartë në shoqëritë tona, dhe ç'rrënjosjen e varfërisë mes tyre', plani veprues i OSBE-së ju rekomandon shteteve anëtare veprime të qarta për përmirësimin e gjendjes së komunitetit rom dhe sinti në vendet e tyre.

Rekomandimet e Planit veprues burojnë nga vetëdija se romët dhe sintit janë mes grupeve më të varfëra dhe më të marginalizuara brenda regjionit të OSBE-së. Ato shpesh vuajnë nga diskriminimi dhe abuzimi i të drejtave njerëzore, mungesa e qasjes në shërbime dhe mundësi, kanë vetëdije të kufizuar lidhur me të drejtat e tyre dhe shumë rrallë janë të përfshirë në jetën politike dhe në krijimin e politikave.

Sipas OSBE-së, ndërlidhshmëria e gjendjeve të tilla ka nevojë për një veprim gjithëpërfshirës dhe të koordinuar në një sërë të gjërë të dimensioneve. Duke u ndërlidhur në pikëpamjen se romët duhet aktivisht të përfshihen në dizejnimin dhe zbatimin e politikave të cilat i prekin ata, Plani veprues fillon me rekomandimin se politikat kombëtare dhe strategjitë për zbatim duhet të jenë 'për romët, me romët' (Kapitulli II). Propozon veprime për 'tejkalimin e racizmit dhe diskriminimit' (Kapitulli III), duke filluar nga çështjet e legjislacionit dhe zbatimi i ligjit, deri tek policia dhe mediat. Ç'rrënjosja e diskriminimit dhe respektimi i të drejtave njerëzore të romëve dhe sintive, janë parakushte të rëndësishme për përmirësimin e nivelit të përfshirjes dhe përfundimit të këtyre njerëzve në shoqëri. Pas kësaj, masat të cilat kanë për qëllim që ta zhdukin ç'kyçjen sociale dhe ta thyjnë ciklin e varfërisë, mundën ta arrijnë potencialin e tyre në maksimum. 'Trajtimi i çështjeve socio-ekonomike' (Kapitulli IV) është një hap i nevojshëm për ta nxitur integrimin e romëve në shoqëritë e shteteve anëtare. Sipas rekomandimeve në Planin veprues, duhet të veprohet në sferat e banimit, punësimit dhe kujdesit shëndetësor. Vëmendja e Planit veprues mbi qasjen në shërbime dhe mundësi për romët më tej reflektohet në rekomandimet për 'përmirësimin e qasjes në arsim' (Kapitulli V). Arsimi i rregullt kualitativ do të mundësojë grupet e prekshme, siqë janë romët, ti tejkalojnë pengesat për 'pjesëmarrjen e tyre në jetën publike

dhe politike' (Kapitulli VI). Krizat regjionale humanitare, si ato të cilat ndodhën në Ballkanin perëndimor në vitet e 90-ta, dhe personat e zhvendosur brenda vendit e krijuan nevojën për përfshijën e rekomandimeve për 'romët dhe sintit në krizë dhe në situata pas krizash' (Kapitulli VII).

Besimi se institucioni i OSBE-së dhe misionet në terren mund të ofrojnë një kontribut të rëndësishëm në arritjen e qëllimeve të Planit veprues, reflektohet në rekomandimet specifike të cilat i trajtojnë këto çështje. Dhënia e asistencës për shtetet anëtare, lehtësimi i koordinimit dhe shkëmbimi i praktikave të mira, koordinimi i përpjekjeve me vepruesit e tjerë ndërkombëtar dhe shqyrtimi i progresit në zbatim, janë sfera kyçe në të cilat OSBE-ja, siqë është paraparë në Planin veprues, duhet të luaj një rol të rëndësishëm.

### **Status raport për zbatimin e 'Planit veprues për përmirësimin e gjendjes së romëve dhe sintive në regjionin e OSBE-së' në shtetin nikoqir të Misionit mbikqyrës të OSBE-së në Shkup**

Në linjë me Kapitulli X të Planit veprues 'Zbatimi: shqyrtim dhe vlerësim' (rekomandimi 137), dhe me MC.DEC8/09 (pika 6), Misioni mbikqyrës i OSBE-së në Shkup (SMMS) e promovoi përpilimin e Status raportit për zbatimin e Planit veprues në vend. Përshtatja e zbatimit të Planit veprues sipas gjendjes unike të një shteti anëtarë dhe sipas nevojave specifike të bashkësisë rome, do të sigurojë një qasje më efektive lidhur me çështjet kryesore të cilat trajtohen. Misioni i OSBE-së, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet shtetërore, ju përgjigj mandatit të tij lidhur me përkrahjen e zbatimit të Marrëveshjes kornizë të Ohrit (OFA) lidhur me bashkësitë jo shumicë në shtet, siqë janë edhe romët.

Në kohë kur ka një interes më të madh në Bashkimin Evropian (BE) për çështjet e migrimit dhe integritit të romëve dhe sintive, kjo iniciativë ka nevojë për një peshë edhe më të madhe. Ngjarjet e fundit në BE, rritja e manifestimeve të racizmit dhe ksenofobisë dhe efektet e cikleve të kaluara të zgjerimit të BE-së mbi migrimin, i bëjnë politikatat të cilat kanë për qëllim përmirësimin e gjendjes së romëve në shtetet e tyre të origjinës shumë më të rëndësishme.

Shteti nikoqir, atdhe për shumë romë migrantë meriton një vëmendje të posaçme. Shpia e 53,879 romëve,<sup>1</sup> shteti ju dha romëve status të popujve themelues në kushtetutën e tij. Duhet të ceket se në kontekstin më specifik të shtetit nikoqir dhe OSBE SMMS, fokusi i raportit është vetëm mbi komunitetin rom edhe përpos referencës 'rom dhe sinti' në Planin veprues. Sintit në fakt, nuk janë prezent në shtetin nikoqir.

Shteti nikoqir shpesh shihet si shembull i praktikës së mirë sa i takon integritit të romëve në shoqëri, edhe përpos të disa mangësive në zbatimin e politikave të cilat i synojnë romët dhe gjendjen e vështirë në të cilën ende gjenden. Aspiratat e shtetit për tu anëtarësuar në BE, gjë e cila duhet të pasojë pas statusit aktual i të qenit shtet kandidat, kërkon që çështja e përfshirjes së romëve në shtet të vendoset mes prioriteteve në agjendën politike të vepruesve ndërkombëtar dhe kombëtar.

Në aspekt të dhënies së një vlerësimi për gjendjen aktuale dhe identifikimin e sfidave me të cilat ballafaqohen, qoftë edhe të tejkaluara deri tani, ky raport ka qëllim të trefishtë. Së pari, ta përkrahë shtetin nikoqir që ta përmirësojë dizejnimin dhe zbatimin e politikave kombëtare. Kjo do të dëshmohej si shumë e vlefshme, në veçanti nëse merren parasyshtë mekanizmat e dobët për

---

<sup>1</sup> Vlerësimet ndryshojnë mes atyre zyrtareve prej 53,879 (regjistrimi i popullsisë në 2002) dhe 80,000-250,000 sipas burimeve të raportuara nga Këshilli i Evropës.  
[http://www.coe.int/t/dg3/romatravellers/archive/documentation/strategies/statistiques\\_en.asp](http://www.coe.int/t/dg3/romatravellers/archive/documentation/strategies/statistiques_en.asp) (E qasur më 2 dhjetor 2010).

mbikqyrje dhe vlerësim në vend. Së dyti, Status raporti do të jetë në përfitim të OSBE SMMS dhe aktorëve të tjerë ndërkombëtar. Do t'ju ndihmojë atyre që ti identifikojnë mungesat dhe prioritetet në zbatimin e politikave për romët, duke dhënë depërtime shtesë për planifikimin e aktiviteteve të ardhshme. Në fundi, ky Status raport, specifik për shtetin, i pari i këtij lloji, mund të stimulojë shkëmbim të praktikave të mira në regjionin e Evropës jug-lindore.

## **Metodologjia**

Ky raport është rezultati i katër muajve të hulumtimit primar dhe sekondar në vend, në fund të 2010. Gjerësisht bazohet në informata të grumbulluara gjatë një numri të madh të takimeve me të gjithë vepruesit kryesor në vend. Zyrtar qeveritar dhe shtetëror, organizata ndërkombëtare, shoqata qytetare dhe ekspertë, të gjithë të cilët kanë kontribuar me pikëpamjet dhe eksperiencat e tyre në dizenjimin, zbatimin dhe rezultatet e politikave dhe projekteve që kanë të bëjnë me romët. Duke mos ndjekur ndonjë format të përpiktë, intervistat e hapura japin detaje për aktivitetet e secilit vepruesi, pengesat dhe sukseset të cilat vepruesit i kanë identifikuar, tendencat të cilat i kanë dëshmuar që nga miratimi i OSBE Planit për veprim e deri më sot dhe projektimet për përfshirje të ardhshme.

Kjo metodologji hulumtuese dha një përparësi të katërfishtë. Së pari, mundësoi që të tejkalohen vështirësitë në grumbullimin e informative dhe të dhënave të botuara. Shumica e të intervistuarve i bashkëndanë të dhënat e tyre dhe në kërkesë dhanë edhe detale shtesë. Së dyti, përshtypjet dhe pikëpamjet analitike të atyre drejtëpërdrejtë të përfshirë në çështjet rreth siguruan një mirëkuptim tërthor për natyrën shumëllojshë të çështjeve dhe rezultatve politike, siqë shihen edhe nga vetë vepruesit kryesor. Së treti, një hulumtim përfshirës, duke i marrë parasyshë pikëpamjet e të gjithë vepruesve e lehtësoi krijimin e një vizioni të paanshëm dhe gjithëpërfshirës për gjendjen në terren. Kjo mundësoi që të krijohen rekomandime të bazuara në identifikimin e skenareve reale dhe sinergjive të mundëshme mes aktorëve. Më në fund, hulumtimet kualitative ishin në pajtim me disa çështje specifike të shfaqura në Planin veprues të OSBE-së. Përfshirja e drejtëpërdrejtë e shumicës së vepruesve vend kishte një efekt shtesë: e rriti vetëdijen për Planin veprues të OSBE-së mes institucioneve shtetërore, si dhe anëtarëve të shoqatave qytetare.

Mbështetja vetëm në burimet primare do të ishte ngatërruese. Burimet sekondare më tej e kanë pasuruar qëllimin e këtij studimi. Hulumtimi në tavolinë përfshinte ekzaminim e dokumenteve zyrtare, raporteve dhe botimeve nga institucionet lokale dhe të huaja, si dhe nga ekspertët. Këto ishin resurse thelbësore për analizimin e politikave të ndërlidhura me romët, si dhe për kushtet jetësore të bashkësisë në moment dhe në të kaluarën.

Vlerësimi kualitativ i informative të grumbulluara i dha dritë jo vetëm progresit në gjendjen e romëve në shtetin nikoqir dhe në politikat dhe projektet të cilat i synojnë romët, por gjithashtu edhe në zbatimin e rekomandimeve të Planit veprues të OSBE-së. Të dy nivelet e analizës janë të ndërlidhura: përputhshmëria e rekomandimeve të PV të OSBE-së, vazhdon edhe përmes përmbushjes së politikave shtetërore të përpiluara në linjë me zotimet ndërkombëtare. Vlerësimi i këtij Status raporti e merr parasyshë progresin në përmbushjen e rekomandimit specifik të ndërmarrë më vitin 2003, duke përfshirë edhe vlerësim të veprimeve të aktorëve shtetëror dhe jo-shtetëror në këtë aspekt.

Edhe pse gjithëpërfshirës dhe i detajuar, ky raport nuk është i plotë në shqyrtimin e gjendjes së komunitetit rom në vend. Mungesa e të dhënave zyrtare dhe fokusi i përpiktë i hulumtimit mbi dokumentin e OSBE-së, e kufizojnë qëllimin e këtij vlerësimi. Megjithatë, ky dokument do të japë një shqyrtim të informuar mbi gjendjen dhe progresin në disa aspekte sa u takon romëve në shtetin nikoqir, duke i marrë parasyshë përshtypjet dhe punën e të gjithë aktorëve.

## II. KU GJENDET SHTETI TANI?

### Progresi që nga miratimi i Planit veprues të OSBE-së

Peridha e cila vijonte menjëherë pas miratimit të Planit veprues të OSBE-së (PV) në fund të vitit 2003, ishte një moment pozitiv për zhvillimin e politikave romë në shtetin nikoqir. U arrit një progres i rëndësishëm sa i takon krijimit të strategjive dhe institucioneve. Pasuan edhe zhvillime pozitive në sferën e legjislacionit. U krijua edhe korniza e domosdoshme për dizenjimin dhe zbatimin e sukseshëm të politikave romë, në përputhshmëri me kërkesën e MC.DEC6/08. Kjo e dëshmon zotimin e shtetit për ti mbajtur çështjet romë në agjendë.

Megjithatë, progresi në gjendjen aktuale të popullatës romë në vend ende nuk është shumë i dukshëm. Jo vetëm që duket se momenti pozitiv fillestarë të jetë humbur, por ka edhe një zbrastirë të madhe mes miratimit dhe zbatimit të politikave, e cila është shumë e dukshme tani kah fundi i kësaj dekade. Gjendja aktuale mund të vlerësohet si stagnuese, edhe pse kushtet janë të pjekura për revitalizimin e sukseshëm i cili është në interes dhe për veprime konkrete.

#### Miratimi i strategjive

Në pajtim me rekomanimin 4 të PV, shteti ka përpiluar *Strategjinë për romët në Republikën e Maqedonisë* (dhjetor, 2004), e cila është gjithëpërfshirëse dhe ende mbetet si burim inspirues për politikën e ndërlidhura me romët. Duke ju përgjigjur zotimeve ndërkombëtare, të ndërmarra në nivel regjional, shteti krijoi një grup punues përfshirës për përpilimin e *Planeve vepruese për Dekadën e përfshirjes së romëve 2005-2015*.<sup>2</sup> Këto u miratuan në vitin 2005, u rishqyrtuan në vitin 2008 dhe u miratuan në vitin 2009. Çështjet kryqëzuese siqë janë çështjet gjinore, në pajtim me rekomanimin e PV (Rec. 6), nuk u morrën parasysh. Një *Plan veprues për përmirësimin e gjendjes së grave romë* u miratua në vitin 2008 dhe pritet që version i rishqyrtuar të jetë gati në 2011.

Sa i takon procesit të decentralizimit në vend, 19 komuna nënshkruan një Memorandum për bashkëpunim me institucionet qendrore, duke e ndërmarrë përgjegjësinë për zbatimin e Planeve vepruese të Dekadës së romëve. Sidoqoftë, zbatimi i këtyre planeve gjithëpërfshirëse dhe ambicioze është i kufizuar. Raporti i Decade Watch vlerëson se vetëm 8% të aktiviteteve të parapara janë përfunduar.<sup>3</sup>

#### Themelimi i institucioneve

Sa i takon themelimit të institucioneve të cilat kanë për detyrë të promovojnë, krijojnë dhe zbatojnë politika për romët, hapa të rëndësishëm u ndërmorrën pas periudhës së miratimit të PV. Ministria për punë dhe politikë sociale (MPPS) e përfshin Njësinë për zbatimin e dekadës dhe strategjisë kombëtare,<sup>4</sup> në plotësim të tetë Qendrave informative romë (RIC) të shpërndara në vend dhe të cilat japin shërbime bazike dhe informata për popullatën romë.

Grupi punues i cili i formuloi *Planet vepruese të Dekadës* u institucionalizua si *Organ kombëtar koordinativ për zbatimin e Strategjisë kombëtare dhe planet vepruese të Dekadës*. Duke përfshirë përfaqësues të zgjedhur romë dhe nëpunës shtetëror, ministra dhe përfaqësues të

<sup>2</sup> Prej tani e tutje: “Dekada romë” ose “Dekada”.

<sup>3</sup> InSoC, Decade Watch MK 2010, f. 89.

<sup>4</sup> Prej tani e tutje: “Njësi”.

shoqatave qytetare, ky organ deri në vitin 2007 takoheshte rregullisht dhe me efikasitet. Në vitet e fundit ndodhën disa ndryshime, sa u takon anëtarëve dhe lidhshimit. Organi u takua vetëm dy herë në vitin 2008 dhe 2009 dhe nuk ka arritur që të takohet prej atëherë.

Pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2008, u krijua pozita e Ministrit pa resor, përgjegjës për çështjet rome. Në këtë pozitë në moment gjendet ministri Nexhdet Mustafa, i cili ndihmohet nga katër anëtarë të kabinetit. Roli i ministrit në qeveri e mundëson shansën e pashmangshme që vazhdimisht të sillen çështjet rome përpara vëmendjes së qeverisë. Koordinimi mes institucioneve, të cilat merren me çështjet rome, është i dobët. Është dobët i institucionalizuar dhe i ndikuar nga mendimet garruese mes anëtarëve të komunitetit rom, gjë e cila e frenon dialogun e frytshëm.

### **Buxheti shtetëror**

Një hap i rëndësishëm në trajtimin e politikave që kanë të bëjnë me romët është iniciimi i linjave buxhetore të dedikuara për Dekadën në buxhetet e ministrive relevante (punë dhe politikë sociale, transport dhe komunikim, arsim dhe shkencë, shëndetësi dhe kulturë). Mund të gjendet edhe një pikturë më e qartë për atë se si fondet përpunohen me projektet. Edhe pse në rritje që nga mesi i viteve 2000, fondet të cilat janë ndarë për zbatimin e Planeve vepruese në vitin 2010 janë 0.014% nga buxheti i përgjithshëm shtetëror. Sipas burimeve të ndryshme, buxheti shtetëror për romët në vitin 2010 ishte mes 335,610 € dhe 390,000 €. <sup>5</sup> Në disa raste, buxheti i caktuar nuk është shpenzuar për shkak të pengesave të ndërlidhura me zbatimin, siqë është rasti i Ministrisë së shëndetësisë në 2009.

### **Miratimi i kornizës ligjore**

Është bërë progres thelbësor sa i takon miratimit të legjislacionit, i cili ka të bëjë çështjet rome. Ligji për antidiskriminim, Ligji për ndihmë juridike falas, amandmanet e Ligjit për sigurim shëndetësor dhe disa ligje të ndryshme për arsim, janë mes ligjeve më relevante të miratuara pas PV të OSBE-së. Zbatimi dhe efikasiteti i tyre është i dobët. Procedurat për miratimin dhe promovimin e legjislacionit mund të jenë të gjata, siqë është rasti i Ligjit për antidiskriminim dhe Ligjit për legalizimin e ndërtimeve pa leje (është në fazën skicore që nga viti 2007).

### **Progresi në politika dhe në praktikë**

Gjendja aktuale e politikave dhe projekteve të ndërlidhura me romët, si dhe ndikimi i tyre, mund më së miri të sqarohen përmes analizimit të zbatimit të PV të OSBE-së më poshtë. Disa tendenca janë të qarta.

E para; konkludime për progresin në sferat e diskriminimit, banimit, punësimit, shëndetësisë dhe arsimit, shumë rrallë mund të gjenden nga të dhënat në numra. Këto në shumicë janë të pabesueshme, siqë gjithashtu janë edhe mekanizmat mbikqyrës dhe vlerësues përgjat të gjitha dimensioneve të përfshira në PV. Kurrëfar progresi i rëndësishëm nuk është vërejtur në sferën e grumbullimit të të dhënave dhe mekanizmave vlerësues. <sup>6</sup>

E dyta; arsimi gjerësisht llogaritet si dimension i cili më së shumti ka shfaqur progres. Shteti nikoqir ju është përshtatur rekomandimeve 69 dhe 75 të PV, për mundësi të barabarta dhe qasje në arsim, të ngulitura në programet arsimore parashkollë dhe të inkurajuara në vendimet e Këshillit të ministrave 6/08 dhe 8/09. Programe të cilat kanë për qëllim uljen e braktisjeve të shkollës nga

<sup>5</sup> Numri më i vogël është marrë nga Decade Watch MK 2010 (f. 91), i cili i referohet Gazetës zyrtare të Republikës së Maqedonisë si burim. Numri më i madh është marrë nga Njësia për zbatimin e Dekadës, MPPS.

<sup>6</sup> Shih Open Society Institute, "No Data - No Progress, Data Collection in Countries Participating to the Decade of Roma Inclusion 2005-2015", qershor 2010.

ana e fëmijëve rom janë shumë pak efektive dhe nuk janë gjithëpërfshirëse. Gjithashtu, edhe iniciativat për rritjen e vetëdijes, të cilat i synojnë prindërit, janë sporadike dhe të ndërmarra nga shoqatat qytetare. Promovimi i multikulturalizmit dhe respektit të ndërmjetshëm në shkolla, i cili është problem në shtetin nikoqir në përgjithësi, është ende nën optimalen. Mungesat janë të dukshme në realizimin e Rekomandimeve 71, 72, 73 dhe 76 të PV, edhe përpos të iniciativave të vlefshme siqë është krijimi i lëndës zgjedhore *Gjuha dhe kultura rome* në shkollat fillore, e cila është në disponim për një numër të kufizuar të fëmijëve rom. Një hap i rëndësishëm është njohja nga ana e institucioneve shtetërore se *de facto* segregimi në arsim ndodh.<sup>7</sup>

E treta; progresi, në jetën socio-ekonomike të popullatës rome, që nga miratimi i PV të OSBE-së, është shumë i kufizuar. Papunësia, gjerësisht e përhapur (73% sipas vlerësimeve jo-zyrtare),<sup>8</sup> e cila krijon kushte banuese dhe jetësore të rrezikshme, është nxitës i shëndetit të dobët, si dhe ndikon në ndjekjen e ulët të shkollimit, tregon se duhet ende bërë për tu thyer cikli i varfërisë. Popullata rome mbetet grupi më i prekshëm në shoqëri.

Bashkëpunimi i frytshëm mes vepruesve ndërkombëtar dhe institucioneve shtetërore, rezultoi në pak progres sa i takon regjistrimit dhe marrjen e dokumenteve identifikuese për popullatën rome. Efekte të dukshme të përfshirjes rome në punësimet publike ende nuk shihen, edhe përpos të disa shenjave të realizimit të rekomandimeve 48, 49, 95 dhe 96 (në pajtim me OFA). Edhe pse është e përfaqësuar në nivel lokal dhe kombëtar, popullata rome ka shumë pak përfitim nga përfshirja e zmadhuar politike dhe mekanizmat këshilluese të cilat ekzistojnë. Promovimi i të drejtave njerëzore dhe nevojave të romëve nga përfaqësuesit e tyre në përgjithësi, nuk shihet për të qenë i dobishëm. Si pasojë, ndarja e madhe mes komunitetit dhe delegatëve të tij është duke u rritur në disiluzion.

---

<sup>7</sup> Rexhep Ali Çupi, drejtor i Drejtoratit për zhvillim dhe promovim të arsimit të gjuhëve të bashkësive, Ministria për arsim; intervenim gjatë konferencës për promovim të Decade Watch MK 2010, 22 tetor 2010.

<sup>8</sup> OSI Report, "No Data - No Progress, Data Collection in Countries Participating to the Decade of Roma Inclusion 2005-2015", qershor 2010, f. 40.

## Gjendja aktuale e zbatimit

### Kapitulli III i PV – Tejkalimi i racizmit dhe diskriminimit

#### Legjislacioni dhe zbatimi i ligjit

**7) Nëse nuk janë ratifikuar, sa më shpejt që është e mundshme të ratifikohen të gjitha traktatet ndërkombëtare dhe mes tjerave, Konventa ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit.**

Shteti nikoqir ka miratuar kornizën ndërkombëtare legjislative e cila e lufton diskriminimin racor. Jo vetëm që shteti nikoqir pajtohet me *Konventën ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor*,<sup>9</sup> por gjithashtu edhe rregullisht i nënshtrohet komitetit relevant. Nënshtimi i ardhshëm pritet që të bëhet këtë vit.

Pas ndarjes nga Jugosllavia, gjegjësisht në 1994, u miratuan një sërë e dokumenteve të rëndësishme ndërkombëtare, përfshirë *Deklaratën për të drejtat njerëzore të KB*, *Konventën ndërkombëtare për të drejta civile dhe politike* dhe *Konventën ndërkombëtare për të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore*. Shteti nikoqir gjithashtu, e ka ratifikuar *Konventën kornizë për mbrojtjen e të drejtave njerëzore dhe lirive bazike* (1 shkurt 1998) dhe *Konventën evropiane për mbrojtjen e të drejtave njerëzore dhe lirive bazike* (10 prill 1997), duke përfshirë edhe *Protokollin 12* i cili merret me diskriminimin (1 prill 2005).

**8) Të miratohet dhe zbatohet legjislacioni efektiv për antidiskriminim për të tejkaluar diskriminim racor dhe etnik në të gjitha sferat, duke përfshirë si pasojë edhe qasjen në banim, nënshtetësi dhe qëndrim, arsim, punësim, shëndetësi dhe shërbime sociale. Të përfshihen përfaqësues të romëve dhe sintive në proceset e dizenjimit, zbatimit dhe vlerësimit.**

Pas disa viteve të debatit intensiv sa i takon përmbajtjes së ligjit për antidiskriminim, në prill të vitit 2010, kuvendi i shtetit nikoqir e miratoi *Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi*.<sup>10</sup> Ky i fundit, duhet të fillojë të zbatohet nga 1 janar 2011, pas formimit të Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi.<sup>11</sup> Ligji është si pasojë e rekomandimeve ndërkombëtare, mes të tjerave ato të OSBE-së, Bashkimit Evropian<sup>12</sup> dhe Komitetit për eliminimin e diskriminimit racor të KB, mirëpo zbatimi i legjislacionit të antidiskriminimit në praktikë dhe efektet e tij mbeten që ende të vërtetohen. Ekzistojnë dyshime lidhur me zbatimin e një legjislacioni të tillë, si dhe lidhur me qasjen e qytetarëve rom sa u takon informative për të drejtat e tyre njerëzore, si dhe për punën e Komisioni i cili së shpejti duhet të krijohet.<sup>13</sup>

Ligji ka për qëllim që ta parandalojë, si dhe të mbrojë nga diskriminimi dhe qartësisht ju referohet të gjitha sferave, duke filluar nga banimi, arsimi dhe punësimi, deri tek shëndetësia dhe shërbimet sociale. Nuk i bëhet kurrëfar reference e qartë nënshtetësisë dhe rezidencës.

<sup>9</sup> Shteti nikoqir u bë palë e Konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor përmes suksesit dhe jo të miratimit më 18 janar 1994.

<sup>10</sup> Prej tani e tutje: “Ligji” ose “Ligji për antidiskriminim”.

<sup>11</sup> Prej tani e tutje: “Komisioni”.

<sup>12</sup> Commission of the European Communities, The Former Yugoslav Republic of Macedonia 2009 Progress Report, 2009, f. 18.

<sup>13</sup> Intervist me: Aleksandra Bojaxhieva, InSoC, 24 shtator 2010; Gordana Nestorovska, Komiteti maqedonas i Helsinkit, 28 shtator 2010; Mirjana Naiçevska, Institut për hulumtime sociologjike, politike dhe juridike, 6 tetor 2010.

Debati i gjatë i cili ndodhi përpara miratimit të Ligjit e nxorri në pah përfshirjen e shoqatave qytetare në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave njerëzore dhe të pakicave, (Komiteti Maqedonas i Helsinkit, InSoC, Qendra për të drejta njerëzore dhe zgjidhje të konflikteve, Aleanca Maqedonia pa diskriminim). Organizatat ndërkombëtare, duke përfshirë edhe OSBE-në, në pajtim me Rec. 20 të PV, e ndihmuan procesin e përpilimit.

Sapo të fillojë faza e zbatimit do të bëhet e qartë se nëse shoqatat qytetare për të drejtat njerëzore dhe përfaqësuesit e romëve janë përfshirë rregullisht në procesin e vlerësimit. Përfshirja e romëve mund të përforcohet përmes zgjedhjes së qytetarëve romë në Komision, në rast se gjendet kandidat i kualifikuar.

### **9) Legjislacioni për antidiskriminim duhet të sigurojë:**

#### **a. Parandalim i diskriminimit racor të drejtëpërdrejtë dhe jo të drejtëpërdrejtë.**

Neni 3 i Ligjit për antidiskriminim ndalon ‘çdo lloj të diskriminimit të drejtëpërdrejtë dhe jo të drejtëpërdrejtë, nxitje të diskriminimit dhe ndihmimin e akteve diskriminuese’ në disa fusha edhe atë sipas racës, përkatësisë së grupeve të marginalizuara ose atyre etnike.

#### **b. Vendosja e sanksioneve efektive, të përshtatshme dhe zbindëse për aktet ose praktikat diskriminuese.**

Ligji përmban rregulla për kundërvajtje, duke indikuar sanksione në para për kryerjen, inkurajimin ose shtimin e praktikave dhe veprimeve diskriminuese; shkelje të dinjitetit të një personi, malltretim ose viktimizim; mungesë e të dhënave ose ndalesë e qasjes në dosjen për Komisionin (neni 37-40). Më tej, praktikat diskriminuese mund të dënohen edhe sipas legjislacionit tjetër, i cili vlen për fusha specifike (arsim, marrëdhënie pune, shëndetësi etj) ose të Kodit penal. Ky i fundit imponon sanksione duke përfshirë edhe dënimin me burg për kryerje të ‘shkeljes së barazisë së qytetarëve’ (neni 137), ‘ofendim përmes sistemit kompjuterik të anëtarëve në bazë të racës, religjionit, grupit etnik, në bazë të ngjyrës së lëkurës’ (neni 173, paragraph 2), ‘nxitja të urrejtjes etnike, racore dhe religjioze, grindje dhe jotolerancë’ (neni 319), ‘shpërndarje të materialeve raciste dhe ksenofobike përmes sistemeve kompjuterike’ (neni 394-d), dhe ‘diskriminim racor dhe ndonjë tjetër lloj’ (neni 417).

Edhe pse janë paraparë sanksione për veprime dhe praktika diskriminuese, efikasiteti i tyre është i vështirë për tu matur. Efekti zbindës i imponuar nga ligji i ri do të mund të dallohet vetëm pas zbatimit të Ligjit në janar të vitit 2011. Në aspektin tjetër, efikasiteti i sanksioneve të parapara në ligjet e tjera (Kodi penal, ligjet për arsim, ligjet për marrëdhënie të punës etj.) është i vështirë për tu vlerësuar. Edhe pse raste të diskriminimit shumë rrallë janë raportuar, të hetuara dhe sanksionuara, shoqatat qytetare shprehin keqardhje për diskriminimin në shtetin nikoqir,<sup>14</sup> edhe në sfera ku legjislacioni kombëtar duhet që të ofrojë mbrojtje.

Komiteti i KB për eliminimin e diskriminimit racor raporton për një mungesë brengosëse të dënimit të kryersve të fjalimit të urrejtjes në media.<sup>15</sup> Në këtë kontekst të moskujdesit për zbatimin e ligjit dhe mjetet e kufizuara të qytetarëve romë për të ndërmarrë procedura ligjore për mbrojtje të të drejtave të tyre, bëhet e dyshueshme se nëse sanksionet e parapara me ligjin e ri do të jenë

<sup>14</sup> State Department, “2009 Human Rights Report: Macedonia”, 11 mars 2010.

<http://www.state.gov/g/drl/rls/hrrpt/2009/eur/136044.htm>. (Accessed on 16 Shtator 2010).

<sup>15</sup> UN OHCHR, “Concluding Observations – Consideration of Reports submitted by State Parties under Article 9 of the Convention: The Former Yugoslav Republic of Macedonia, CERD/C/MKD/CO/7”, 13 qershor 2007, f. 55.



efektive dhe zbindëse. Kjo do të ndodhë vetëm nëse shteti nikoqir nuk dëshmon zotim më të madh politik për të siguruar zbatim të ligjit, duke u ndërlidhur në momentumin i cili është krijuar nga ligji i ri për antidiskriminim, për ti këputur ç'rrenjësuar qëndrimet e kaluara lidhur me çështjet diskriminuese.

***c. Vendosja e dënimeve më të rënda për krimet racore edhe për individët privat edhe për zyrtarët publik.***

Nenet brena Kodit penal parashohin dënime më të rënda për krime të motivuara në bazë të racës. Amandmanet e Kodit penal në shtator të vitit 2009, parashohin dënimin me burg për krimet e urrejtjes.<sup>16</sup> Një nga bazat është origjina kombëtare dhe/ose raca (Neni 39 (5)).

Ligji vlen barabartë për të gjitha qeniet njerëzore dhe juridike, duke i përfshirë edhe individët privat, si dhe zyrtarët publik.

***d. Qasje e barabartë në mjetet efektive (gjyqësore, administrative, pajtim ose ndërmjetësim).***

Qasja e barabartë tek mjetet për viktimat e supozuara nga diskriminimi, do të thotë se nuk ka kurrëfar pengesa që qytetarët ti përdorin të gjitha instrumentet ekzistuese për ti mbështetur të drejtat e tyre. Nuk ka kurrëfar pengese legjislative edhe sa i takon qasëshmërisë në këto mjete. Ka kornizë ligjore për qasjen e barabartë në mjetet efektive.

Mbetet që të vëzhgohet se si do të zhvillohet zbatimi i Ligjit në praktikë. Tre pika kryesore mund ta parandalojnë qasjen e barabartë në mjetet efektive dhe prandaj atyre duhet t'ju kushtohet më tepër vëmendje. Së pari, duhet të rritet vetëdija mes popullatës rromë për konceptin e diskriminimit ndaj të drejtave njerëzore, si dhe për mjetet efektive të cilat janë të disponueshme në rast të diskriminimit. Duhet të zgjidhen mekanizma efektiv për ta shpërndarë informatën tek romët. Raporti juridik ekspert, i prodhuar për OSBE SMMS thotë se RIC mund të luajn një rol shumë të rëndësishëm në këtë kontekst.<sup>17</sup> RIC mund ta informojnë popullatën rromë për të drejtat e tyre sipas ligjit për antidiskriminim dhe ti japin popullatës ndihmë bazike dhe këshilla sa i takon kësaj çështje. E dyta, shpenzimet e ndërlidhura me procedurat gjyqësore mund ta parandalojnë qasjen e barabartë për të gjithë. Edhe pse ankesat në Komision do të jenë falas, shpenzimet e fshehta (p.sh. transport, mbledhja e dëshmimeve) mund të paraqesin pengesa për qasjen e qytetarëve të varfër. Ligji për ndihmë juridike falas nuk i mbulon shpenzimet për të gjithë qytetarët, të cilët janë ekonomikisht të prekshëm. E treta; meqenëse Komisioni do të jetë i vendosur në Shkup, largësia nga kryeqyteti mund ta pengojë qasjen deri tek këto mjete.

Çështja e efikasitetit të mjeteve/instrumenteve më së miri do të vlerësohet njëherit që Komisioni do ta vlerësojë rastin e parë të diskriminimit. Ligji sygjeron që të merret si udhëzim vlerësimi i rekomandimeve të Komisionit.

***10) Legjislacioni kombëtar duhet ti parandalojë të gjitha llojet e akteve diskriminuese dhe që të gjitha rastet e dyshuara për diskriminim duhet të jenë hollësisht dhe objektivisht të hetuara.***

Legjislacioni kombëtar është gjithëpërfshirës sa u takon të gjitha formave të veprimeve diskriminuese. Ligji vlen për rastet e diskriminimit në të cilat janë përfshirë edhe personat fizik edhe juridik, pa dallim në sferën private ose publike. Më tej, përfshihen të gjitha llojet e diskriminimit: diskriminim i drejtëpërdrejtë ose jo i drejtëpërdrejtë (më saktësisht i përcaktuar në

<sup>16</sup> Ligji për ndryshimet dhe amandmanet e Kodit penal, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 114, 14 shtator 2009.

<sup>17</sup> Don Bisson, Assessment of the Capacity of the Roma Information Centres to Provide Free Legal aid to the Roma Community, tetor 2010.

nenin 6), ngacmimi ose trajtimi degradues (Neni 7), thirje për dhe nxitja e diskriminimit (Neni 8-a), viktimizimi (Neni 8-b), dhe diskriminimi në dhënien e të mirave dhe shërbimeve (Neni 8-c).

Hetimi i rasteve të dyshimta për diskriminim do të jetë një nga kompetencat e Komisionit, i cili duhet të fillojë me punë në janar të vitit 2011. Emrimi i anëtarëve profesional dhe të pavarur në Komision nga ana e Kuvendit shumë do të ndihmojë në hetimin e tërësishëm dhe objektiv. E dyta; është e rëndësishme që Komisioni, gjyqtarët dhe prokurorët të trajnohen lidhur me sferën e legjislacionit të antidiskriminimit. Akademia për trajnim të gjyqtarëve dhe prokurorëve publik deri tani nuk është angazhuar për të dhënë trajnim lidhur me ligjin e ri.<sup>18</sup> E treta, me qëllim që të bëhet një hetim i hollësishëm lidhur me rastet e dyshuara për diskriminim duhet që të caktohen resurse të nevojshme për Komisionin, me qëllim që i njejtë ta zbatojë me sukses mandatin e tij. Më në fund, nëse hetohen të gjitha rastet e dyshuara për diskriminim, Komisioni duhet sipas kompetencave të dhëna nga ligji të jetë proaktiv në iniciimin e hetimeve dhe veprimeve.

Përveç të qenit të hollësishëm dhe objektiv, hetimet duhet të jenë në kohë: është e rëndësishme që rastet të cilat sillen në gjyq të trajtohen si ‘procedura urgjente’ (Ligji për antidiskriminim, neni 29). Elementet e parimit të ‘procedurës urgjente’ nuk janë të përcaktuara. Urgjencia e procedurës e nënvizon nevojën për zgjidhje urgjente të konflikteve gjatë caktimit të ndëgjimeve në gjyq, por nuk jepen afate më të përpikta. Në këtë rast, do të vlejë afati i përgjithshëm i paraparë me ligjin për procedurat lidhur me daljen në gjyq.<sup>19</sup>

***11) Të krijohet, ku është e mundshme institucione të specializuara për të siguruar zbatimin e një legjislacioni të tillë, si dhe mekanizma vendor për mbikqyrjen dhe raportimin e rregullt me transparencë sa i takon progresit të arritur në zbatim. Të inkurajohet pjesëmarrja e përfaqësuesve romë dhe sinti në trupat e tillë, puna e të cilëve duhet të jetë e qasëshme për publikun.***

Ligji krijon një institucion të specializuar, Komisionin, i cili është përgjegjës për të mbrojtur nga diskriminimi dhe zbatimin e legjislacionit për antidiskriminim. Komisioni ka një horizont të gjërë të kompetencave të cilat mund të karakterizohen siqë vijon: trajtim pas ankimit, asistencë dhe përkrahje e viktimave të rasteve konkrete të diskriminimit; kompetenca promovuese dhe këshilluese; aktivitete hulumtuese dhe analitike.

Është i paraparë edhe raportimi vjetor në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë.<sup>20</sup> Edhe pse praktika e kornizës së re ligjore do të hijesojë mekanizmat vëzhgues relevant, kujdes i posaçëm duhet të kushtohet që nga fillimi për të siguruar vlerësim të rregullt lidhur me progresin në zbatimin e Ligjit.

Duht të merret parasysh se Agjencia për realizimin e të drejtave të pakicave, e themeluar në 2008 mundet të luaj ndonjë rol në vëzhgimin e progresit sa i takon antidiskriminimit të pakicave më të vogla se 20% e popullatë (duke përfshirë edhe romët). Sidoqoftë, deri tani efikasiteti i kësaj agjencie ka qenë i kufizuar.

---

<sup>18</sup> Intervistë me Aneta Arnaudova, drejtorë i Akademisë për trajnim të gjyqtarëve dhe prokurorve publik, 14 tetor 2009.

<sup>19</sup> Duhet të theksohet se procedura për mbrojtjen nga diskriminimi ka disa veçanti në krahasim me procedurën e rregullt civile. Këto përfshijnë: kompetenca lokale dëshmitë(zhvendosja prej në paditës, në të paditur), karakteri i lëndës gjyqësore dhe pohimit, pjesëmarrja e palëve të treta në procesin e ndërgjimit, mundësia për të inicuar procedura gjyqësore të përbashkëta dhe masa sigurie përpara fillimit ose gjatë procedurës.

<sup>20</sup> Ligji për antidiskriminim, Parag. 19 (4).

Përfaqësuesit e shoqërisë civile do ta mirëpresin zgjidhjen e përfaqësuesve romë në Komision, nëse gjendet një kandidat i kualifikuar. Meqëse mund të dalin vështirësi gjatë këtij qëllimi bëhet edhe shumë më e rëndësishme që të kemi mekanizma transparent për vlerësim.

***12) Të krijohen, ku është e nevojshme, strategji gjithëpërfshirëse kombëtare ose plane vepruese për ta përmirësuar gjendjen e romëve dhe sintive, të cilat do të përfshijnë masa specifike të cilat do ta trajtojnë diskriminimin në të gjitha sferat e jetës.***

Një Strategji kombëtare gjithëpërfshirëse (Strategjia për romët në Republikën e Maqedonisë) dhe plane vepruese të detajuara (Plane vepruese për Dekadën e përfshirjes romë 2005-2015 dhe verzionet e rushqyrtuara të tyre në 2009)<sup>21</sup> u krijuan, me qëllim që ta përmirësojnë gjendjen e komunitetit rom. Strategjia kombëtare përfshin 'Mbrojtjen e të drejtave njerëzore dhe nga diskriminimi' në sferat kryesore të identifikuar. Masa specifike për ta parandaluar dhe tejkaluar diskriminimin përbrenda shoqërisë nuk janë të parapara në këto dokumente.

Në disa komuna u miratuan edhe plane lokale vepruese (psh. Tetovë, Kumanovë, Gostivar), shpesh të inkurajuara nga OJQ-ët.

***13) Të vlerësohen rregullisht, posaçërisht në nivel lokal, rezultatet e këtyre strategjive, si dhe të përfshihet komuniteti rom dhe sinti në procesin e vlerësimit.***

Deri tani nuk është organizuar kurrëfar vlerësimi sa u takon rezultateve të dokumenteve paraprake në sferën e diskriminimit. OJQët, qoftë ato të fokusuar në çështjet romë ose të drejtat njerëzore në përgjithësi, ndërmarrin vlerësime lidhur me diskriminimin sa u takon romëve duke ju referuar zotimeve dhe dokumenteve shtetërore. Shembuj për tu marrë parasyshtë janë botimet nga OJQ-ja Meseçina dhe Aleanca Maqedonia pa diskriminim.

Mbetet ende për tu parë se nëse do të organizohen vlerësime më sistematike, të cilat i përfshijnë të gjithë aktorët, me fillimin e zbatimit të ligjit të ri për antidiskriminim. Komisioni si detyrë ka edhe aktivitete hulumtuese, duke përfshirë grumbullim të dhënash, ndjekje dhe dokumentim të rasteve diskriminuese. Qëllimi i këtyre aktiviteteve është të detektohen stereotipet dhe paragjykimet ekzistueset, si dhe të gjenden strategji për ti ç'rrenjosur ato, gjithashtu edhe përmes politikave.

***14) Të bëhen përpjekje, përmes të inkurajimit të dialogut të sigurtë, për përmirësimin e relacioneve mes romëve dhe sintive dhe banorëve të tjerë, me qëllim të promovimit të tolerancës dhe tejkalimit të paragjykimeve dhe stereotipeve negative tek të dyja palët.***

Shteti nikoqir nuk mundëson mekanizma sistematik, të cilat e inkurajojnë dialogun dhe konsultimin mes romëve dhe banorëve tjerë. Fushatat e gjëra kundër paragjykimeve dhe stereotipeve dhe aktivitete mediale të cilat gjithashtu promovojnë tolerancë mungojnë. Njësia për mundësi të barabarta brenda MPPS inicoi një fushatë për ta promovuar Ligjin për antidiskriminim, duke përfshirë gjithashtu çështjen e diskriminimit të romëve.

Mund të vërehen dy fakte positive. E para, përfaqësuesit e romëve zakonisht përfshihen në diskutimet lidhur me politikën të cilat ndikojnë mbi komunitetin e tyre (p.sh. përpilimi i Ligjit për antidiskriminim, Planet vepruese të Dekadës së romëve, etj.). E dyta, OJQ-ët promovojnë aktivitete të cilat inkurajojnë dialogun dhe mirëkuptimin e përbashkët mes romëve dhe banorëve të tjerë. Punëtori për nëpunësit shtetëror lokal për antidiskriminim (Komiteti maqedonas i Helsinkit),

---

<sup>21</sup> Planet vepruese trajtojnë katër sfera: arsim, punësim, banim dhe shëndetësi.

trajnim për studentët e fakulteteve pedagogjike për të punuar me pakicat siqë janë romët (OSBE SMMS) dhe iniciativa të ngjajshme të cilat janë përpjekje të pakta për ti tejkaluar paragjykimet kundër romëve.

***15) Të dokumentohen, sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e të dhënave, të gjitha llojet e rasteve relevante të diskriminimit që më mirë të vlerësohet gjendja dhe të plotësohen nevojat e romëve dhe sintive.***

Në fillimi të zbatimit të ligjit për antidiskriminim nuk mund të gjenden të dhëna të përshtatshme për të gjitha rastet e diskriminimit. Jo vetëm që rastet që kanë të bëjnë me diskriminim janë trajtuar në kuadër të ligjeve të tjera të ndryshme (Kodi penal, Ligji për marrëdhënie pune, etj.), por gjithashtu edhe shumë rallë i bëhet referencë diskriminimit. Vetëdija e kufizuar lidhur me konceptin dhe shfaqjen e diskriminimit mbesin, së bashku me padëshirën e qytetarëve për ti praktikuar parimet antidiskriminuese. Këto janë pengesat kryesore sa i takon vlerësimit të besueshëm lidhur me praktikant diskriminuese ndaj romëve.

Sa i takon funksionit preventiv të Komisionit, pritet që të ketë sukses në vlerësimin e gjendjes. Aktivitetet promovuese, të cilat e përforcojnë vetëdijen e qytetarëve lidhur me mbrojtjen nga diskriminimi, duhet të jenë pjesë e qasjes strategjike të Komisionit.

Deri tani, zyra e Avokatit të popullit ka qenë një shembull i praktikave të mira në dokumentimin e rasteve diskriminuese të cilat i përfshijnë institucionet publike. Disa qytetarë shpesh edhe rrefuzojnë që të japin detale lidhur me përkatësinë e tyre etnike dhe të thonë qartësisht se kanë qenë të diskriminuar. 18 raste për diskriminim kanë qenë të raportuar nga qytetarë romë mes 2003 dhe 2010,<sup>22</sup> më së shumti lidhur me të drejtat e punës dhe sigurimin shëndetësor. Qoftë nga mungesa e prokurorëve publik për të krijuar baza të mjaftueshme për ta inicuar procedurën ose nga ato të cilët hekin dorë nga procesi, asnjë rast nuk ka rezultuar në vendim gjyqi.

***16) Të sigurohen hetime aktive dhe efektive të akteve të dhunës ndaj personave romë dhe sinti, posaçërisht kur ka baza të arsyeshme për të dyshuar se kanë qenë të motivuara në bazë të racës dhe të paditen ato të cilët janë të përgjegjshëm në pajtim me ligjet vendor dhe të cilat janë në pajtim me standardet relevante ëvr të drejtat njerëzore.***

Kodi penal deri tani e ka dhënë bazën për hetimin dhe dënimin e akteve të dhunës racore. Nuk është përpiluar ndonjë shqyrtim gjithëpërfshirës i rasteve të tilla dhe mungon edhe vetëdija e publikut të gjërë lidhur me aktet e dhunës kundër romëve. Prandaj edhe është e vështirë të vlerësohet efikasiteti i hetimeve relevante.

Ekspertët dhe aktivistët për të drejta njerëzore shprehin keqardhje për procedurën e vështirë për të mbledhur dëshmi dhe vonesa që efektivisht të hetohen të drejtat njerëzore dhe rastet e diskriminimit ku përfshihen romët. Raportohen ndodhitë e tilla i shkurajojnë qytetarët rom për të kërkuar drejtësi kur besojnë se janë viktime të dhunës racore. Edhe pse elementet për një vlerësim të dobishëm për një çështje të tillë janë të pakta, roli proaktiv i institucioneve në iniciimin dhe inkurajimin e hetimit në kohë dhe efektiv për të gjitha rastet e dhunës racore mund të përforcohen.

Në pajtim me Planin dhjetë pikësh të OSBE-së për tejkalimin e krimeve të urrejtjes dhe përmirësimin e zgjidhjeve legjislative, praktikave gjyqësore, detektimit dhe përndjekjes së krimeve të dhunshme të urrejtjes, duhet të krijohet një bazë e të dhënave statistikore e veçantë për krimet e urrejtje. Gjithashtu edhe masat dhe aktivitetet veç inkriminimit mund të përforcohen (p.sh. edukimi

---

<sup>22</sup> Të dhëna nga Uranija Pirovska, Zyra e Avokatit të popullit. Intervistë me 27 shtator 2010.

i policëve dhe prokurorve publik, inkurajimi i qytetarëve për ti raportuar krimet, mbrojtja e viktimave etj).

**17) Të munësohet mosndëshkimi i autorëve të krimit të diskriminimit ose akteve të dhunshme, mes tjerave duke ndërmarrë një veprim të menjëhershëm, efektiv, si dhe ndëshkues nga ana e policisë.**

Ankesat nga romët kundër kryersve të akteve diskriminuuese ose të dhunshme janë të rralla. Avokati i popullit raporton për raste ku nuk është ndërmarrë aksion nga policia, ndërsa është dashur që të marrin masa për ti mbrojtur qytetarët.<sup>23</sup> Nuk japin informata për përkatësinë e tyre etnike. Në vitin 2007 dhe 2008 Gjykata evropiane e të drejtave njerëzore gjykoi tre raste në favor të qytetarëve romë kundër shtetit.<sup>24</sup> Duke ju referuar ngjarjeve të cilat kanë ndodhur përpara një dekade, rastet treguan se aktet e dhunës ngaj qytetarëve romë nuk janë hetuar adekuatshëm.<sup>25</sup>

**18) Të lehtësohet qasja në drejtësi për romët dhe sinti përmes masave siqë janë ndihma juridike dhe dhënia e informatave në gjuhën rome.**

Qytetarët romë shpesh kanë mungesë të mjeteve finaciare për ti mbrojtur të drejtat e tyre përmes sistemit gjyqësor. Ligj i miratuar për ndihmë juridike falas, i cili hyri në fuqi në janar të vitit 2010, duhet të mundësojë që grupet më të prekshme në shoqëri të kenë qasje në ndihmën juridike bazike edhe atë falas. Sidoqoftë, kriteret për tu kualifikuar për të janë tepër të rrepta, saqë nuk është e qartë se kush janë përfituesit. Qytetarët të cilët kanë pronësi e cila vlen katër herë më tepër se rroga mesatare kombëtare nuk kualifikohen, edhe pse ato mund të mos kenë mjete për ti bartur shpenzimet ligjore. Përveç përpjekjeve shtetërore për t'ju mundësuar asistencë juridike falas romëve edhe disa OJQ ofrojnë një ndihmë të tillë. Mes tyre është Shoqata për mbrojtjen e të drejtave njerëzore të romëve, bashkëpunëtore e OSBE-së në projekt përmes të cilit mundësohet ndihmë juridike mobile në pjesën lindore të shtetit.

Ndihma juridike falas më veti, nuk është e mjaftueshme për ta siguruar qasjen e romëve në drejtësi. Dhënia e informative lidhur me të drejtat e tyre, obligimet dhe procedurat bazike juridike është një parakusht tjetër i domosdoshëm. OJQ-ët rome dhe organizatat për të drejtat njerëzore në shtet, së bashku me Qendrat informative rome (RIC),<sup>26</sup> shpesh ofrojnë ndihmë bazike në fazat e hershme të procedurave juridike. MPPS planifikon që ta përforcojë kapacitetin e RIC-ve sa u takon çështjeve juridike dhe administrative. Me ndihmën e OSBE-së, BE-së, pushtetit lokal dhe Iniciativa reformuese e shërbimit publik (LGI), MPPS po shqyrton mënyra se si t'jua garantojë shërbimet e tilla bazike qytetarëve romë, përmes trajnimeve juridike të punonjësve aktual në RIC ose përfshirjen e avokatëve brenda këtyre institucioneve.

<sup>23</sup> Zyra e Avokatit të popullit të Republikës së Maqedonisë, "Raport vjetor 2009", f. 35.

<sup>24</sup> CASE OF JASAR v. THE FORMER YUGOSLAV REPUBLIC OF MACEDONIA (Application no. 69908/01); CASE OF SULEJMANOV v. THE FORMER YUGOSLAV REPUBLIC OF MACEDONIA (Application no. 69875/01); CASE OF DZELADINOV AND OTHERS v. THE FORMER YUGOSLAV REPUBLIC OF MACEDONIA. Në të gjitha këto raste, Gjykata njëzërit ka vendosur se ka pasur shkelje të nenit 3 nga Konventa evropiane e të drejtave njerëzore, pvr shkak se autoritetet kanë dështuar që të zbatojnë një hetim efektiv mbi pohimin e aplikuesve për trajtimin e keq nga ana e policisë.

<sup>25</sup> [http://www.coe.int/t/DGHL/Monitoring/Execution/Themes/Roms/Roma\\_en.asp](http://www.coe.int/t/DGHL/Monitoring/Execution/Themes/Roms/Roma_en.asp).

<sup>26</sup> Tetë Qendra informative rome janë prezente në territorin e shtetit nikoqir. Ato janë të vendosura në OJQ-ët lokale dhe secila prej tyre ka nga dy punonjës të pagur nga MPPS. Kjo e fundit edhe i koordinon dhe mbikqyr aktivitetet e tyre në dhënie e shërbimeve për popullatën rome.

**19) Në të gjitha programet dhe aktivitetet të merret parasyshë gjendja e grave romë dhe sinti, të cilat shpesh janë viktime të diskriminimit, edhe në bazë të përkatësisë etnike, edhe në bazë të gjinisë.**

Në fillim të miratimit të Ligjit për mundësi të barabarta (2006) dhe krijimin e Departmentit për mundësi të barabarta përbrenda MPPS, ju përkushtua vëmendje edhe çështjes së diskriminimit të shumëfishtë të cilin e përjetojnë gratë romë. Nevojat specifike të grave romë u identifikuan në Planin veprues për gratë romë 2008-2010 (i cili së shpejti duhet të zëvendësohet nga një dokument i ri më 2011), i cili si sfera prioritare i kishte punësimin, shëndetësinë, arsimin, pjesëmarrjen politike, të drejtat njerëzore dhe diskriminimin.

Megjithatë, mungesa e resurseve buxhetore rezultoi në mungesa në zbatimin e masave të parapara nga Plani veprues: u zbatuan vetëm dy projekte lidhur me diskriminimin kundër grave romë.<sup>27</sup> Së pari, u organizuan punëtori për të trajnuar trajnues për atë se si të qasen institucionet për ti mbrojtur të drejtat e grave romë. E dyta, MPPS dhe UNIFEM botuan një libër i cili ka për qëllim që ta rrisë vetëdijen për diskriminimin e grave romë.

Sa i takon dhunës familjare, trafikimit me njerëz dhe çështjeve të tjera lidhur me gjinin, asnjë program specifik për romët nuk është zbatuar nga shteti deri më sot. OJQ-ët janë aktive në këtë sferë përmes iniciativave për rritje të vetëdijes dhe dhënies së ndihmës për gratë romë.

## Policia

**26) Të krijohen politika të cilat promovojnë vetëdije mes institucioneve për zbatim të ligjit lidhur me gjendjen e romëve dhe sintive, dhe të cilat tejkalojnë paragjykitime dhe stereotipe negative.**

Angazhimi i drejtëpërdrejtë i policisë me komunitetin rom, përmes punëtorive, diskutime me Këshillet lokale preventive (LPC) dhe Grupet këshilluese të qytetarëve tematike (CAG) (përkrahur nga OSBE SMMS) janë instrumenti kryesor për të rritur vetëdije për tejkalimin e paragjykitimeve ndaj policisë. Një mjet tjetër shtesë dhe i vlefshëm për ta përforcuar vetëdijen e policëve për gjendjen e popullatës romë është organizimi i trajnimeve për kulturën romë. Ministria për punë të brendshme (MPB) dhe OSBE-ja kanë bashkëpunuar që nga viti 2007 në mundësimin e *ad hoc* trajnimeve për më tepër se 200 policë të cilët shërbejnë në vendet e banuara me romë, me qëllim që ti përgadisë ato që të përgjigjen adekuatshëm për nevojat e sigurisë të komunitetit rom.

Në këtë kontekst, Departamenti për zhvillim të policisë (PDD) i OSBE-së ka në plan që të organizojë trajnime për praninë të llojllojshmërisë në 2011, me qëllim që ta rrisë vetëdijen për paragjykitimet mes policisë.

**27) Të krijohen programe trajnuese për parandalimin e përdorimit të tepërt të fuqisë dhe të promovohet vetëdije për dhe respekt i të drejtave njerëzore.**

Programi trajnues i Akademisë policore përfshin module për të drejtat njerëzore dhe etikë në polici. Në plotësim, MPB dhe PDD kanë bashkëpunuar që nga viti 2007 në organizimin e trajnimit në shërbim për zbatimin e Kodit policor për etikë.

---

<sup>27</sup> Informata të dhëna nga Mirdita Saliu, Udhëheqës i Departamentit për mundësi të barabarta, MPPS. Intervista u mbajt me 1 tetor 2010.

Megjithatë, pohime për brutalitet dhe përdorim të tepërt të fuqisë nga ana e policisë, në veçanti ndaj romëve vazhdojnë edhe sipas 2010 Raportit për progres të BE-së<sup>28</sup> dhe sipas Raportit vjetor të Avokatit të popullit.<sup>29</sup> Gazetat e përditëshme dhe OJQ-ët gjithashtu raportojnë për sjellje të keqe të policisë kur bëhet fjalë për qytetarët romë. Për shembull, në 2007, Dnevnik raportoi se ‘qindra lypës romë pohojnë se policia ka përdorur fuqi për ti zhvendosur lypësit e përditshëm në kufirin e Tabanovcit’.<sup>30</sup> OJQ Arka, në raportin e saj vjetor për të drejtat e romëve ka identifikuar 13 raste të shkeljes së të drejtave romë nga ana e policisë. Nga këto, 8 përfshijnë përdorim të tepërt të fuqisë, duke përfshirë ‘trajtim jo-njerëzor dhe brutal nga policia, i cili shkakton dëmtim të dhimbshëm trupëror dhe vuajtje mentale të personave të cilët janë të privuar nga liria e tyre’.<sup>31</sup> Të tjerët kanë të bëjnë me hetimin e vonuar dhe keqpërdorimin e fuqisë.

Më 2009, tek avokati i popullit u sollën 9 ankesa nga qytetarë romë për çështje të ndërlidhura me policinë, edhe pse numri mund të jetë më i lartë nëse merret në konsiderim ajo se qytetarët nuk e tregojnë përkatësinë e tyre etnike gjatë dorëzimit të ankesës. Hetimi pastaj i referohen Sektorit për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale në MPB. Avokati i popullit ka identifikuar disa përmirësime të kufizuara në procedurat e tij,<sup>32</sup> të cilat më tej mund të zhvillohen përmes miratimit të një manuali për Veprime standarde operative për përdorimin e tepërt të fuqisë (në veçanti kur bëhet fjalë për përdorimin e armëve me zjarr) i cili në moment është nën shqyrtim. OJQ-ët e të drejtave njerëzore kërkojnë një hetim më të detajuar dhe pavarësi më të madhe të këtij sektori, i cili sipas pohimeve deri tani ka ndërmarrë vetëm masa minimale kundër kryersve.<sup>33</sup>

SMMS do të organizojë konferencë regjionale për krijimin e Sektorin për kontrollë të brendshme dhe standarde profesionale, e cila do të ketë për qëllim që të nxisë zhvillim të mëtutjeshëm të kontrollit të brendshëm të policisë dhe marrëdhëniet e saj me mekanizmat e jashtëm për vëzhgim.

***28) Të krijohen politika: (1) për përmirësimin e marrëdhënieve mes komunitetit rom dhe sinti me policinë për të parandaluar keqpërdorimin dhe dhunën ndaj romëve dhe sintive; dhe (2) për ta përmirësuar besimin tek policia mes romëve dhe sintive.***

Gjatë viteve të fundit janë zbatuar një numër i projekteve të cilat kanë pasur qëllim të dyfishtë, për ta njoftuar policinë me komunitetin rom dhe nevojat e tij, përderisa në të njëjtën kohë është përforcuar besimi i romëve ndaj policisë. Janë zbatuar edhe disa punëtori për rolin e policisë ku janë përfshirë fëmijët dhe komuniteti në përgjithësi (psh. Dita ekologjike e Topaanës 2006; Vizitë tek stacioni policor i Gazi Babës më 2005).

OSBE-ja i ka përkrahur diskutimet e LPC dhe CAG tematike lidhur me çështje të cilat kanë qenë në interes të bashkësisë romë (psh. fëmijët në rrugë) në 17 komuna, në vitin 2010 dhe këto paraqesin një iniciativë pozitive për të promovuar përfshirje sociale të bashkësisë romë dhe rritjen e vetëdijes së policisë lidhur me çështjet specifike të sigurisë për romët. LPC-ët dhe CAG-ët janë vetëm parciaisht të njohura mes qytetarëve. Sipas hulumtimit për polici qytetare të OSBE-së në 2010, 37.2% nga të anketuarit dinë për LPC-ët dhe 34.4% për CAG-ët, edhe pse përgjigjet pozitive

<sup>28</sup> Commission of the European Communities, “The Former Yugoslav Republic of Macedonia 2010 Progress Report The Former Yugoslav Republic of Macedonia”, f. 15.

<sup>29</sup> Avokati i popullit, “Raporti vjetor 2009”, f. 35.

<sup>30</sup> Dnevnik, “Romët e Kumanovës e akuzojnë policinë për brutalitet”, 14 gusht 2007, f. 13.

<sup>31</sup> Roma Rights Forum Arka, “Roma Monitor - Situation of Roma rights in Macedonia 2009-2010”, f. 4.

<sup>32</sup> Avokati i popullit, “Raporti vjetor 2009”, f. 36.

<sup>33</sup> Roma Rights Forum Arka, “Roma Monitor - Situation of Roma rights in Macedonia 2009-2010”, f. 15.

janë zmadhuar që atëherë.<sup>34</sup> Është raportuar se komunitetet, ndryshe nga maqedonasit dhe shqiptarët, janë më pak të njoftuara me institucionet e tilla.<sup>35</sup>

Punëtoritë e mëtutjeshme të cilat kanë pasur për qëllim përmirësimin e bashkëpunimit dhe besimit të ndërmjetshëm përmes dialogut (fëmijë në rrugë, delikuenca juvenile, trafikimi i fëmijëve) e kanë dëshmuar bashkëpunimin e policisë me OJQ-ët rome (p.sh. Sumnal, Ambrela) dhe veprues të tjerë (Avokati i popullit, MPPS, OSBE) në disa komuna (posaçërisht Koçan, Manastir, Shuto Orizare). Më tej, OJQ-ja Open Gate ka organizuar trajnim për policinë lidhur me parandalimin e trafikimit njerëzor dhe asistencën e viktimave, në bashkëpunim me MPB.

Përfshirja dhe frekuenca e këtyre aktiviteteve do të sigurojë përmirësime më të mëdha në ndërtimin e besimit të ndërmjetshëm mes policisë dhe qytetarëve romë. Një studim më i hershëm i OSBE-së i thekson tendencat e ulta, mirëpo përmirësuese, në besimin shoqëror tek policia mes të gjithë qytetarëve në vend (61.9%).<sup>36</sup> Hapsirë për përmirësimin e besimit të qytetarëve në polici ka në të gjithë shoqërinë.

### ***29) Të krijohen politika dhe procedura për të mundësuar që policia ti përgjigjet dhunës racore kundër romëve dhe sinti.***

Nuk ka politika dhe procedura për krimet racore, njejtë siqë supozohet se ‘nuk ka raste të dhunës racore’ në shtetin nikoqir.<sup>37</sup> Nuk ka dëshmi për sulmet e organizuara kundër vendbanimeve rome në shtetin nikoqir.

### ***30) Të vlerësohet zbratira mes standardeve ndërkombëtare për polici dhe praktikat ekzistuese kombëtare në konsultacion me forcat policore kombëtare, OJQ-ët dhe përfaqësues të komuniteteve rome dhe sinti.***

Aktivitetet e përmendura parapakisht të cilat kanë për qëllim përforcimin e besimit mes policisë dhe komunitetit rom përfitojnë nga përfshirja e OJQ-ve dhe përfaqësuesve romë. LPC dhe CAG tematike rome gjithashtu mundësojnë pjesëmarrjen e komunitetit rom.

### ***31) Të përpilohen, ku është e përshtatshme dhe në bashkëpunim të ngushtë me organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-ët rome, deklarata policore, kode për sjelljs, manuale për udhëheqje praktike dhe programe trajnuese.***

Manuale dhe kode për sjelljen e policisë dhe posaçërisht për policinë në komunitetin rom, nuk janë të disponueshme. Sipas OJQ-ës rome Arka, është i nevojshëm arsim më i madh për kodet e sjelljes dhe të drejtat njerëzore, në veçanti për njësitë Alfa.<sup>38</sup>

Botimi dhe shpërndarja e fletushkave për të drejtat e qytetarëve, në stacionet policore dhe në veçanti të drejtat e qytetarëve të arrestuar, në të gjitha gjuhët e pakicave (përfshirë edhe atë rome) është një hap pozitiv. Kjo ishte një përpjekje për ta rritur transparencën e veprimeve policore, rritja e vetëdijes për të drejtat e qytetarëve dhe përforcimi i besimit.

---

<sup>34</sup> OSBE SMMS në bashkëpunim me MPB, Hulumtimi për polici qytetare 2010, Raport narativ, f. 97.

<sup>35</sup> Ibid., f. 98.

<sup>36</sup> Ibid., f. 89.

<sup>37</sup> Intervistë me Toni Stankovski, zëvendës drejtor, Ministria për punë të brendshme, Sektori për polici, 12 nëntor 2010. Z. Stankovski bashkëndau përgjigje të shkruar nga zyra kompetente e MPB lidhur me pyetjen nga eksperti: “A ka procedura për ta trajtuar dhunën racore?”

<sup>38</sup> Roma Rights Forum Arka, “Roma Monitor - Situation of Roma rights in Macedonia 2009-2010”, f. 15.



**32) Të inkurajohen romët dhe sintit që të punojnë në institucionet për zbatim të ligjit, si një mjet i qëndrueshëm i promovimit të tolerancës dhe llojllojshmërisë.**

Aktivitetet të cilat kanë për qëllim që ta afrojnë komunitetin rom me policinë, si dhe parimi i përfaqësimit të drejtë, janë instrumente për inkurajimin e përfshirjes rome në institucionet për zbatim të ligjit. Vullneti i MPB për të rekrutuar studentë romë nga shkollat e mesme, me kritere lehtësuese është një shenjë pozitive, edhe pse rezultatet janë të rralla.

Proporcioni i qytetarëve romë të punësuar në institucionet për zbatim të ligjit, nga numri i përgjithshëm i punonjësve (0.65%)<sup>39</sup>, është në përputhshmëri me mesataren kombëtare të romëve në institucionet publike, por shumë nën objektivën prej 2.66%. Ka 73 romë punojnë në institucionet për zbatim të ligjit në shtetin nikoqir, nga të cilët vetëm disa janë në pozita të rangut të mesëm. Roli i tyre në polici ka efekt të dyfishtë, nga njëra anë rritja e besimit të komunitetit rom tek policia dhe nxitja e dialogur ndër-etnik brenda forcave policore.

## Mediat

**36) Të organizohen fushata informative dhe për rritje të vetëdijes, me qëllim që të tejkalohen paragjykimet dhe stereotipet negative për romët dhe sintit.**

Në vitet e fundit nuk është inicuar kurrëfar fushate për informim dhe rritje të vetëdijes në mediat e shtetit nikoqir, me qëllim që të tejkalohen paragjykimet dhe stereotipet negative për romët. Strategjia kombëtare më veti, edhe pse u përkushton pak vëmendje mediave, si një nga sferat prioritare për përforcimin e komunitetit rom, nuk përfshin rekomandime specifike për fushata për tejkalim të paragjykimeve.

Megjithatë, fushata të dedikuara për senzibilizimin e vetëdijes publike për çështjet të cila ndikojnë mbi grupet e prekshme, përfshirë edhe romët, organizohen prej kohe në kohë. Shembuj të fundit janë fushata për varfëri (tetor, 2010) dhe ajo për fillimin e Ligjit për antidiskriminim.<sup>40</sup> Portretimi sporadik i punës së sukseshme të OJQ-ve rome në media mund të ketë efekt pozitiv në tejkalimin e stereotipeve negative. Transmetimi i videos së OSBE-së dhe OJQ-ës rome Sumnal në televizionin A1 TV, e përkrah këtë pikëpamje.

Analizat e rolit të mediave në përmirësimin e gjendjes së romëve nuk duhet ta lejn anësh vlerën e fushatave informative, të cilat e synojnë popullatën rome. Redaksioni i gjuhës rome në kuadër të transmetuesit kombëtar TVM, ka transmetuar dokumentare të shkurtër për regjistrimin në arsim, shëndetësi dhe qasjen në dokumente. Transmetuesit privat romë, disaherë kur përfshihen në aktivitete të ngjajshme mund ti përforcojnë përpjekjet dhe kapacitetin e tyre për të transmetuar informata për çështjet të cilat ndikojnë mbi popullatën rome. Këto përpjekje nuk arrijnë deri tek publiku më i gjërë dhe prandaj janë të papërfillëshme në kontributin për tu tejkaluar stereotipet dhe paragjykimet negative.

<sup>39</sup> Të dhënat u mundësuan nga Toni Stankovski, 12 nëntor 2010.

<sup>40</sup> Intervistë me Elena Grozdanova, 5 tetor 2010.

**37) Për tu nxitur liria e shprehjes, duhet të inkurajohet trajnimi i gazetarëve romë dhe sinti dhe punësimi i tyre në media, me qëllim që të lehtësohet qasja më e gjërë e romëve dhe sintive në media.**

Mbështetja e lirisë së shprehjes dhe përmirësimi i lajmeve dhe çështjeve të ndërlidhura me romët në mediat kryesore, si dhe në mediat private të romëve, do të përfitojë me shumë nga përfshirja e gazetarëve romë në institucionet e mediave. Prezenca e gazetarëve romë në redaksionet kombëtare është shumë e kufizuar dhe raportohet se është e zvogluar në vitet e fundit.<sup>41</sup>

Edhe pse kanë qasje në arsimin e gazetarisë, romët kanë mungesë të mjeteve nxitëse për të marrë këtë drejtim në Fakultetin juridik ose për të ndjekur shkollën për gazetari dhe marrëdhënie publike (SHGMP), e themeluar nga MIM në vitin 2008. Së pari, shpagesat ekonomike për arsimin e gazetarisë janë të kufizuara dhe një karrierë në gazetari bëhet shumë më pak atraktive. E dyta, programet të cilat ofrojnë përkrahje financiare janë të kufizuara. Kjo situatë është keqësuar në vitet e fundit.

Në mes 2006 dhe 2008, gjatë tre viteve akademike, MIM ka trajnuar 36 romë për tu bërë gazetarë përmes Programit medial për romët, duke ju ofruar studentëve 6 muaj ligjerata dhe 3 muaj punë praktike në media. Pengesat ekonomike për ndjekje tejkaloreshin përmes dhënies së materialeve dhe parave në bazë mujore. Në vitin 2008, studentëve romë ju ofruan 3 bursa për ta ndjekur kursin 3 vjeçar të SHGMP-ës, por mbetet ende e paqartë nëse ky program i bursimit do të vazhdojë.<sup>42</sup> Rezultatet e projektuara nga aktivitetet e MIM dhe SHGMP-ës janë të dyfishta: në njërin anë, është rritur numri dhe kualiteti i lajmeve të ndërlidhura me romët në media (p.sh. trajtimi i rasteve të diskriminimit); në anën tjetër, është krijuar një gjeneratë e re e gazetarëve romë. Mirëpo, vetëm disa prej tyre të përfshirë mbeten në gazetari për shkak se shumica e të diplomuarve janë zhvendosur në profesione ekonomikisht më të përfitueshme dhe më stabile (OJQ, qeveri).<sup>43</sup> Këto programe në rastin më të mirë kanë arritur rezultate të përziera. TVM, A1 dhe transmetuesit romë i mbajnë disa nga të diplomuarit e MIM, mirëpo vështirësit financiare dhe hezitimi i gazetarëve profesionistë për të bërë kompromis me politikën redaktuese të disa shtëpive mediale private i frenojnë mundësitë për punësimin e gazetarëve romë në media.

**38) Të inkurajohen mediat që të trajtojnë aspekte pozitive dhe të prezantojnë një portretim të balansuar të jetës rome, të përmbahen nga stereotipet ndaj romëve dhe sintive dhe tu shmangen tensioneve mes grupeve të ndryshme etnike. Të organizohen tryeza të rrumbullakta mes përfaqësuesve të mediave dhe përfaqësuesve të romëve dhe sintive për ta promovuar këtë qëllim.**

Përderisa mediat nuk janë të inkurajuara në mënyrë aktive, për të transmetuar aspekte pozitive të jetës rome, ato edhe nuk janë të detyruara sipas Ligjit për transmetim ta respektojnë dhe inkurajojnë ‘shpirtin e tolerancës, respektit dhe kuptimit të ndërmjetshëm mes individëve të përkatësive së ndryshme etnike dhe kulturore’.<sup>44</sup> Trajnime për gazetarë, për të promovuar gazetari etike shpesh organizohen nga MIM dhe partnerët e tij ndërkombëtar, organizatat ndërkombëtare ose transmetuesit e huaj (p.sh. BBC).

<sup>41</sup> Intervistë me Petrit Saraçini, 12 tetor 2010; Intervistë me Ajet Osmanovski, 14 tetor 2010.

<sup>42</sup> Dyshimet për vazhdimin e programit të bursimit u shprehën nga Petrit Saraçini, 12 tetor 2010.

<sup>43</sup> Ibid.

<sup>44</sup> Ligji për transmetim (Nga: Qendra maqedonase për hulumtime juridike, <http://www.mlrc.org.mk/law/1021.htm>. (E qasur më 27 tetor 2010).

Sipas aktiviteteve mbikqyrëse të MIM, Romaversitas dhe OJQ-ve, rastet e stereotipizimit dhe mungesës së respektit dhe profesionalizimit në pikturimin e romëve në lajme, janë të shpeshta. OJQ-ja Meseçina dhe përfaqësuesi i MIM e raportojnë titullin e Veçer në 2008, ‘I lusim romët mos bëjnë punë cigane’ i cili është përdorur në dy raste.<sup>45</sup> Tek lajmet të cilat kanë të bëjnë me romët shpesh vendosen fotografi për romët e stereotipizuar.<sup>46</sup> Nëse romët janë të përfshirë në vepra penale, atëherë tregohet edhe përkatësia e tyre tenike.<sup>47</sup> Këto janë vetëm raste të zakonshme të cilat kontribuojnë në përforcimin e stereotipeve dhe mosbesimit ndaj popullatës rome.

Përderisa përpjekjet për senzacion dhe lajme në media, së bashku me qëllimet politike janë udhëheqësit kryesor për portretimin e pabalansuar të jetës rome, është mungesa e zbatimit të legjislacionit dhe dënimeve për tu fajësuar për situatën aktuale. Vërejtjet nga Këshilli i nderit të gazetarëve dhe ankesat nga institucionet, të cilat i vëzhgojnë mediat, mund të kenë *ad hoc* efekte të menjëhershme, edhe përpos asaj që nuk janë të detyrueshme. Mungesa e kuptimit të shumëllojshmërisë kulturore, injorimi i zbatimit të përmbajtjes së trajnimeve dhe dështimi i institucioneve për ti trajtuar çështjet e stereotipizimit dhe diskriminimit, janë mes çështjet kryesore të cilat duhet të adresohen.

#### **Kapitulli IV i PV – Trajtimi i çështjeve socio-ekonomike**

##### Kushtet banuese dhe jetësore

***43) Të vendosen mekanizma dhe procedura institucionale për tu qartësuar të drejtat e pronës, të zgjidhen çështjet e pronësisë dhe të rregullohet statusi legal i romëve dhe sintive, të cilët jetojnë në rrethana të legalitetit të pazgjidhur (p.sh. lagje rome pa të drejta prone ose të cilat nuk janë të përfshira në planet kryesore urbane të atij vendi; familje dhe shtëpi pa status për qëndrim legal në vendbanime ku njerëzit de facto kanë jetuar me dekada).***

Sa i takon çështjes së pronësisë ose legalizimit të vendbanimeve ilegale të banuara nga romët dhe modernizimin e ndërtesave sub-standarde, nuk ka ndonjë progres të dukshëm. Mungojnë të dhëna të qarta dhe vlerësim i gjendjes, ndërsa konkludimet paraprake përkrahen nga hulumtimet e mendimit publik, siqë janë Decade Watch MK dhe dokumentet qeveritare (2009 Plani veprues për banim). Ato raportojnë se ka keqësim dhe gjendje të pafavorshme në sferën e dokumentacionit dhe legjislacionit të pronësisë.<sup>48</sup> Transferimi i kompetencave në nivel komunal, pasojë e procesit të decentralizimit, edhe më shumë e ka frenuar qasjen më të qëndrueshme dhe më të informuar, sa i takon kësaj çështje. Megjithatë, disa komuna pregatisin plane urbane të cilat mund ti përfshijnë lagjet e romëve (p.sh. Prilep).

Miratimi i ligjit për legalizimin e ndërtesave pa leje ende është duke u pritur, edhe pas tre viteve të përpilimit nga ana e Ministrisë për transport dhe komunikim (MTK) në bashkëpunim me

---

<sup>45</sup> 16 qershor 2008, <http://www.vecer.com.mk/default.asp?ItemID=DAB12A4FF4AB06448ECDADBFC57A4E96> and

25 Tetor 2008

<http://vecer.com.mk/?ItemID=D98F34FE7924EC4F97961718193A7825>. Intervistë me Muhamed Toçi, 14 Tetor 2010. Intervistë me Petrit Saraçini, 12 tetor 2010.

<sup>46</sup> Hulumtimet nga MIM theksojnë përdorimin e fotografive të refugjatëve rom nga Kosova në një sërë të artikujve ku përmenden romët në ndonjë kontekst krejtësisht tjetër.

<sup>47</sup> Hulumtim nga Meseçina; Intervistë me Muhamed Toçi, 14 tetor 2010.

<sup>48</sup> Decade Watch MK 2010, f. 39. Revision of the National Action Plans for the Decade of Roma Inclusion 2005-2015 in the Republic of Macedonia for the period 2009-2011, f. 10.

UNDP-in. Procedura për legalizim, e cila parashihet me këtë dokument, duket si tepër e vështirë për të qenë lehtë e qasëshme për banorët romë. Procesi i miratimit është shtyer për vitin e ardhshëm edhe pse mbetet e paqartë se nëse në këtë fazë të ligjit do të përfshihen edhe vendbanimet pa leje ku jetojnë qytetarët romë. Përderisa çështja e legalitet mbetet e pazgjidhur, perspektivat për zgjidhje rezistente në mundësimin e infrastrukturës, veglave, standard të denjshëm jetësor dhe qasje më të lehtë në të drejtat dhe shërbimet të cilat kërkojnë si dëshmi adresën e jetesës, janë të zbehta.

***44) Të përfshihen romët dhe sintit në dizenjimin e politikave banuese, si dhe në ndërtimin, rehabilitimin dhe/ose mirëmbajtjen e projekteve për banim publik, të cilat janë të dedikuara për përfitimin e tyre. Projektet banuese të mos nxisin segregim etnik dhe/ose racor.***

Në përgjithësi romët nuk janë të përfshirë në dizenjimin e politikave banuese dhe projekteve për banim publik. Megjithatë, në një shkallë të kufizuar, komuniteti rom është i përfshirë në sferën e projekteve infrastrukturore në vendbanimet rome, të financuara kryesisht përmes buxhetit të MTK për zbatimin e Planit veprues të Dekadës si dhe përmes buxheteve komunale. Kabineti i Ministrisë pa resor konsultohet gjatë përcaktimit të projekteve prioritare në nivel komunal, ndërsa të cilat duhet të financohen nga buxheti i MTK.

***45) Të shqyrtohet mundësia për dhënien e huave për shtetet anëtare, të cilat mundësohen nga organizatat ndërkombëtare dhe institucionet financiar, e për projekte banuese për personat me të ardhura të vogla.***

Shteti nikoqir ka marrë hua nga Banka zhvillimore e Këshillit të Evropës. Huaja duhet të përdoret për ndërtimin e banimit social sipas planit qeveritar 2007-2009, i cili parcialisht është gati. Projekti parasheh në përgjithësi € 50.7 milion për ndërtimin e 35 ndërtesave në 26 qytete.

Banesat duhet t'ju jepen familjeve të prekshme, me qira të ulta. Jo vetëm që 'familjet rome socialisht të prekshme' janë mes 7 kategorive të përfituesve të këtij projekti banues, por atyre gjithashtu ju jepet prioritet përpara të gjitha kategorive gjatë aplikimit (p.sh. persona me hendikep, nëna të vetme etj.)<sup>49</sup> Është e rëndësishme që zotimi i tillë të plotësohet në përcaktimin e ardhshëm të banimit social. RIC mund të japin asistencë për popullatën rome në realizimin e të drejtave të tyre në këtë sferë.

***46) Të promovohet opcioni i skemave për banim bashkëpunues për komunitetin rom dhe të mundësohet trajnim për mirëmbajtje të paisjeve të tilla.***

Opcioni i skemave për banim bashkëpunues për romët nuk është shqyrtuar nga ana e MTK. Njësia për përfshirje sociale brenda MPPS, udhëheq dy qendra për të pastrehët (Çiçino Sello dhe Lubanci), të cilat strehojnë kryesisht qytetarë romë dhe ofrojnë paisje të bashkëndara. Mbi 100 njerëz strehohen në një kohë dhe për një periudhë prej maksimum gjashtë muaj. MPPS raporton se shumica e shfrytëzuesve romë nuk janë të pastrehë, por janë familje me probleme banuese (p.sh. banim me me tepër anëtarë).

---

<sup>49</sup> Intervistë me Lençe Bajkova, Njësia për banim dhe infrastrukturë, Ministria për transport dhe komunikim, 10 nëntor 2010.

## Problemet e papunësisë dhe ato ekonomike

### **48) Të promovohet pjesëmarrja më e madhe e romëve dhe sintive të kualifikuar në punësimin publik.**

Shteti nikoqir është i zotuar për ta ndjekur parimin e përfaqësimit të drejtë në administratën publike në të gjitha nivelet, sipas detyrave të ndërmarra nga OFA. 2.66% e të punësuarve në sektorin publik duhet të jenë rom – gjë e cila duhet të jetë në përputhshmëri me numrin zyrtarë të romëve në shtetin nikoqir.<sup>50</sup> Meqenëse mbikqyrja e administratës publike (përafërsisht 130,000 punonjës në shtet) është një vështirësi e madhe dhe shërbimi publik nuk do të rregullohet deri në pranverë të 2011,<sup>51</sup> Sekretariati për implementimin e Marrëveshjes kornizë të Ohrit (SIOFA) deri më tani është fokusuar kryesisht në përfaqësimin e drejtë në shërbimin civil (rreth 10,000 punonjës). Në të kaluarën SIOFA, gjithashtu fokusoheshte në polici dhe ushtri.

Sipas Nexhdet Mustafa, ministër pa resor, përqindja e romëve të punësuar në administratën publike është rritur nga 0.1% në 2000, deri më 0.6% në 2010,<sup>52</sup> gjë e cila tregon se ka përmirësime të vogla gjatë dekadës së fundit. E cituar në një studim të fundit të OSI-it, SIOFA pohon se niveli i punësimit të romëve në shërbimin publik është rreth 0.62%.<sup>53</sup> Mungesa e të dhënave të përpikta i kufizon analizat e detajuara të kësaj tendence. Plani veprues për punësim 2009-2011 (Dekada për përfshirjen e romëve) ka për qëllim që të përfshijë 50 romë tepër me arsim universitar në administratën publike deri në 2011. Një hap pozitiv u bë në shtator të vitit 2010, kur SIOFA rekrutoi 250 nëpunës shtetëror të komuniteteve romë dhe turke.

Sipas pohimit në Raportin vjetor 2009 të Avokatit të popullit, numri i romëve të punësuar si nëpunës shtetëror është shumë më i vogël se sa i nevojshmi prej 2.66%. Në këtë të fundit, gjithashtu konkludohet se ‘disa institucione nuk e kanë arritur nivelin e nevojshëm të përfaqësimit’ dhe se parimi i përfaqësimit adekuat dhe të drejtë duhet të promovohet edhe më tej.<sup>54</sup> Kjo gjithashtu u përmend në 2009 Raporin e progresit të BE-së ku drejtëpërdrejtë është përmendur nën-përfaqësimi i romëve.<sup>55</sup> Disa udhëheqës politik romë, përfshirë edhe Nexhdet Mustafa, qëndrojnë në atë se romët e kualifikuar preferojnë të punësohen në OJQ dhe kjo është një nga pengesat kyçe sa i takon përfaqësimit të romëve në shërbimin publik.<sup>56</sup> Përderisa pagat dhe perspektivat më të mira për zhvillim të karrierës janë një faktor përcaktues, i cili i motivon romët e ri për t’ju bashkangjitur sektorit të OJQ-ës, në anën tjetër transparenca më e madhe në punësim dhe rrugët për zhvillim të karrierës në sektorin publik mund ti inkurajojnë romët e kualifikuar që ti bashkangjiten administratës publike. Progresi në reformat e administratës publike do ta shkaktojë zhvillimin pozitiv në punësimin publik të romëve.

<sup>50</sup> Regjistrimi i popullësisë në 2002.

<sup>51</sup> Ligji për shërbim publik u miratua në pranverë të 2010 dhe do të hyjë në fuqi një vit pas miratimit.

<sup>52</sup> Decade Watch MK 2010 Konferencë, 15 tetor 2010.

<sup>53</sup> Stephan Müller & Zeljko Jovanovic, “Pathways to Progress? The European Union and Roma Inclusion in the Western Balkans”, OSI botim, prill 2010, f. 38.

<sup>54</sup> Avokati i popullit, Raporti vjetor 2009, f. 29.

<sup>55</sup> The Former Yugoslav Republic of Macedonia – 2009 EU Progress Report, f. 21.

<sup>56</sup> Stephan Müller & Zeljko Jovanovic, “Pathways to Progress? The European Union and Roma Inclusion in the Western Balkans”, f. 34.

Edhe përpos të disa zhvillimeve pozitive, numri i nëpunësve shtetëror romë në disa institucione, posaçërisht në institucionet e sistemit gjyqësor, mbetet i vogël.<sup>57</sup> Përfaqësimi i zmadhuar më veti nuk është i mjaftueshëm: shpërndarja nëpër sektore dhe në pozita duhet gjithashtu të merret në konsiderim. Ligji për nëpunës shtetëror është instrumenti kryesor për realizimin e objektivës për përfaqësim të drejtë dhe është e rëndësishme që më tej të përforcohet. Kjo është një sferë kyçe për përfshirjen e vazhdueshme të OSBE-së në përkrahjen e SIOFA-s.

**49) Krijimi i programeve të cilat do ti përgatisin grupet e nën-përfaqësuar siqë janë romët dhe sintit në administratën publike në nivel lokal dhe sfera të tjera, si dhe të krijohen politika të cilat do ta inkurajojnë punësimin si nëpunës shtetëror të atyre të cilët do të diplomojnë përmes këtyre programeve.**

Nuk ka programe trajnuese specifike për para-shërbim për përfshirjen e grupeve të nën-përfaqësuar në administratën publike lokale të cilat ofrohen nga shteti nikoqir. Arsimi formal është institucioni kryesor i cili i përgatit nëpunësit e ardhshëm shtetëror. Iniciativat trajnuese nga vepruesit ndërkombëtar, duke përfshirë edhe OSBE-në janë ekzistuese. Duhet të bëhet më shumë në krijimin e mekanizmave të institucionalizuar për ti përgatitur nëpunësit e ri shtetëror nga grupet e nën-përfaqësuar.

Në aspekt të procesit të decentralizimit, OSBE-ja ka organizuar sesione trajnuese për përfaqësuesit dhe të punësuarit në nivel komunal, duke përfshirë edhe përfaqësues romë nga Shuto Orizareja. Një studim më i ri i projektit të OSBE-së, i cili i synon nëpunësit e ri shtetëror në pozita të bashkëpunëtorëve të ri do tu mundësojë atyre trajnim bazik për aftësi fillestare dhe çështje të administratës publike. Në fazën e parë të projektit janë përfshirë 3 nëpunës shtetëror rom. Parashihet që deri më nëntor të vitit 2011 të trajnohen 15 romë të tjerë.

**50) Të rivlerësohet ndikimi i programeve të subvencionuara për punësim, duke u kushtuar vëmendje të posaçme komponentave edukuese të tyre, për tu siguruar se këto do të kenë për qëllim që ta rrisin aftësinë e romëve dhe sintive në tregun e punës.**

Sipas analizave të tregut të punës dhe tendencave të punësimit, shteti nikoqir e miratoi Strategjinë kombëtare për punësim 2006-2010, në bazë të cilës janë krijuar Planet kombëtare për veprim. Plani veprues 2009-2010, pason pas vlerësimit të Planit veprues 2006-2010, ku në bazë të arritjeve të kaluara janë përcaktuar edhe prioritetet e reja. Edhe pse nuk kanë fokus të posaçëm mbi romët, këto dokumente i përfshijnë ato mes politikave synuese dhe veprimeve të qëlluara për popullësinë në përgjithësi ose për grupet e prekshme.

As dokumentet paraprakisht të përmendura, as Plani veprues për punësim i rishqyrtuar i Dekadës për përfshirje të romëve (2009-2011) nuk e vlerësojnë ndikimin e programeve për punësim të subvencionuara dhe të komponentës së tyre arsimuese mbi punësimin e romëve. Përpos identifikimit të disa barrierave për punësim (p.sh. nivelet arsimuese, papunësia afat-gjate), shkaqet për pjesëmarrjen e kufizuar të romëve në programet punësuese të subvencionuara nga MPPS nuk janë hetuar në thellësi dhe as po janë trajtuar.

---

<sup>57</sup> Shih studimin e Avokatit të popullit për zbatimin e rekomandimeve për përfaqësim të përshtatshëm dhe të drejtë dhe diskriminim, i përgatitur në shkurt 2010.

**51) Të krijohen politika dhe programe të cilat do të përfshijnë trajnim profesionalizues për ti përmirësuar aftësitë për në treg dhe punësimin e romëve dhe sintive, në veçanti të personave të rinj dhe grave.**

MPPS përpilon Plane vjetore operative për programe dhe masa aktive për punësim. Qytetarët romë janë të përfshirë edhe si përfitues të të dyja masave të cilat synojnë të gjithë popullësinë (të cilat mund të përfshijnë masa të cilat synojnë grupet e prekshme) dhe programet specifike për romët. Kategoria e parë përbëhet nga dy masa ku përfshihen pjesëmarrës romë. E para është *Programi për vetëpunësim*. Ky program ishte në dobi të 14 qytetarëve romë të papunësuar në 2009, nga numri i përgjithshëm i 700 pjesëmarrësve, të cilët fituan materiale me vlerë prej 3,000 € për fillim të biznesit. E dyta është, *Regjistrimi i biznes programit*, ku gjithashtu kishte përfshirje të vogël të pjesëmarrësve romë (5 njerëz).

E vetmja masë aktive specifike për romët është *Programi për përkrahje të punësimit të romëve*. Kishte për qëllim që ti mundësoj 50 romë në 2010, me aftësi për të punuar me gips, duke ju ofruar mundësinë për tu punësuar në një fabrikë pas periudhës edukues dhe 3 muajve të periudhës trajnuese. Vetëm një grusht njerëzish u regjistruan në 2010,<sup>58</sup> edhe përpos të përpjekjeve të MPPS për ti përfshirë RIC në promovimin e thirrjes së hapur për aplikues. Nëse merret parasysh se në shtator të 2010, Agjencia kombëtare për punësim numroi 16,695 romë të papunësuar,<sup>59</sup> shumica prej të cilëve do të pritet që të shprehin interes për trajnimet e tilla, shkaqet për mungesën e pjesëmarrjes duhet të analizohen.

Hetimi i shkaqeve për suksesin e kufizuar të këtyre masave aktive do ta mundësojë dizejnimin më të mirë të programeve për punësim, të qëlluara për rritjen e përfshirjes së romëve dhe konkurrencës së tyre në tregun e punës (në përputhshmëri me Rec. 50).

Ende nuk janë krijuar politika specifike për rritjen e aftësive punësuese të grave dhe të rinjve romë. Gratë rome janë të përfshira në programet kryesore për punësim, të mundësuar nga shteti nikoqir (p.sh. masa për rehabilitimin e viktimave të dhunës familjare) dhe institucionet ndërkombëtare (p.sh. projekti i BE-së *Gratë në ekonominë maqedonase*, i cili synon ‘komunitete të ndryshme etnike’).<sup>60</sup> Më tutje, lidhja mes arsimit dhe punësimit është anëshkalar edhe përpos të zotimeve për ti ndjekur Udhëzimet e integruara për punësim nga BE-ja.<sup>61</sup> Bashkëpunimi mes institucioneve mund të përforcohet me qëllim që të përfshihen romët e paarsimuar (pa arsim fillor) në tregun e punës ose sigurimi i qasjes së tyre në programet arsimuese.

**52) Të miratohen politika sociale të cilat do të nxisin kërkesën e punës, si një mënyrë e qëndrueshme për t’ju shmangur varësisë së beneficioneve sociale.**

Edhe pse nuk ka të dhëna të besueshme për numrin e qytetarëve romë të cilët marrin beneficione sociale, vlerësimet tregojnë se një numër shumë i madh i tyre marrin asistencë shtetërore. Rreth 90% të familjeve nga komuna e Shuto Orizares vlerësohet se janë shfrytëzues të këtyre ndihmave. Nëse merret parasysh se, sipas të dhënave të fundit lidhur me papunësinë e regjistruar në shtet, 16,695 romë janë të papunësuar, nuk është befasuese ajo që aq shumë qytetarë romë janë shfrytëzues të ndihmave sociale. Krahasuar me romët e papunësuar të regjistruar në

<sup>58</sup> 2 në Shkup dhe 5 në Gostivar, dy komunat e vetme ku organizohet ky trajnim.

<sup>59</sup> Ueb-faqja e Agjencisë kombëtare për punësim e Republikës së Maqedonisë (www.avrm.gov.mk).

<sup>60</sup> European Initiative for Democracy and Human Rights (EIDHR), 2008. Informata u dha nga Elvis Ali, Kontakt për çështje rome, Delegacioni i BE në Shkup, Intervistë më 3 nëntor 2010.

<sup>61</sup> Strategjia kombëtare për punësim, f. 4.

dhjetor 2003 (16,937), numri nuk është zvogluar shumë, në krahasim me numrin e përgjithshëm të papunësuarve të regjistruar (prej 390,361 në dhjetor 2003 deri më 323,233 në shtator 2010).<sup>62</sup>

Një pengesë e madhe për kërkesën aktive për punësim është përfshirja në ekonominë e zezë. Programe për ti legalizuar bizneset janë miratuar nga MPPS dhe vetëm një grusht i qytetarëve romë kanë aplikuar për të njejtat. As kjo, as fakti se asistenca financiare për mirëqenie është shumë e ulët (baza, sipas Ligjit për mbrojtje sociale në 2009 është 2,140 MKD) nuk mund të kontribuojnë në uljen e shkallës së papunësisë, aq sa mund të ndikojë krijimi i më shumë mundësive për punësim, për personat e paftësuar ose shumë pak të aftësuar.

### Kujdesi shëndetësor

#### ***58) Të mundësohet qasja e romëve dhe sintive në shërbimet e kujdesit shëndetësor në bazë jo-diskriminuuese.***

Sipas amandmaneve të Ligjit për kujdes shëndetësor në prill 2009, kujdesi shëndetësor primar tani është i siguar për të gjithë qytetarët e shtetit nikoqir. Të gjithë qytetarët romë, nëse janë të regjistruar dhe kanë dokumente personale mund ti përdorin strukturat e kujdesit primar shëndetësor falas.<sup>63</sup>

Megjithatë, një propozim ligj nga Ministria për shëndetësi në nëntor 2010, kërcnohet që ta ndryshojë këtë praktikë. Është ende e paqartë se çfarë do të shkaktojnë rregullat e reja dhe cilat do të jenë pasojat e propozimit. Pritet që pakoja bazike shëndetësore të reduktohet në një gamë minimale të shërbimeve.<sup>64</sup> Grupet e prekshme mund disproporcionalisht të vuajnë nëse nuk parfshihen këto masa.

Sidoqoftë pengesat për qasjen e romëve në shërbimet e kujdesit shëndetësor mbesin. E para, vlerësohet se 3,000 deri më 5,000 njerëz nuk kanë qasje në sigurim shëndetësor për shkak të dokumenteve personale.<sup>65</sup> Pengesë më të madhe për qasjen në sigurim shëndetësor paraqesin procedurat administrative. E dyta, mungesa e paisjeve për kujdes shëndetësor bazik në vendet e banuara me rom dhe shpenzimet për transport të ndërlydhura me qasjen në kujdes shëndetësor i vendosin qytetarët më të prekshëm romë në disavantazh, sa i takon qasjes në paisjet shëndetësore. Komuna e Shuto Orizares, shtëpi për 13,342 romë nga numri i përgjithshëm i banorëve prej 22,017 sipas regjistrimit të fundit të popullësisë më 2002,<sup>66</sup> ka mungesë të shërbimeve bazike shëndetësore (p.sh. klinikë gjinekologjike) dhe ofron vetëm shërbime ambulancore. Shërbime bazike shëndetësore të kufizuara ofrohen nga OJQ Hera (gjinekolog me gjysëm orar pune, dermatolog, psikolog etj.). E treta, edhe pse Avokati i popullit nuk raporton raste të diskriminimit të romëve në sektorin e shëndetësisë, aktivistët për të drejta njerëzore dhe OJQ-ët denoncojnë praktika të tilla kundër pacientëve romë.

<sup>62</sup> Agjencia kombëtare për punësim e Republikës së Maqedonisë.  
(<http://www.avrm.gov.mk/?ItemID=7876A4C875B08F43A1CCE7E0B425AA38>)

<sup>63</sup> Shpesh paguhet një shumë për pjesëmarrje deri më 20%.

<sup>64</sup> AITV, 8 nëntor 2010.

<sup>65</sup> Senad Memedi, Ministria për shëndetësi, Sektori për integrim evropian, i intervistuar më 29 tetor 2010.

<sup>66</sup> Besohet se këto të dhëna e nën-vlerësojnë numrin real të banorëve të kësaj komune.



**59) Të promovohet vetëdija për nevojat specifike të popullatës rome dhe sinti mes personelit për kujdes shëndetësor.**

Nuk ka masa specifike të cilat do të mundësojnë që personeli në kujdesin shëndetësor të jetë më i vetëdijshëm për nevojat specifike të pacientëve romë. Edhe pse është paraparë si një nga qëllimet e Planit veprues të revizionuar 2009 të Dekadës, edukimi i punonjësve shëndetësor për atë se si ma mirë t'ju qasen pacientëve romë dhe për çështjet e tyre specifike ende nuk është mundësuar. Trajtimi i përshtatshëm i pacientëve romë varet nga aftësitë sociale dhe profesionale të personelit të kujdesit shëndetësor. Mund të ndodhin edhe probleme në komunikim, gjë që e bën iniciativën e Ministrisë për shëndetësi lidhur me krijimin e medijuesve shëndetësor romë edhe më shumë të rëndësishme.

**60) Të adresohet paraqitja e sëmundjeve dhe të paushqyerit tek komuniteti rom.**

Kushtet jo-adekuate banuese dhe jetësore të komunitetit rom, si dhe varfëria gjerësisht e shpërndarë, janë mes shkaktarëve rrënjësor për paraqitjen e sëmundjeve dhe të paushqyerit. Vetëm një qasje gjithëpërfshirëse e këtyre çështjeve, mund të sigurojë përmirësime pozitive dhe të qëndrueshme në këtë aspekt.

Masat preventive të ndërlydhura rreptësisht me shëndetësinë, mund të kontribuojnë në lehtësimin e shfaqjes së sëmundjeve dhe të paushqyerit. Imunizimi falas, i disponueshëm edhe për jo-shtetasit, është politika kryesore shtetërore e cila e reflekton këtë pikëpamje dhe duhet të zbatohet më tërthorazi duke siguruar përfshirje më të madhe të sëmundjeve tek popullata rome.

Sa i takon të paushqyerit, gjë e cila ndikon posaçërisht tek fëmijët, vetëm disa nga OJQ-ët mundësojnë asistencë për fëmijët në shkolla (p.sh. Sumnal). Studimi i UNICEF-it për të paushqyerit e fëmijëve thotë se përafërsisht 17% nga fëmijët romë, 'janë shumë ose mesatarisht të paushqyer'.<sup>67</sup>

**61) Të inkurajohet qasja e popullatës rome dhe sinti në shërbimet publike shëndetësore në fazë të hershme përmes:**

**(a) Informimit të romëve dhe sintive për disponueshmërinë e shërbimeve të tilla dhe mënyra se si të përdoren ato;**

Në përgjithësi në shtet ka informata për disponueshmërinë e shërbimeve shëndetësore, për shembull përmes fushatave mediale (p.sh. 2009 promovimi i programit *Sigurim për të gjithë*). Sidoqoftë, shpërndarja e informatave mes popullatës rome është e kufizuar.

Janë duke u shqyrtuar masa specifike për kanalizimin e informatave për qasje në shërbimet shëndetësore mes popullatës rome. RIC mundësojnë informata bazike, mirëpo roli i tyre duhet ende të përforcohet. Vendosja e 16 medijuesve shëndetësor romë është e paraparë për vitin 2011. Nëse shteti i cakton resurset e domosdoshme për projektin e Ministrisë për shëndetësi, kjo mund të jetë një hap përpara, drejt rritjes së vetëdijes së romëve për shërbimet shëndetësore. Medijuesit do të kenë si detyrë aktivitetet përfshirëse, ta zvoglojnë zbrastirën mes qytetarëve dhe institucioneve dhe ta edukojnë popullatën për çështjet bazike shëndetësore.

Për fat të keq, edhe pse Ministria për shëndetësi ka kërkuar 4 milion denarë për këtë aktivitet, buxheti total i përcaktuar për zbatimin e Dekadës në sferën e shëndetësisë për 2011 është 200,000 MKD.<sup>68</sup> Duhet të bëhet rebalans dhe rishqyrtim i buxhetit, me qëllim që ky plan të bëhet operacional.

<sup>67</sup> UNICEF, "Multiple Indicator Cluster Survey 2005-2006", 2007, f. 67.

<sup>68</sup> Intervistë me Senad Memedi, 29 tetor 2010.

Deri sa të ndodhe kjo, veprues të tjerë zbatojnë aktivitete informative. Së pari, Hera e cila ka punësuar 2 medijues romë përmes një pilot projekti, i cili duhet të informojë për pjesëmarrjen shtetërore në ardhmëri në programin e medijuesve romë. E dyta, edhe pse synohet vetëm komuniteti i Shuto Orizares, Qendra rome për resurse (e financuar nga HERA) dhe ambulanca i japin informata bazike popullatës lokale për shërbimet publike. Disa informata të kufizuara, të cilat kryesisht kanë të bëjnë me imunizimin dhe shëndetin fëmijor, jepen në shkollë në rastet kur duhet të bëhet vaksinimi i detyrueshëm. Nivelit i ulët i ndjekjes dhe braktisjet e shpeshta shkollore e kufizojnë efikasitetin e këtyre përpjekjeve. Programet edukuese në media, posaçërisht ato të transmetuesve në gjuhën rome, mund të inkurajohen për ta rritur shpërndarjen e informatave lidhur me shëndetin.

***(b) Të përforcohet besimi i romëve dhe sintive ndaj siguruesve të kujdesit shëndetësor publik, përfshirë përmes: dënimit të diskriminimit të drejtëpërdrejtë dhe jo të drejtëpërdrejtë ndaj romëve dhe sintive; trajnimit të punonjësve shëndetësor për ti kuptuar aspektet relevante të kulturës rome; dhe përkrahja e medijuesve të cilët mund të luajnë një rol të rëndësishëm në zvoglimin e zbrastirës mes komunitetit rom dhe dhënësve të shërbimeve të kujdesit shëndetësor.***

Mungesa e besimit të romëve ndaj institucioneve shëndetësore publike është një nga disa faktorët të cilët e parandalojnë qasjen e tyre në shërbimet shëndetësore. Edhe pse është vështirë që të matet pesha relative e faktorëve të tillë, gjerësisht besohet se financat luajnë një rol shumë më të madh, sesa mungesa e informatave ose besimit.

Avokati i popullit nuk ka raportuar ndonjë rast të diskriminimit ndaj romëve nga ana e dhënësve të shërbimeve shëndetësore edhe pse ndodhitë e të njejtës nuk mund të përjashtohen. Punonjësit shëndetësor nuk janë të trajnuar për ta kuptuar prapavijën sociale dhe kulturore të shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore të cilët u takojnë komuniteteve të ndryshme.

Ministria për shëndetësi, së bashku me MPPS (Njësia për zbatimin e Dekadës) dhe me përkrahje të OJQ-ve Hera dhe FOSIM, është e vendosur për ta inicuar rolin e medijuesve shëndetësor romë në sistemin e kujdesit shëndetësor publik. Një studim i praktikave të mira në regjion (p.sh. Bulgaria) dhe vlerësimi i pilot projektit të zbatuar nga Hera në Shuto Orizare, tregojnë se ky program mund ta zbatohet nëse sigurohen fondet e nevojshme nga qeveria.

Besimi ndaj institucioneve shëndetësore, gjithashtu mund të rritet përmes inkurajimit të romëve të ri për tu regjistruar në arsimin mjekësor. FOSIM, me përkrahjen financiare të REF, deri tani ka qenë i pvrkushtuar në përkrahjen e studentëve romë në mjekësi, duke inkurajuar krijimin e praktikantëve të ardhshëm shëndetësor romë. Pritet që 30 studentë (Fakulteti i mjekësisë ose shkollat e mesme mjekësore) që të përfitojnë nga bursat në 2010-2011.

#### ***62) Ti kushtohet vëmendje e posaçme shëndetit të grave dhe vajzave përmes:***

Përderisa Instituti maqedonas për shëndet të nënave dhe fëmijëve i mbikqyr dhe ka për qëllim që ti miratojë masat parandaluese për të siguruar kujdes para lindjes dhe pas lindjes për të gjithë, nuk ka përpjekje shtetërore për ti trajtuar çështjet specifike të grave rome. Progresi në këtë sferë mvaret më së shumti nga përpjekjet e OJQ-ve.

***(a) Promovimi dhe/ose krijimi i programeve të cilat kanë për qëllim që t'ju sigurojnë informata të gjithëve për kujdesin shëndetësor (duke përfshirë të ushqyerit, kujdes pas lindjes dhe dhunë familjare, etj);***

Informata të pakta për të ushqyerit, jo domosdoshëm të synuara për vajzat, jepen në shkolla, gjatë orëve të parapara për *stilet e shëndosha jetësore*. Nuk është krijuar kurrëfar programi për përfshirje, i cili do të bëjë vajzat dhe gratë më të vetëdishme për çështjet e ndërlidhura me shëndetin e gruas. Në veçanti mungojnë masat preventive. Disa nga OJQ-ët e kanë kompenzuar këtë zbrastirë përmes shpërndarjes së fletushkave dhe organizimin e punëtorive dhe përmes medijuesve shëndetësor romë të cilët mund të kontribuojnë në rritjen e vetëdijes për të ushqyerit, kujdesit pas lindjes dhe dhunës familjare, si dhe të udhëzimit të pacientëve romë tek institucionet relevante.

Informatat bazike për çështjet paraprakisht të përmendura dhe udhëzimi i përshtatshëm tek institucionet duhet të jetë një detyrë e rëndësishme për RIC në shtet. Fundamental do të jetë përforsimi i kapacitetit të tyre për aktivitete parandaluese (përfshirje, rritje e vetëdijes) dhe dhënia e asistencës për gratë romë në qasjen e shërbimeve shëndetësore.

***(b) Përmirësimi i qasjes në kujdesin shëndetësor gjinekologjik, përfshirë shërbimet para lindjes, gjatë dhe pas lindjes përmes informimit dhe trajnimit.***

Vetëm disa gra romë janë të vetëdishme se jo vetëm lindja është falas, por gjithashtu edhe 4 kontrollat dhe 1 ultrazë gjatë shtatëzarisë të cilat mundësohen nga institucionet publike shëndetësore. Që të përdoren këtë mundësi, gratë duhet të jenë të regjistruara në Fondin për sigurim shëndetësor (kërkohen edhe dokumente për nënshtetësi dhe detale të tjera personale). Është e rëndësishme që të sigurohet një regjistrim më i gjërë i romëve dhe shpërndarje më e gjërë e informatave për shërbimet shëndetësore falas të cilat jepen.

Megjithatë, qasja në kujdesin shëndetësor gjinekologjik mbetet një çështje problematike. Së pari, OJQ-ja HERA dhe Znj. Biljana Ançevska, njëherit pedijatër në Shuto Orizare dhe tani e punësuar në Institutin për shëndet të nënave dhe fëmijëve, raportojnë vështirësi për të gjetur personel mjekësor, i cili do të punojë në komunitetin rom. Si rezultat i hezitimit të tillë dhe mungesë të angazhimit qeveritar në këtë çështje, Qendra romë për resurse (HERA) e mundëson qasjen e vetme gjinekologjike në Shuto Orizare. Mundësimi i shërbimeve gjinekologjike në këtë komunë do të sigurojë vetëdije dhe një qasje më të madhe në shërbimet gjinekologjike për komunitetin më të madh rom në vend. Në plotësim, edukimi në veçanti për shëndetin reprodiktiv duhet gjithashtu të shqyrtohet nga institucionet arsimuese dhe organizatat romë (RIC, OJQ).

***63) Ti kushtohet kujdes i veçantë shëndetit të fëmijëve romë dhe sinti përmes mundësimit të kujdesit adekuat pedijatrik, përfshirë edhe masa preventive, siqë është ofrimi i vaksinimit në vendbanimet romë.***

Shteti nikoqir garanton imunizim universal falas. 11 inekcione duhet ti jepen çdo fëmije në moshën parashkollore dhe disa tjera shtesë duhet të jepen në shkollën fillore.

Edhe pse nuk ka të dhëna zyrtare për përfshirjen në imunizim sipas përkatësisë etnike, një studim aktual i organizuar nga Meseçina, i bashkëndarë me Institutin për shëndet të nënave dhe fëmijëve tregon se imunizimi është larg nga të qenit universal për fëmijët romë dhe është shumë më i vogël se sa tek maqedonasit etnik.<sup>69</sup> Është bërë një progres shumë i vogël.

<sup>69</sup> UNICEF, "Multiple Indicator Cluster Survey 2005-2006", 2007, f. 32.

Në veçanti brengosës është niveli i ulët i imunizimit të vajzave pas klasës së 5 të shkollës fillore, gjë e cila tregon për regjitrimin e ulët në arsim. Nivelet e ulta të ndjekjes së shkollës, të cilat janë më të larta se shkalla e braktisjeve mesatare kombëtare, keqinformimi i prindërve ose mungesa e interesit për programet imunizuese dhe vështirësitë për ti gjetur fëmijët dhe familjet e tyre që të ftohen për vaksinim, janë mes pengesave kryesore të cilat duhet të tejkalohen. Theks më i madh duhet të vendoset në bashkëpunimin me shkollat dhe në mundësimin e informimit efektiv në rastin e vaksinimit të parë në shkollën fillore, ku do të ketë prezent një anëtarë nga familja e fëmiut.

## **Kapitulli V i PV– Përmirësimi i qasjes në arsim**

**67) Të mundësohet që legjislacioni kombëtar të përfshijë ligje të përshtatshme të cilat do ta ndalojnë segregimin racor dhe diskriminimin në arsim, dhe të cilat do të mundësojnë korrigjime efektive për shkeljen e legjislacionit të tillë.**

Legjislacioni kombëtar në shtetin nikoqir përmban rregulla të cilat e ndalojnë *diskriminimin* në arsim, në baza racore dhe etnike. Korniza relevante ligjore rangohet nga *Ligji për arsim fillor* (neni 2 (2)) dhe *Ligji për arsim të mesëm* (Neni 3) deri tek *Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi* (i cili duhet të fillojë të zbatohet nga 1 janar 2011). Dokumentet ndërkombëtare ngërthyesë, të ratifikuara nga shteti nikoqir (p.sh. Konventa për të drejtat femënore e KB) e theksojnë karakterin falas dhe të detyrueshëm të arsimit fillor, relevant sa i takon qasjes në arsim.

Legjislacioni kombëtar parasheh sanksione për shkollat primare ku ndodh diskriminimi (*Ligji për arsim fillor, neni 172*), si dhe instanca tjera të diskriminimit (*Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, kapitulli VII*). Kodi penal mbetet baza për trajtimin e shkeljeve në sferën e diskriminimit (p.sh. krimet e urrejtjes).

Çështja e efikasitetit të rregullave të tilla është e vështirë për tu vlerësuar për shkak të tre shkaqeve. Së pari, mungon definimi adekuat për atë se cilat veprime do të merren si diskriminim në shkolla, gjë e cila i bën rastet diskriminuese të vështira për tu identifikuar dhe raportuar. E dyta, nuk është bërë kurrëfar denoncimi për diskriminim ndaj fëmijëve romë në arsim në mënyrë zyrtare, as po hetim edhe përpos të referencave për diskriminim.<sup>70</sup> E treta, krijimi i Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi do të mundësojë depërtim më të thellë në zbatimin aktual të legjislacionit për diskriminim me fillim në 2011. Drejtori i Drejtoratit për zhvillim dhe promovim të arsimit në gjuhën e komuniteteve<sup>71</sup> konfirmoi se janë shpërndarë informata për ligjin e ri për antidiskriminim nëpër shkolla dhe se janë organizuar trajnime për inspektorët e shkollave.<sup>72</sup>

Brenga të ngjajshme janë hedhur edhe sa i takon çështjes së *segregimit* në arsim. Nuk ka referencë të përpiktë për veprimet e tilla ose për ndalimin e tij në legjislacionin kombëtar. Termi sapo ka filluar të përdoret nga zyrtarët shtetëror.<sup>73</sup> Studime nga Instituti shoqëria e hapur<sup>74</sup> dhe Decade Watch,<sup>75</sup> si dhe Strategjia kombëtare për përfshirje të romëve,<sup>76</sup> e identifikojnë ndarjen në arsim si problem i cili i prek fëmijët romë.

<sup>70</sup> ECMI i cituar në OSI, “Equal Access to Quality Education”.

<sup>71</sup> Prej tani e tutje: “Drejtor”.

<sup>72</sup> Intervistë me Rexhep Ali Çupi, 16 shtator 2010.

<sup>73</sup> Intervenim nga drejtori Rexhep Ali Çupi në konferencën për promovimin e Decade Watch MK 2010, 22 tetor 2010.

<sup>74</sup> FOSIM, “Equal Access to Quality Education”, f. 213.

<sup>75</sup> InSoC, “Decade Watch MK 2010”, f. 20.

<sup>76</sup> MPPS, “Strategjia rome në Republikën e Maqedonisë”, dhjetor 2004, f. 42.

Një përqindje e madhe jopropocionale e fëmijëve romë janë vlerësuar si fëmijë me nevoja të posaçme dhe janë të ndarë në klasa ose shkolla speciale. Kërkesa për transfer të fëmijëve në klasa të tilla mund të inicohet nga mësuesit, në rast se fëmijët shfaqin pamundësi për ta kuptuar programin mësimor, ose këkesa mund të bëhet edhe nga prindërit e tyre. Rasti shqyrtohen nga një komision i cili vendos për miratimin e transferit. Shpeshtia e kësaj praktike tregon për mungesat gjatë vlerësimit për statusin e nevojave të posaçme.<sup>77</sup> (Shih Rec. 73). Edhe pse rregullat ligjore të cilat e ndalojnë segregimin mungojnë,<sup>78</sup> disa përpjekje desegreguese/përfshirëse kanë filluar që të ndërmerren. Si shembull, mund të merren projektet e vogla *Përfshirja e fëmijëve me nevoja të posaçme në shkollat e rregullta* të Ministrisë për arsim dhe shkencë (MASH).

**68) Të konsultohen përfaqësuesit e romëve dhe sintive gjatë dizenjimit të politikave arsimore të cilat ndikojnë mbi ta.**

Drejtori pohon se MASH rregullisht i konsulton përfaqësuesit e shoqërive civile rome.<sup>79</sup> Duke pasur kontakte të drejtëpërdrejta me qytetarët romë dhe vetëdije shumë të mirë për nevojat e tyre, OJQ-ët janë bashkëpunëtorë adekuat për MASH gjatë dizenjimit të politikave dhe programeve arsimore. Fondi për arsim të romëve (REF) mes tjerave, shpesh financon dhe zbaton projekte të përkrahura nga qeveria, në veçanti sa i takon arsimit parashkollor, mentorimit dhe trajnim të mësuesve.<sup>80</sup> MASH ju drejtohet OJQ-ve rome në veçanti kur ka nevojë për të dhëna dhe raporte për gjendjen në terren.

Përderisa informatat për nevojat e qytetarëve romë i transmetohen MASH përmes OJQ-ëve lokale, niveli i njejtë i pronësië dhe mirëkuptimit të nevojave rome nuk garantohet përbrenda institucioneve të sektorit arsimor. Përbrenda Drejtoratit një këshill i përbërë nga një përfaqësues prej secilit komuniteti pakicë<sup>81</sup> jep këshilla për çështjet arsimore të pakicave. Pozita e rezervuar për një qytetarë romë në moment nuk është plotësuar dhe perspektivat për një emërim më të shpejtë janë të zbehta. Enti për zhvillimin e arsimit (EZHA), organ përbërës për krijimin e programit mësimor me fuqi të madhe për ta formuluar procesin e mësimin, si dhe Inspektorati arsimor gjithahstu nuk kanë përfaqësues romë. Kjo mund të pasojë në mangësi për ta përshtatur programin arsimor në pajtim me ndjeshmërinë kulturore të popullatës rome.

**69) Aktivisht të promovohen mundësi të barabarta në sferën e arsimit për fëmijët romë dhe sinti, në veçanti duke ju mundësuar atyre asistencë lidhur me gjuhën ose ndonjë lloji tjetër.**

Shteti nikoqir, kushtetuta e të cilit thotë se ‘secili ka të drejtën që të arsimohet nën kushte të barabarta’,<sup>82</sup> është formalisht i zotuar për të garantuar mundësi të barabarta arsimore për të gjithë. Secili komunitet e ka të drejtën ta ndjekë arsimin në gjuhën amë. Megjithatë, romët nuk e praktikojnë këtë të drejtë dhe ju bashkangjiten klasave ku arsimit jepet në gjuhën maqedonase dhe disa herë edhe në shqip dhe turqisht. Kjo ka të bëjë me meungesën e mësuesve të kualifikuar romë dhe disponueshmërinë e librave në gjuhën rome. Si pasojë, fëmijët romë shpesh ballafaqohen me vështirësi gjuhësore në vitet e hershme të arsimit fillor, posaçërisht ato të cilët flasin gjuhën rome

<sup>77</sup> REF, “Advancing education of Roma in Macedonia – Country Assessment and the Roma Education Fund’s Strategic Directions”, 2007, f. 28.

<sup>78</sup> Segregimi në arsim është në konflikt me të drejtën (në moment jo e praktikuar nga romët) për ta ndjekur arsimin në gjuhën e komuniteteve pakicë.

<sup>79</sup> Intervistë me Rexhep Ali Çupi, 16 shtator 2010.

<sup>80</sup> Në bashkëpunim me MASH, Qendra kombëtare rome krijoi një manual trajnues për antidiskriminim për mësuesit; përmban gjithashtu një skemë për mentorim.

<sup>81</sup> Komunitetet serbe, bosnjake, turke, vllehe dhe rome janë të përfshira.

<sup>82</sup> Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Art. 44.

në shtëpi. Kjo rezulton në shkalla të mëdha të braktisjes së shkollës edhe përpos të asaj se arsimit fillor dhe i mesëm janë të detyrueshëm, si dhe në transfer të shpeshtë të fëmijëve romë në klasat e fëmijëve me nevoja të posaçme.<sup>83</sup> (Shihni gjithashtu Rek. 73 dhe 75).

Edhe pse MASH e njeh këtë gjendje,<sup>84</sup> nuk ka programe sistematike për asistencë gjuhësore. Shenjat inkurajuese sa i takon promovimit të mundësive të barabarta në arsim për fëmijët romë, me fokus të posaçëm në çështjet e ndërlidhura me gjuhën, janë të dukshme. Së pari, MASH tregon shenja të zotimit për ti përkrahur projektet e OJQ-ve, siqë është *Projekti për medijues* i Qendrës kombëtare rome, përmes të cilit ofrohet asistencë mësimore pas orëve shkollore për fëmijët romë në Shkup dhe Kumanovë, që nga viti 2005. E dyta, në Fakultetin filologjik, u krijuar lëndë zgjedhore *Gjuha dhe kultura rome* më 2010/2011. Nëse bëhet funksionale në ardhmëri,<sup>85</sup> kjo duhet ti zmadhojë perspektivat për krijimin e mësuesve të ardhshëm, si dhe mësues të vetëdijshëm për kulturën rome. Kjo nga aspekti tjetër mund ti përforcojë perspektivat për një arsim multikulturor dhe ulje të paragjyqimeve dhe diskriminimit në shkolla. Një zhvillim i tretë pozitiv në këtë aspekt është fokusi mbi arsimin parashkollor përmes projektit të MPPS, *Përfshirja e fëmijëve romë në arsimin parashkollor*. Ky i fundit, filloi më 2006/07 dhe ende po vazhdon, duke përfshirë vetëm një numër të kufizuar nga numri i përgjithshëm i fëmijëve romë të moshës parashkollore.<sup>86</sup> Projekti i REF-it, *Një fillimi i mbarë*, i inicuar në 2010, kontribon në zgjerimin e përfshirjes në arsimin parashkollor.<sup>87</sup>

Kushtet e ulta socio-ekonomike janë një pengesë për ndjekjen e arsimit, gjë e cila vetëm pjesërisht trajtohet. Politika më e fundit për të mundësuar transport për fëmijët të cilët jetojnë më larg se 2 km nga shkolla dhe librat falas për të gjithë nxënësit duhet në veçanti të dobishme për anëtarët e komunitetit rom. Zbatimi dhe rezultatet e këtyre dy politikave mbetet që të analizohen.<sup>88</sup> Ato paraqesin një parakusht të domosdoshëm për lehtësimin e faktorit ekonomik, si shkak për regjistrimet e ulta në shkolla.

Një zhvillim pozitiv është vendimi i MASH, për ta ndërmarrë programin e bursave nga FOSIM për fëmijët romë të shkollave të mesme nga 2009/2010, të përkrahur nga REF. Brengosëse janë vonesat e MASH në zbatimin e tij.<sup>89</sup> Programi i FOSIM-it, së bashku me reformat e bëra në arsimin e mesëm, me të cilat ai u bë i detyrueshëm në 2008, raportohet se kanë kontribuar në rritjen e regjistrimeve dhe avoglimit të braktisjeve nga ana e studentëve romë në fillim të arsimit të

---

<sup>83</sup> REF vlerëson se reth 27% të fëmijëve të regjistruar në shkollat ose klasat e posaçme janë rom. Shihni ref, "Advancing education of Roma in Macedonia – Country Assessment and the Roma Education Fund's Strategic Directions", 2007, f. 31.

<sup>84</sup> Drejtorati, "Gjendja aktuale në arsimin fillor e nxënësve të cilët u takojnë bashkësive etnike në Republikën e Maqedonisë", f. 57.

<sup>85</sup> Procedurat administrative dhe zhvillimi i programit mësimor kanë lejuar krijimin e lëndës më 2010-2011. Regjistrimi dhe ligjeratat për këtë lëndë ende nuk janë hapur.

<sup>86</sup> Sipas të dhënave nga MPPS, 211 studentë kanë përfituar nga ky program më 2006/07, 226 në 2007/08, dhe 241 në 2008/09. Qëllimi për 2009/11 ishte që të përfshihen 777 nxënës, edhe pse sipas gjasave ky numër do të jetë më i vogël nga i synuari.

<sup>87</sup> Duhet patur ndërmend se ekzistojnë edhe disa programe të tjera në sferën e arsimit parashkollor, të mundësuar nga veprues të tjerë (FOSIM/USAID, REF, disa OJQ lokale).

<sup>88</sup> Të dhënat shtetërore për fëmijët të cilët kanë përfitim nga transporti falas në arsimin fillor janë të disponueshme në [http://www.stat.gov.mk/english/publikacii\\_eng/PublikaciiGlavna\\_eng.htm](http://www.stat.gov.mk/english/publikacii_eng/PublikaciiGlavna_eng.htm) (2007/08, 2008/09, 2009/10). Botimi i njejtë jep edhe të dhëna për librat falas për 2007/08 dhe 2008/09.

<sup>89</sup> Intervistë me Spomenka Lazarevska, FOSIM, 16 shtator 2010.

mesëm.<sup>90</sup> Drejtorati raporton se është bërë një rritje prej 57.5% në numrin e studentëve romë të përfshirë në arsimin e mesëm nga 2005 deri më 2010.<sup>91</sup>

**70) Të ndërmerren masa të posaçme për ta përmirësuar kualitetin dhe efikasitetin e arsimit për fëmijët romë dhe sinti. Të inkurajohet pjesëmarrje më e madhe e romëve dhe sinti si mësues/e në shkolla.**

Mundësimi i asistencës lidhur me gjuhën dhe skemat e tjera mentoruese për fëmijët romë është kyçe për përmirësimin e kualitetit dhe efikasitetit të arsimit të tyre. Mbajtja e romëve në arsim, në vend të zbatimit të praktikës së shpeshtë të vendosjes së tyre në klasa të posaçme, do ti përforcojë mundësitë e tyre për të përfituar nga arsimi efikas dhe do të kontribuojë në perspektivat e tyre të ardhshme për punësim. Ekzistojnë edhe disa programe mentoruese të OJQ-ve dhe donatorëve, të cilat disa herë e përfshijnë MASH i pasrtner, mirë po janë të kufizuara në aspekt të qëllimit.

Përfaqësimi i romëve si mësues në shkolla do të shërbejë për uljen e paragjykimeve në shkolla dhe do të sigurojë sensibilizim kulturor për çështjet të cilat ndikojnë mbi fëmijët romë. Kjo do të ketë efekte pozitive mbi ndjekshmërinë dhe uljen e braktisjeve shkollore. Më tej, në afat më të gjatë do ta mundësojë komunitetin rom për ta realizuar të drejtën e tij për arsim në gjuhën rome.

Romët etnik momentalisht përfaqësojnë rreth 0.16% nga personeli i përgjithshëm mësimdhënës në shkolla.<sup>92</sup> Bursat universitare për studentët romë,<sup>93</sup> në plotësim të krijimit të lëndës zgjedhore për gjuhën rome në Fakultetin filologjik, janë masa pozitive. Stimulues (p.sh. mjete financiare, kuota) për ti joshur romët e rinj, për të zgjedhur profesionin e arsimtarit mungojnë. Përforsimi i nivelit arsimues mes të rinjve romë do ti përforcojë mundësitë për krijimin e arsimtarëve romë në ardhmëri.

**71) Të përfshihet historia dhe kultura rome në tekstet shkollore, duke i dhënë theks të posaçëm eksperiencës të cilën e kanë pasur romët gjatë Holokaustit.**

Historia dhe kultura rome nuk është përfshirë adekuatshëm në materialet shkollore, qoftë në lëndën e historisë, arsimit qytetarë ose në tekstet e letërsisë. FOSIM vlerëson se përfshirja e historisë dhe kulturës rome paraqitet në përafërsisht 1.7% të faqeve në librat shkollor.<sup>94</sup> Një botim i UNICEF-it për multikulturalizmin në shkolla e thekson natyrën stereotipike të përshkrimit të kulturës rome në librat e shkollës fillore.<sup>95</sup> Duhet të theksohet se përfaqësimi i drejtë i grupeve etnike në librat shkollor në përgjithësi është problem i cili nuk ka të bëjë vetëm me romët. Ato nuk zënë ndonjë vend të rëndësishëm në tekstet shkollore, as po eksperiencia e romëve prej Holokaustit e deri më sot është përfshirë.

Njëherit fakultative dhe tani lëndë zgjedhore, *Gjuha dhe kultura rome*, në shkollat fillore jep informata për historinë dhe kulturën rome, mirëpo i synon vetëm nxënësit rom.

<sup>90</sup> Intervistë me Spomenka Lazarevska, FOSIM, 16 shtator 2010.

<sup>91</sup> Të dhënat zyrtare janë mundësuar nga drejtori Rexhep Ali Çupi, 22 shtator 2010.

<sup>92</sup> Drejtorati, “Gjendja aktuale në shkollat fillore e nxënësve të cilët u takojnë komuniteteve etnike në Republikën e Maqedonisë”, qershor 2010, f. 55.

<sup>93</sup> Për më tepër informata lidhur me programet bursiste universitare shihni Rec. 82.

<sup>94</sup> Intervistë me Spomenka Lazarevska, FOSIM, 16 shtator 2010.

<sup>95</sup> UNICEF, “Multikulturalizmi dhe marrëdhëniet etnike në arsim”, 2007.

Në këtë kontekst, tepër i rëndësishëm është zotimi i MASH në ndërmarrjen e ‘Hapave drejtë arsimit të integruar në sistemin arsimor në Republikën e Maqedonisë’.<sup>96</sup> MASH pranon se ka konflikt mes të drejtës në arsim në gjuhën amë dhe mungesës së vazhdueshme të dijenisë dhe bashkëveprimit të ndërmjetshëm mes grupeve etnike, gjë e cila është e çuditshme në se merret parasysh karakteri multietnik i shoqërisë. Duke i ndjekur rekomandimet e Komisionerit të lartë për pakica kombëtare të OSBE-së në 2008, MASH filloi që ta rishqyrtojë programin shkollor me qëllim që fëmijët të mësojnë për të gjitha komunitetet të cilat jetojnë në shtetin e tyre. Zbatimi i plotë i programit të ri shkollor parashihet që të fillojë nga viti shkollor 2014/15.

**72) Të merren në konsiderim masa të cilat do të mundësojnë respekt, mbrojtje dhe promovim të gjuhës rome dhe mësimin të saj dhe të kulturës rome, si pjesë integrale e pasurisë kulturore të rome dhe sintive.**

Shteti nikoqir e futi në përdorim lëndën zgjedhore *Gjuha dhe kultura rome* në programin shkollor të shkollave fillore që nga viti akademik 2008/09. Ky është një hap i rëndësishëm në sigurimin e mbrojtjes dhe promovimit të pasurisë kulturore të romëve.

Me qëllim që ky mjet i vlefshëm të bëhet edhe më efektiv, duhet tu kushtohet kujdes dy prioritetëve për në ardhmëri. E para, përfshirja aktuale e kësaj lënde zgjedhore gjatë mësimdhënies duhet të zgjerohet. Deri tani 6 shkolla fillore kanë dhënë mësim në këtë lëndë për 2191 nxënës romë (79.3% nga numri i përgjithshëm i nxënësve romë në ato shkolla). 3 shkolla tjera do ta ofrojnë këtë lëndë në 2010/2011,<sup>97</sup> edhe pse 28 shkolla i kanë përmbushur kushtet për organizimin e këtyre orëve.<sup>98</sup> Disa studentë romë nuk e ndjekin këtë lëndë zgjedhore për shkak të barrës shtesë të obligimeve të cilat burojnë prej saj. E dyta, është i nevojshëm zbatim adekuat i ligjerimit të lëndës: duhet të jepen informata për disponueshmërinë dhe regjistrimin; duhet të jepen materiale mësimore (p.sh. tekste shkollore) dhe të organizohet trajnim i mësuesve për të dhënë mësimdhënie kualitative. Librat shkollor janë në proces të shqyrtimit nga MASH. Mësuesit romë janë të rrallë.

Edhe pse mbetet e paqartë se nëse lënda është e qasëshme për nxënësit jo romë,<sup>99</sup> vetëm fëmijët romë e ndjekin atë. Promovimi i gjuhës dhe kulturës rome mes popullatës jo-rome mbetet i kufizuar.

**73) Të krijohen dhe zbatohen programe shkollore gjithëpërfshirëse për desegregim të cilat kanë për qëllim: (1) ta ndërpresin praktikën e transferimit të fëmijëve romë në shkolla ose klasa të posaçme (p.sh. shkolla për persona me hendikep mental, shkolla dhe klasa të cilat janë krijuar ekskluzivisht për fëmijët romë dhe sinti); dhe (2) transferimi i fëmijëve romë nga shkollat e posaçme në shkollat e rregullta.**

Meqense segregimi në arsim nuk njihet formalisht, nuk janë paraparë masa specifike për desegregim. Segregimi i fëmijëve në shkolla për një kohë të gjatë është njohur si *ndarje*. Së shpejti, zyrtarët shtetëror kanë shfaqur një qëndrim më fleksibil gjatë referimit të kësaj praktike.

Rezultatet e dobta dhe vështirësitë mësuese, shpesh të ndërlidhura me dijeninë e varfër të gjuhës në të cilën ligjerohet, si dhe përfitimet ekonomike për familjet e fëmijëve me nevoja të posaçme janë shkaqet kryesore për ti transferuar fëmijët në shkolla të posaçme. Nuk ka të dhëna

<sup>96</sup> Ministria për arsim dhe shkencë e Republikës së Maqedonisë, “Hapa drejtë arsimit të integruar në sistemin arsimor të Republikës së Maqedonisë, 2009.

<sup>97</sup> Intervistë me Rexhep Ali Çupi, 16 shtator 2010.

<sup>98</sup> FOSIM, “Analysis of the Implementation of Roma Language and Culture as an elective subject”, 2010 f. 6.

<sup>99</sup> Nuk duket sikur të jetë e ndaluar edhe pse Z. Ljupço Spasovski, Udhëheqës i Sektorit për arsim fillor dhe të mesëm, pohon të kundërtën. Intervistë me Z. Spasovski, 23 shtator 2010.



gjithëpërfshirëse të cilat janë në disponim për përbërjen etnike në shkolla dhe klasa të fëmijëve me nevoja të posaçme. REF vlerëson se 27% e fëmijëve në shkolla dhe klasa speciale janë romë.<sup>100</sup> Informatat e dhëna nga Drejtorati lidhur me shkollat e mesme në Shkup dhe Shtip e vërtetojnë numrin tepër të lartë të fëmijëve romë, krahasuar me bashkësitë e tjera, në institucionet arsimore për fëmijë me nevoja të posaçme.

Një propozim për ta marrë rolin dhe organizimin e Komisioni, në moment nën Ministrinë për shëndetësi, i cili është përgjegjës për vlerësimin e statusit ‘me nevoja të posaçme’ është nën shqyrtim.<sup>101</sup> Kjo reform gjithashtu duhet ta shqyrtojë krijimin dhe inkurajimin e përdorimit të mekanizmave për transfer të fëmijëve nga shkollat dhe klasat speciale në ato të rregullta.

Mundësimi i librave shkollor dhe transportit falas për të gjithë nga ana e shtetit, duhet të rezultojë në atë që më pak prindër të insistojnë që ti transferojnë fëmijët e tyre në institucionet arsimore speciale për shkak të financave. Përfitimet financiare të cilat ende ekzistojnë për fëmijët me nevoja të posaçme arsimore, ende paraqesin pengesë për motivimin e prindërve për ti transferuar fëmijët e tyre në shkollat ose klasat e rregullta.

*De facto* segregimi nuk ndodh vetëm me transferimin e fëmijëve në klasa speciale por gjithashtu edhe duke lejuar ose promovuar ekzistencën e shkollave të cilat në shumicë ose tërësisht ndiqen nga romët.

Brengat për segregim i animojnë debatet për hapjen e mundëshme të shkollës së mesme në lagjen rome të Shuto Orizares, e cila normal se do të jetë e ndjekur më së shumti nga studentët romë.

Për dallim të kësaj, në Gostivar, Manastirë dhe Kumanovë ka raste të të ashtuquajturave shkolla “të shoqërueshme ndaj romëve” me shkalla të larta të nxënësve romë. Autoritetet janë informuar dhe kanë intervenuar me hetime edhe pse kanë pasur shumë pak ndikim në rastet e tilla. Është përcaktuar se këto nuk janë raste diskriminuese, por janë si rezultat i preferencave të disa prindërve për klasa të pastra me romë ose për shkak të ndarjes së re të qyteteve apo komunave.<sup>102</sup> Kjo i detyron fëmijët të cilët jetojnë në një vend specifik të regjistrohen në shkollat të cilat janë në atë rrethinë. Përqëndrimi i familjeve rome në vendin e njejtë e përcakton rregjistrimin e fëmijëve të tyre në shkollën e njejtë. Krijimi i komunave të reja shkaktoi konfuzion për atë se në cilën shkollë duhet të bëhet regjistrimi.

***74) Të caktohen resurse financiare për transferin e fëmijëve romë në arsimin e rregullt dhe për zhvillimin e programeve shkollore për përkrahje për ta lehtësuar tranzicionin në arsimin e rregullt.***

Nuk ka program për lehtësimin e transferit të fëmijëve romë në arsimin e rregullt. Ekzistojnë projekte për lehtësimin e qasjes së fëmijëve romë në arsimin e rregullt përmes arsimit parashkollor. (Shih 75d).

***75) Të lehtësohet qasja e fëmijëve romë në arsimin e rregullt duke ndërmarrë masa siqë janë:  
(a) Ndërmarrja e masave për ç’rrenjosje të manifestimeve të paragjykimeve ndaj romëve dhe sintive në shkolla;***

<sup>100</sup> REF, “Advancing education of Roma in Macedonia – Country Assessment and the Roma Education Fund’s Strategic Directions”, 2007, f. 31.

<sup>101</sup> Nëse miratohet, krijimi i 4 qendrave shëndetësore duhet të mundësojnë kategorizim dhe kontrollë më të mirë. Intervistë me Rexhep Ali Çupi, 22 shtator 2010.

<sup>102</sup> Intervistë me Vaska Bajramovska Mustafa, Këshilltarë shtetëror, Zyra e Avokatit të popullit, 26 tetor 2010.

Diskriminimi dhe paragjykimet ndaj fëmijëve romë janë identifikuar për të qenë si faktorë të mundshëm të cilët e pengojnë qasjen e tyre në arsim.<sup>103</sup> Mungojnë masa efektive të cilat i synojnë qëndrimet e nxënësve jo-romë ndaj nxënësve romë në shkolla. Nga njëra anë bashkënxënësit nuk kanë arsim të përshtatshëm për aspektet pozitive të multikulturalizmit, shumëllojshmërisë dhe kulturës rome. Një hulumtim i organizuar nga OSBE-ja thotë se: 15.6% nga maqedonasit etnik, 17.9% nga shqiptarët etnik dhe 10% nga turqit etnik, fëmijë të shkollave të mesme të intervistuar kanë ndjenja negative ndaj romëve etnik.<sup>104</sup> Nga ana tjetër, mësuesit dhe personeli shkollor disa herë kanë edhe vetë paragjykimet ndaj nxënësve romë.

Janë zbatuar disa iniciativa të ndrojtura të cilat i kanë synuar mësuesit. MASH dhe Qendra kombëtare rome (NRC) botuan një manual trajnues për njohjen e diskriminimit dhe paragjykimëve në shkolla. Trajnimi para hyrjes në shërbim nga USAID/FOSIM dhe projekti *Arsim për drejtësi sociale*, përmes të cilit është organizuar trajnim për arsim multikulturor për 400 mësues nga 11 shkolla të mesme. Aktivitetet e tilla janë të pakta dhe duhet më tej të plotësohen me trajnime dhe aktivitete sistematike të cilat i synojnë nxënësit.

***(b) Të trajnohen edukues për arsim multikulturor dhe mënyrat se si të veprojnë me klasat etnikisht të përziera;***

Mungon një trajnim sistematik dhe gjithëpërfshirës i edukatorëve për arsim multikulturor. Janë organizuar edhe trajnime sporadike ku kanë marrë pjesë vetëm disa mësues edhe atë kryesisht në bazë vullnetare. Manuali i MASH dhe NRC-ës i plotëson vetëm disa nga zbrastirat e formacionit të mësuesve.

Misioni i OSBE-së me partner organizata nga Shkupi, Manastiri, Shtipi dhe Tetova, është i përfshirë në sferën e një projekti për trajnim përpara hyrjes në shërbim. Që nga 2009, rreth 300 studentë nga Fakultetet pedagogjike dhe nga Instituti për punë sociale dhe politikë sociale (Shtip) kanë përkrahur mësimin e fëmijëve të përkatësive të ndryshme etnike, pjesë e një periudhe trajnuese prej katër muajve. Fokusi qëndron tek ulja e paragjykimëve mes mësuesve jo-romë ndaj fëmijëve të komuniteteve tjera, posaçërisht ndaj romëve. Përafërsisht 1/3 e fëmijëve të përfshirë në këtë projekt janë romë.

***(c) Të krijohen strategji për të fituar përkrahje nga komuniteti më i gjërë për desegregimin në shkolla;***

Ende mbetet që të krijohen një strategji efektive me këtë qëllim.

***(d) Të mundësohet përkrahje për ta zvogluar zbrastirën mes fëmijëve romë dhe sinti dhe nxënësve tjerë, përfshirë edhe përmes programeve parashkollore të dizenuara për ti përgatitur fëmijët romë dhe sinti për shkollën fillore;***

Në pajtim me OSCE MC.DEC6/08, shteti nikoqir ka identifikuar programe parashkollore për të qenë kyçe për përmirësimin e qasjes në arsim kualitativ për fëmijët romë dhe në këtë mënyrë të zvoglohet zbrastira mes tyre dhe nxënësve të tjerë.

Përgjegjësia për fëmijët e moshës parashkollore mbetet tek MPPS. Njësia e MPPS e zbaton projektin për *Përfshirje të fëmijëve romë në arsimin parashkollor* që nga 2006. Qëllimet kryesore

<sup>103</sup> Joanna Laursen Brucker, "Roma children – A study of barriers to Educational Attainment in the Former Yugoslav Republic of Yugoslavia", UNICEF's Paper Series, "Out of school children in Central and Eastern Europe and the Commonwealth of Independent States", f. 16.

[http://www.unicef.org/ceecis/Out\\_of\\_school\\_children\\_Final\\_compressed.pdf](http://www.unicef.org/ceecis/Out_of_school_children_Final_compressed.pdf). (E qasur më 13 dhjetor 2010).

<sup>104</sup> OSBE SMMS, "Moshë, Kontaktet, Perceptimet – Si shkollat i ndërtojnë marrëdhëniet mes bashkësive", janar 2010, f. 11-12.

të tij janë: qasje e lehtësuar në arsim fillor për fëmijët romë, si dhe përmirësimi i aftësive të tyre lidhur me gjuhën maqedonase; të sigurohet regjistrim në kohë në arsimin fillor; të ulët braktisja e shkollës; të inkurajohet përfshirja e romëve në klasat e përziera etnike. Njësia për zbatim raporton se 678 fëmijë janë përfshirë në program mes 2006 dhe 2009. Ato janë përfshirë në foshnjoret shtetërore të cilat kanë qenë të pasuruara me personel shtesë të romëve asistentë.<sup>105</sup> Propozim projektet për 2009/2010 dhe 2010/2011 tregojnë për përpjekje për ta rritur numrin e regjistrimeve për të përfshirë 777 fëmijë në periudhë prej dy vite. Përfshirja ka mbetur e kufizuar gjoja se për shkak të kapaciteteve të kufizuara të shkollave për të përfshirë më tepër fëmijë, si dhe mungesa e kapaciteteve njerëzore, institucionale dhe financiare në disa komuna të cilat duhet ta zbatojnë projektin.

Ka vonesa në procedurat administrative lidhur me pagesën nga ana e pushteteve komunale, për regjistrimin e fëmijëve dhe rekrutimin e asistentëve romë. Vlerësimi i projektit thotë se përqindja e romëve nga numri i përgjithshëm i fëmijëve të cilët ndjekin arsim parashkollor është rritur prej më 1.3% në 2006/7 në 1.83% në 2008/9, edhe pse burimi i të dhënave të tilla nuk është përmendur.<sup>106</sup>

Me qëllim që të vlerësohen rezultatet e këtij projekti si dhe të politikave arsimuese në përgjithësi, duhet të bëhet koordinim më i mirë mes të gjithë vepruesve, si dhe grumbullim më i mirë i të dhënave, menaxhimit dhe botimeve.

Përfshirja e hershme e fëmijëve romë në arsimin e rregullt mund të kontribuojë në tejkalimin e prezencës së fëmijëve në rrugë, të prekshëm ndaj veprimeve kriminale, trafikimit, dhunës dhe eksploatimit të punës feminare. OJQ-ja Open Gate vlerëson se 90% e fëmijëve në rrugë janë romë. Disa OJQ japin mentorim dhe paisje për kujdes ditor për fëmijët romë të moshës parashkollorë (p.sh. Sumnal). Me ndihmën e UNICEF-it, MPPS operon qendra ditore për fëmijë në Shkup dhe Manastirë, të cilat strehojnë rreth 70 fëmijë dhe kanë për qëllim që ti parandalojnë ato që të shkojnë në rrugë. Këto qendra nuk ofrojnë masa konkrete për përfshirjen e fëmijëve në arsimin formal.<sup>107</sup>

#### ***(e) Të mundësohet përkrahje për rritjen e numrit të medijuesve/trajnuësve dhe mësuesve në komunitetin rom.***

Futja në përdorim e lëndës zgjedhore, *Gjuhë dhe kulturë rome* në shkollat fillore dhe projektet e shpërndara të cilat përfshijnë medijues/trajnuës për të ofruar përkrahje jashtë programit shkollor për fëmijët (zakonisht të zbatuara nga OJQ-ët) kanë kontribuar në rritjen e numrit të edukatorëve nga komuniteti rom. Shumica e vepruesve, siqë është MASH, shkollat dhe shoqëria civile, shprehin keqardhje për raritetin e medijuesve/mësuesve të kualifikuar romë në arsimin e rregullt. Moduli i ri i krijuar në universitet, *Gjuha dhe kultura rome* mund të jetë një hap i parë i mirë për ta zvogluar këtë zbraztirë.

#### ***76) Të krijohen dhe zbatohen programe shkollorë për antiracizëm, si dhe fushata antiraciste për mediat.***

Programet shkollorë nuk përmbajnë dënime eksplicite të racizmit as po promovojnë qasje antiraciste. Analiza e librave shkollorë e bërë nga UNICEF në 2007 konkludon se në shumë raste

<sup>105</sup> Projekt propozim për 2009/2011 i cili përmban informata lidhur me rezultatet e projektit 2006/2009. Janë përfshirë fëmijë nga 15 komuna: më 2006/07, u përfshinë 211; në 2007/08, 226; në 2008/09, 241.

<sup>106</sup> Ibid.

<sup>107</sup> Ljatifa Sikovska, e intervistuar më 16 dhjetor 2010.

tekstet shkollore i përforcojnë stereotipet,<sup>108</sup> me çfarë nën-vlerësohet ç'rrenjosja e suksesshme e racizmit.

**77) Të krijohen politika të cilat i trajtojnë të gjithë faktorët të cilët ndikojnë në ndjekjen e ulët të arsimit për fëmijët romë dhe sinti. Kjo përfshin edhe sigurimin që familjet rome dhe sinti të paiseën me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për regjistrim, si edhe çdo banorë tjetër.**

Regjistrimi dhe ndjekshmëria e fëmijëve romë është shumë më e vogël se mesatarja kombëtare. Një botim nga UNICEF/Enti shtetëror statistikor në vitin 2006 vlerëson se shkalla e ndjekshmërisë e fëmijëve romë të moshës 7-14 (shkolla filllore dhe të mesme) të jetë rreth 61.1%, në krahasim me mesataren kombëtare prej 94.9%.<sup>109</sup>

Disa nga faktorët kryesorë të cilët ndikojnë në ndjekshmërinë e ulët të romëve janë: shpenzimet, largësia nga shkolla, paarsimi i prindërve dhe mosbesimi në sistemin arsimor, mungesa e dokumentacionit të nevojshëm. Edhep se shumë çështje të ndërlydhura mund ta përcaktojnë jo-regjistrimin e fëmijëve në arsim dhe në këtë mënyrë duke i bërë politika gjithëpërfshirëse të domosdoshme, masat të cilat e trajtojnë secilën çështje veçmas mund të kenë ndonjë efekt pozitiv.

Faktorët ekonomik dhe ato të largësisë u adresuan përmes politikave qeveritare (librat shkollor dhe transporti falas). Bursat nga MASH dhe donatorë (p.sh. REF, OSI) kanë kontribuar në mbulimin e shpenzimeve tjera (ushqim, materiale shkollore, veshje) mirëpo qëllimi i tyre është i kufizuar, mu për shkak të kriterëve të bazuara në merita për tu kualifikuar për bursë.

Qëndrimet dhe vetëdija familjare për vlerën e arsimit në një mënyrë është trajtuar, kryesisht përmes fushatave të organizuara nga OJQ-ët.

Programet edukuese për shkrim/lexim dhe për të moshuar do të kontribojnë në rritjen e mirëkuptimit të familjeve dhe përkrahjes së fëmijëve të tyre në arsim. OSBE MC.DEC6/08 qartësisht thërret që shtetet anëtare ta rrisin vetëdijen mes romëve për rëndësinë e përfshirjes dhe ndjekshmërisë në shkollë.<sup>110</sup> Në këtë aspekt në moment nuk bëhet asgjë e dukshme.

Dokumentacioni mund të paraqesë pengesë për përfshirje, në veçanti për fëmijët në shkollat fillore. OJQ-ët dhe RIC ofrojnë asistencë bazike për këto çështje. Roli i RIC në këto aktivitete duhet të përforcohet.<sup>111</sup>

Ligji thotë se të gjithë fëmijët të cilët jetojnë në vend, e kanë të drejtën e arsimit të detyrueshëm pavarësisht të statusit dhe nënshtetësisë së tyre. Siqë duket ka disa sfera të paqarta në Ligj (regjistrimi i fëmijëve pas një moshe të caktuar dhe i nxënësve pa çertifikata lindje).

**78) Të konsiderohet përpilimi i programeve për përkrahje për familjet rome me të ardhura të ulta të cilët kanë fëmijë të moshës shkollore.**

Në plotësim të kontributeve shtetërore me librat shkollor dhe transportin, bursat ofrohen për të lehtësuar një sërë të shpenzimeve të tjera të ndërlydhura me arsimin. Mirëpo, ato nuk ofrohen në të gjitha fazat e ciklit arsimor dhe zakonisht bazohen në merita dhe në këtë mënyrë nuk i përfshijnë familjet më të prekshme.

Familjet rome me të ardhura të ulta shpesh kualifikohen për beneficione shtetërore.

<sup>108</sup> UNICEF, "Multiculturalism and Inter-ethnic Relations in Education", 2009, f. 36.

<sup>109</sup> Enti shtetëror statistikor dhe UNICEF, "Multiple Indicator Cluster Survey 2005/2006", 2007, f. 97.

<sup>110</sup> MC.DEC6/08, Rec. 3.

<sup>111</sup> Donald Bisson, Assessment of the Capacity of the Roma Information Centres to Provide Free Legal aid to the Roma Community, tetor 2010, f. 25.

Strehimore për të pastrehët, shpesh romë, pa ose me paisje banuese shumë të varfëra, mundësohen nga MPPS në Çiçino Sello dhe Lubanci. Nga 100 personat e strehuar për një periudhë, shumica janë familje rome të cilët aty marrin ushqime, fjetje dhe shërbime bazike.

Fundamentale për parandalimin e fenomenit ‘fëmijë në rrugë’ është përfshirja e familjeve shumë të prekshme në këto struktura si dhe të fëmijëve romë në qendrat ditore të administruara nga MPPS (shih 75d). Qendrat ditore për fëmijë momentalisht nuk ofrojnë asnjë program për ti trajtuar nevojat arsimore, shëndetësore dhe psikologjike të fëmijëve të përfshirë.<sup>112</sup> Ato duhet më tepër të fokusohen në zhvillimin fëmijor, me qëllim që të nxisin zgjidhje të qëndrueshme dhe afat gjata lidhur me fëmijët në rrugë.

***79) Të promovohet ndjekshmëria e rregullt shkollore nga fëmijët romë dhe sinti, përmes përfshirjes së familjeve dhe medijuesve social, rritjes së vetëdijes mes prindërve romë dhe sinti dhe të moshuarve për përgjegjësinë e tyre për ta lehtësuar ndjekshmërinë e fëmijëve në shkolla në veçanti qasjes së arsimit për vajzat.***

Puna sezonale, shpenzimet, performanca e dobët dhe veprimet diskriminuese, të gjitha ndikojnë mbi ndjekshmërinë e dobët dhe shkallës më të lartë braktisjeve shkollor nga nxënësit romë. Mungojnë të dhëna zyrtare, ndërsa vlerësimet e bazuara në mostra shumë të vogla, janë tepër të ndryshme. Shkalla e regjistrimit në arsimin fillor në 2005 sipas OSI, ka qenë 76% nxënës romë dhe 98% për shumicën të cilët janë të ngjajshëm me romët.<sup>113</sup>

Diskrepanca mes shkallës së regjistrimit mes nxënësve romë dhe jo-romë në shkollat e mesme është edhe më e madhe: 19% për romët dhe 74% për ‘mazhorancën e popullësisë e cila vshtë e ngjajshme me romët’.<sup>114</sup> Multiple Indicators Cluster Survey 2005/2006 i botuar në 2007, thotë se shkalla e përfundimit të arsimit fillor nga fëmijët romë është 44.6%, krahasuar me 86.6% të maqedonasve etnik dhe 80.5% të shqiptarëve.<sup>115</sup> Shkalla e tranzicionit në arsimin e mesëm është edhe më brengosëse, me një numër të romëve prej 26.9%.<sup>116</sup> Drejtori i Departamentit për arsim në FOSIM, Spomenka Lazarevska, thotë se shkalla e përfundimit të arsimit të mesëm nga fëmijët romë është 76%.

Duhet të theksohet se arsimi i mesëm u bë i detyrueshëm në vitin shkollor 2008/2009. Edhe pse deri më sot nuk është bërë ndonjë analizë sistematike për ndikimin e një legjislacioni të tillë, ai me siguri se ka qenë një faktor i rëndësishëm në rritjen e ndjekshmërisë së shkollës së mesme. Iniciativat e bursave nga FOSIM (me USAID), REF dhe së shpejti me MASH kanë kontribuar në këtë arritje. Rezultatet e tilla nuk duhet parë veçmas nga projektet e tjera mentoruese, të cilat i paisin fëmijët me ndihmë në gjuhën maqedonase dhe lëndët e tjera.

Rëndësia për tu rritur vetëdija mes prindërve romë dhe anëtarët e komunitetit për rolin e arsimit dhe përgjegjësitë e tyre për ta lehtësuar ndjekshmërinë shkollore të fëmijëve është identifikuar nga disa OJQ. Mekanizmat bindëse janë shumë më të përshtatshme se sa ato frikësuese, për ti përforcuar obligimet nga arsimi i detyrueshëm. Frikësimi as do të krijojë përkrahje prindërore për arsim në afat të gjatë, as po do ta kontribuojë në uljen e braktisjeve shkollore.

OJQ-ët Sumnal dhe Ambrella zbatojnë aktivitete të cilat kanë për qëllim rritjen e vetëdijes mes komunitetit të tyre. Meseçina dhe NRC gjithashtu kanë organizuar fushata dhe takime me

<sup>112</sup> Latifa Shikovska, e intervistuar më 16 dhjetor 2010.

<sup>113</sup> OSI, “EU Monitoring and Advocacy Program”, 2007, f. 31.

<sup>114</sup> Ibid., f. 33.

<sup>115</sup> Enti shtetëror statistikor dhe UNICEF, “Multiple Indicator Cluster Survey”, f. 100.

<sup>116</sup> Ibid.

prindërit dhe institucionet lidhur me këtë çështje. *Fushata për arsim të romëve* nga NRC raportohet se ka kontribuar në dyfishimin e numrit të nxënësve në klasën e parë të regjistruar në shkolla të mbikqyrura mes 2005/6 dhe 2007/8.<sup>117</sup> Projekti i REF, *Një fillim i mbarë*, i cili do të vazhdojë deri në qershor 2012, përfshin aktivitete derë më derë nga medijuesit. Programet e tilla për rritje të vetëdijes nuk janë sistematike dhe në nivel shtetëror dhe janë të anëshkaluara nga organet qeveritare. Përfshirja e RIC-ve në aktivitetet e tilla do të ketë një rezultat edhe më të madh.

Nuk i kushtohet kujdes i posaçëm promovimit të ndjekshmërisë shkollore për femrat.

MASH shqyrton transferet kushtëzuese në para për familjet me ndihma sociale, të cilat do të mvaren nga ndjekshmëria shkollore e fëmijëve të tyre prej më së paku 80% të orëve. Një sistem i ri kompjuterik për të mbikqyrur të dhënat lidhur me regjistrimin, i mundësuar nga Banka Botërore, së shpejti duhet të fillojë me fazën testuese dhe të ndihmojë në këtë aspekt.<sup>118</sup>

**80) Të kushtohet kujdes i veçantë për ti mundësuar vajzat rome dhe sinti me mundësi të barabarta për përfshirje arsimore dhe sociale, si dhe të krijohen programe për ti tejkaluar këto braktisje të posaçme nga procesi arsimor.**

Nuk ka programe specifike të cilat e nxisin ndjekshmërinë shkollore, të cilat do ti synojnë vetëm nxënëset rome edhe përpos të dallimit prej 10 përqind në shkallën e regjistrimit në shkolla fillore mes vajzave dhe djemëve romë (gjegjesisht, 71% dhe 81%).<sup>119</sup> Edhe pse është e drejtë të thuhet se arsimi i mesëm i detyrueshëm për të gjithë dha përmirësime në shkallën e përgjithshme të mbajtjes së nxënësve dhe zvoglimit të zbrastirës, pabarazia gjinore në arsim ende është prezente.

Tradita dhe praktika e martesave të hershme (11.4% nga gratë rome në moshë prej 15 dhe 49 të martuar në moshën 15 vjeçare) janë rrënjët e kësaj çështje. Duhet të krijohen programe të cilat synojnë praktikatat e martesave të hershme, në koordinim të përshtatshëm me institucioneve shëndetësore dhe ato për mundësi të barabarta.

**81) Të konsiderohet krijimi i programeve të përshtatshme për ato të cilët nuk e kanë kryer arsimin fillor ose janë analfabetë.**

Përderisa shkalla e përgjithshme e shkrim-leximit në shtetin nikoqir i afrohet 100%, vetëm 84% të qytetarëve romë janë jo-analfabetë.<sup>120</sup> MASH dhe REF i lejojnë ato të cilët kanë braktisur shkollimin e mesëm një vit përpara diplomimit që ta kryejnë shkollën.

Nuk ka programe gjithëpërfshirëse për analfabetët ose të moshuarit pa diplomë shkollë. Raportohet se Qendra për arsimin e të moshuarve brenda Minsitrisë është në proces të inicimit të ndonjë projekti në këtë sferë,<sup>121</sup> ndërsa programe sporadike për shkrim lexim zbatohen nga OJQ-ët.

**82) Atje ku është e nevojshme të krijohen programe bursash për nxënësit romë dhe të inkurajohet pjesëmarrja e tyre më e madhe në programet ekzistuese të bursave.**

Programet e bursave për nxënësit romë, posaçësisht ato në arsimin e mesëm dhe të lartë, janë aktive dhe kanë kontribuar në promovimin e regjistrimit dhe shkallës regjistruese.

<sup>117</sup> Të dhëna nga NRC.

<sup>118</sup> Intervistë me Rexhep Ali Çupi, 22 shtator 2010.

<sup>119</sup> Duhet të theksohet se nuk ka dallim të madh statistikor në regjistrimin mes vajzave dhe djemve në arsimin fillor për “mazhorancën e popullatës e cila është e ngjajshme me romët”. OSI, EU Monitoring and Advocacy Program, 2007, f. 31.

<sup>120</sup> UNDP, “National Vulnerability Report for Macedonia”, 2006, f. 19.

<sup>121</sup> Intervistë me Rexhep Ali Çupi, 22 shtator 2010.

Përgjat REF, Programi arsimues i romëve nga FOSIM, i cili është marrë përsipër nga MASH që nga 2008/09, u ka mundur bursa dhe mentorim nxënësve të shkollave të mesme që nga 2004: 262 në vitin e parë në deri më 500 gjatë viteve të ardhshme. Nxënësit të cilët nuk kanë mundur ta mirëmbajnë suksesin e nevojshëm (3 nga 5) pas vitit të parë marrin bursa paciale me qëllim që të anëshkalohen braktisjet, ndërsa nxënësive të cilët nuk i ndjekin orët rregullisht, bursa ju ngrihet për një kohë të caktuar.

MASH ka sponsoruar 620 nxënës romë të shkollave të mesme në 2008/09, ka planifikuar që të dhurojë 800 të tjera në 2009/10. Megjithatë vetëm 480 bursa janë dhuruar atë vit për shkak se kriteret kualifikuese nuk ishin të përmbushura nga më shumë nxënës romë.

U raportuan edhe vonesa në zbatimin e programit. Me shpresë për ta institucionalizuar dhe për të siguruar efikasitet të këtij programi, MASH mban negociata me REF për garantimin e 700 bursave në vit, mentorimit dhe tutorimit shtesë për provimin e vitit të fundit (Matura) për nxënësit romë të shkollave të mesme.

Në vitin 1994 vetëm 9 studentë romë janë regjistruar në universitetet e shtetit nikoqir, ndërsa deri më 2001/2 numri është rritur në 97 in 2001/2<sup>122</sup> dhe është trefishuar që atëherë. Studentët universitar përfitojnë nga programi i *Romaversitas* (bursa dhe tutorim) dhe *Roma Memorial University Scholarship Programme* (RMUSP), i ofruar nga REF dhe FOSIM. Që nga 2007/8 *Romaversitas* ka shpërndarë në vit 35 bursa të financuara nga USAID dhe ka mundur mentorim dhe aktivitete të tjera për një numër edhe më të madh të studentëve. Përmes RMUSP janë dhënë mbi 350 bursa që nga 2008. FOSIM përkrah studentët romë në Fakultetin pedagogjik me bursa duke shpresuar se do të kontribuojë në kapacitetin e nevojshëm njerëzor për profesionin e mësuesve. Kuotat të cilat ekzistojnë në universitetet për studentët romë e lehtësojnë qasjen e studentëve romë në arsimin e lartë.

### **83) Të inkurajohet njohja e kompjuterëve mes romëve dhe sintive përmes krijimit të ueb-faqeve informative.**

Kurset për njohje të kompjuterëve mbetet që ende të zhvillohen. Iniciativa *Kompjuter për çdo fëmijë*, e inivuar nga ministria më 2008 ka kontribuar në paisjen e çdo shkolle me kompjuterë. Megjithatë, kushtet e vobekta, mungesa e trajnimeve për mësuesit dhe progresi i ngadalshëm i krijimit të programeve i bëjnë zhvillimet në këtë sferë shumë të kufizuara. Nuk ka program i cili i synon në veçanti nxënësit romë.

### **84) Të vlerësohet periodikisht efikasiteti i politikave arsimore.**

Në mungesë të të dhënave zyrtare, vlerësimi i politikave arsimore siqë janë programet arsimore të dedikuara për popullatën romë dhe koordinimi mes vepruesve (shtetëror, OJQ, donatorë ndërkombëtar) në shtet mbetet sfiduese.

Edhe përpos të vlerësimeve periodike të Inspektoratit shtetëror dhe vetë-vlerësimeve në shkolla, nuk ka mekanizma të tjerë efektiv për mbikqyrjen dhe adresimin e çështjeve urgjente.

Krijimi i Drejtoratit funksional, i cili është i udhëhequr nga një rom i kualifikuar është një hap pozitiv. Ky organ mund të promovojë koordinimin dhe vlerësimin sa u takon politikave arsimore të synuara për romët (dhe komunitetet e tjera pakicë) dhe si rezultat mund të jap një efikasitet të përmirësuar.

<sup>122</sup> [http://www.romaversitas.edu.mk/za\\_nas.html](http://www.romaversitas.edu.mk/za_nas.html) (E qasur më 25 shtator 2010).

## Kapitulli VI i PV– Rritja e pjesëmarrjes në jetën publike dhe politike

**87) Shtetet anëtare duhet të jenë proaktive për t'ju mundësuar romëve dhe sintive, si çdo banori tjetër, qasje deri tek të gjitha dokumentet e nevojshme, përfshirë certifikata të lindjes, dokumente identifikuese dhe kartela për sigurim shëndetësor. Gjatë zgjidhjes së problemeve lidhur me dokumentet bazike, shtetet anëtare këshillohen që të punojnë në bashkëpunim me shoqatat qytetare të romëve dhe sintive.**

Në falemnderim të bashkëpunimit mes institucioneve shtetërore dhe organizatave ndërkombëtare shenjat e përmirësimit janë të dukshme.

Vlerësimet për romët e regjistruar në shtet janë të ndryshme, mirëpo sipas supozimeve numri është shumë i madh dhe reflektohet në variacionet e ndryshme sa u takon të dhënave për popullatën rome në shtet (53,879 sipas regjistrimit të popullësisë më 2002 dhe mes 80,000 dhe 250,000 sipas burimeve të tjera).<sup>123</sup> Besohet se rreth 5,000 romë nuk kanë dokumente për identifikim personal.

Procedura për regjistrimin dhe fitimin e dokumenteve për identifikim personal raportohet për të qenë tepër e vështirë dhe e shtrenjtë. Certifikatat e lindjes mund të kushtojnë deri më 5.25 €. Janë të parapara edhe dënime për regjistrimet e vonshme të lindjeve. Romët jo gjithmonë janë të vetëdijshëm për procedurën dhe përfitimet nga marrja e dokumenteve për identifikim. Çështja e dokumentacionit për romët të cilët janë arratisur nga Kosova kërkon një vëmendje të posaçme (shih Rec. 108).<sup>124</sup>

RIC dhe OJQ-ët japin ndihmë bazike për romët të cilët nuk kanë dokumente. Rezultate të rëndësishme u arritën përmes një projekti të shumë agjencive të financuar nga BE-ja, duke i përfshirë ministritë relevante së bashku me UNHCR, UNICEF dhe OJQ-ët. Rreth, 3,100 romë kanë marrë dokumente personale mes shkurtit të 2008 deri më prill të 2010.<sup>125</sup> Grupi punues i përfshirë në këtë projekt të shumë agjencive përpiloi një raport me rekomandime për parandalimin dhe zgjidhjen e rasteve të tjera të njerëzve pa dokumente për identifikim. Pasiqë i njeiti të miratohet nga Ministria për punë të brendshme dhe Ministria për drejtësi, do të dorëzohet qeverisë. Dokumenti parasheh një qasje më proaktive nga regjistruerit lokal dhe ministritë, luhatje të taksave administrative dhe dënimeve dhe bashkëpunim me OJQ-ët rome.

**88) Shtetet anëtare inkurajohen për ti marrë në konsiderim kushtet e ardhshme bazike për të siguruar pjesëmarrje efektive të romëve dhe sintive në jetën publike dhe politike:**

**- Përfshirje e hershme: çdo iniciativë e ndërlidhur me romët dhe sintit duhet ti përfshijë ato në fazat më të hershme të zhvillimit, zbatimit dhe vlerësimit;**

**- Përfshirje: romët dhe sintit duhet të përfshihen në proceset formale konsultative, si dhe efikasiteti i mekanizmave të krijuar për pjesëmarrjen e tyre në krijimin e iniciativave kryesore politike duhet të sigurohet përmes përfshirjes së tyre në një proces të gjërë përfaqësues;**

**- Transparencë: Programet dhe propozimet duhet të shpërndahen shumë përpara afatit të sjelljes së vendimit me qëllim që të mundësohen analiza domethënëse dhe kontribut nga përfaqësuesit e komunitetit rom dhe sinti;**

**- Pjesëmarrje domethënëse e romëve dhe sintive në të gjitha nivelet e qeverisë: Pjesëmarrja nga romët dhe sintit në qeverinë lokale është thelbësore për zbatimin efektiv të politikave të cilat ndikojnë tek to;**

<sup>123</sup> [http://www.coe.int/t/dg3/romatravellers/archive/documentation/strategies/statistiques\\_en.asp](http://www.coe.int/t/dg3/romatravellers/archive/documentation/strategies/statistiques_en.asp)

<sup>124</sup> Intervistë me Tihomir Nikolovski, asistent juridik në UNHCR, 18 nëntor 2010.

<sup>125</sup> EU Progress Report 2010, f. 22.



**- Pronësia: Romët dhe sintit luaj një rol thelbësor dhe të pazëvendësueshëm për tu siguruar se e drejta e pjesëmarrjes në procesin politik zbatohet në praktikë.**

Popullata rome merr pjesë në jetën politike kryesisht si elektorat (nëse kanë në dispozicion dokumente për identifikim personal). Mbetet e margjinalizuar dhe shumë pak e vetëdishme për iniciativat politike. Edhe Dekada e romëve është krejtësisht e panjohur ose shumë pak njihet.<sup>126</sup>

Pjesëmarrja efektive është e kufizuar tek përfaqësuesit e zgjedhur romë, punonjësit publik dhe anëtarëve të OJQ-ve rome. Vetëm një numër i vogël i OJQ-ve i ka kapacitetet e nevojshme për pjesëmarrje dhe për të dhënë kontribute domethënëse. Disa analiza thonë se mungesa e OJQ-ve të forta në disa regjione e shpeshput komunitetin rom nga procesi i këshillimit edhe në nivel lokal dhe kombëtar.<sup>127</sup>

Përfshirja e hershme mundësohet që nga krijimi i politikave/iniciativave projektore, për shkak se ato zakonisht burojnë nga OJQ-ët rome ose nga romët në zyrat publike. Përfshirja në fazën zbatuese është e shpeshtë për shkak se OJQ-ët rome veprojnë si bashkëpunorë të shtetit gjatë zbatimit. Proceset e vlerësimit janë të dobta ose parciale. Në disa raste, OJQ-ët rome janë të zëshme kur ju drejtohen institucioneve relevante me brengat e tyre.

Përfshirja dhe pjesëmarrja domethënëse e përfaqësuesve romë në krijimin e iniciativave politike, në veçanti në nivel lokal, janë të papërshtatshme. Mungesa e eksperiencës në administratën publike dhe zhvillimet politike e pengojnë pjesëmarrjen e këshilltarëve lokal dhe kapacitetin e tyre për ti formuar efektivisht politikat kombëtare dhe iniciativat lokale. Partitë politike nuk ndërmarrin iniciativa për ta tejkalluar këtë pengesë.

Si mjet për përforcimin e përfaqësuesve romë, OSBE-ja ka ndërmarrë aktivitete për përforcim të kapaciteteve të këshilltarëve romë, duke ju mundësuar atyre trajnim bazik për decentralizim (2006) dhe qeverisje lokale (2007-2010, duke përfshirë një projekt i cili ka synuar këshilltarët romë në Shuto Orizare në 2007). Iniciativat e mëtutjeshme për përforcim të kapaciteteve gjithashtu i kanë përfshirë mes tjerëve edhe këshilltarët romë (që nga 2006 deri më sot). Instituti demokratik kombëtar (NDI) ka ofruar trajnime të ngjajshme (*një pako e trajnimeve për qeverisje të mirë*) për të gjithë këshilltarët romë të cilët kanë shprehur interes që nga zgjedhjet lokale të 2009. Siqë raportohet, rezultati kryesor i përpjekjeve të tilla trajnuese ka qenë që zvoglohen dallimet dhe armiqësia politike pas zgjedhjeve dhe të përforcohet komunikimi mes këshilltarëve.

**89) Zyrtarët e zgjedhur duhet të krijojnë marrëdhënie të ngushta pune me komunitetin rom dhe sinti.**

Komuniteti rom në përgjithësi është i shkëputur nga politikat kombëtare. Përfaqësuesit e zgjedhur romë nuk krijojnë marrëdhënie pune me popullatën rome, as po e përfshijnë aktivisht komunitetin e tyre në jetën politike jashtë rolit të tyre gjatë zgjedhjeve. Një rreth i vogël i qytetarëve romë, shpesh të ndërlidhur me partitë politike, përfshihen në punën e përfaqësuesve të zgjedhur. Jashtë kësaj, përforcimi i komunitetit rom për ti ushtruar të drejtat e tij mvaret nga përpjekjet sporadike të OJQ-ve dhe vepruesve ndërkombëtar. Mes këtyre të fundit është edhe

<sup>126</sup> Decade Watch MK 2010, f. 52-53.

<sup>127</sup> Eben Friedman, 8 nëntor 2010.

OSBE-ja, e cila përmes projekteve për përforsim të kapaciteteve është përpjekur që ta përforsojë mirëkuptimin e këshilltarëve lokal për rolin e tyre.

Përfaqësuesit e zgjedhur romë përfshijnë një numër të OJQ-ve rome në vendimet politike. Megjithatë, tendenca është që të përfshihen vetëm disa OJQ shumë mirë të etabluara, të cilat zakonisht i përfaqësojnë regjionet ku janë edhe të vendosura. Nuk është e rrallë përshtypja se OJQ-ët rome shihen nga popullata si të largëta nga komuniteti të cilin ato e përfaqësojnë.

Duhet të theksohet se gjatë kësaj periudhe raportuese, Partia e bashkuar për emancipim organizoi një seminar për degën e tyre rinore në Shkup.

***90) Të krijohen mekanizma të cilat do të sigurojnë komunikim të barabartë, të drejtëpërdrejtë dhe të hapur mes përfaqësuesve romë dhe autoriteteve qeveritare, përfshirë organet këshilluese dhe konsultuese.***

Ekzistojnë dy mekanizma formale për të siguruar komunikim mes përfaqësuesve romë dhe autoriteteve qeveritare dhe për koordinim të politikave lidhur me çështjet rome.

I pari është krijimi i pozitës së Ministrit pa resor, përgjegjës për punët rome. Kjo mundëson komunikim dhe lobim tek autoritetet qeveritare, përfshirë takimet mujore në nivel të ministrave lidhur me politikën rome. Megjithatë, prezenca tek to zakonisht është shumë e dobët.

Mekanizmi i dytë është Trupi koordinues për zbatimin e Dekadës për përfshirje, e cila kryesohet nga Ministri pa resor Nexhdet Mustafa dhe menaxhohet nga Njësia për zbatimin e Dekadës për përfshirje të romëve (MPPS). Përfshin përfaqësues nga të gjitha institucionet relevante për çështjet rome si dhe OJQ rome. Ka për qëllim që të sigurojë koordinim mes ministrave të përfshira në zbatimin e Dekadës, duke nxitur komunikim të hapur mes anëtarëve të tij. Edhe pse në fillim takoheshte rregullisht dhe kishte për detyrë që ti krijojë Planet vepruese të Dekadës, ka dështuar që të takohet për më tepër se një vit. Mungesa e koordinimit mes Kabinetit të Ministrit dhe Njesisë e pengon përdorimin efektiv të këtij mekanizmi.

Përfaqësuesit nga ministratë e përfshirë në aktivitetet e dekadës dorëzojnë raporte kuartale tek Njësia lidhur me zbatimin e Planeve vepruese. Njësia ia transmeton informatat Kabinetit të Ministrit, i cili pastaj i publikon në Ueb-faqen e tij.

Raportet e fundit të pranuar dhe të qarkulluara nga Kabineti janë të muajit mars, 2010.

***91) Të lehtësohet bashkëveprimi mes udhëheqësve politik në nivel lokal dhe kombëtar dhe grupeve të ndryshme rome.***

Bashkëveprimi mes udhëheqësve politik romë dhe shoqërisë civile, e cila përfaqëson grupe të ndryshme rome është nën ndikim të madh nga përkatësia politike dhe nuk është qartësisht i institucionalizuar. Tendencia në shtet është e tillë që në konsultime të përfshihen vetëm disa OJQ shumë mirë të etabluara, gjë e cila e pengon përfaqësimin e grupeve të ndryshme etnike.

Brengë shtesë është bashkëveprimi i varfër mes udhëheqësve politik në nivel lokal dhe kombëtar. Kjo bazohet në mekanizmat joformal dhe nuk është e uniformuar nëpër shtet, Ministri Musata para një kohe nënshkruajti Memorandum për mirëkuptim për zbatimin e Dekadës vetëm me një të katërtën e komunave.

Tensionet ndërpartiake e pengojnë bashkëpunimin dhe dialogun konstruktiv në të gjitha nivelet: mes institucioneve lokale dhe qendrore; brenda këshilleve lokale; mes institucioneve në

nivel qendror. Përpjekje për tu ndërtuar ura mes vepruesve politik janë të rralla. OSBE-ja dhe vepruesit e tjerë ndërkombëtar kanë organizuar trajnime për përforsim të kapaciteteve të përfaqësuesve romë dhe të rinjve duke qëlluar që të promovojnë bashkëpunim më efikas dhe konstruktiv mes tyre. Projekti i OSBE-së në vitin 2007 *Përkrahje për romët etnik në komunën e Shuto Orizares dhe Pakoja trajnuese për këshilltarët komunal romë* janë shembuj të dukshëm. Megjithatë, gjendja mbetet e pakënaqëshme dhe lidërshipi politik shumë i ndarë.

**92) Të organizohen fushata për rritje të vetëdijes zgjedhore për ta rritur pjesëmarrjen e elektoratit rom në zgjedhje.**

Fushatat për rritje të vetëdijes për zgjedhjet dhe programet të cilat do ta rrisin pjesëmarrjen e informuar të elektoratit rom nuk organizohen nga institucionet shtetërore ose lokale. Përfaqësuesit romë dhe shoqëria civile shpreh keqëardhje për atë se popullata rome në përgjithësi mbetet e pavetëdëshme për ‘fuqinë e zërit të saj.’<sup>128</sup> Pjesëmarrja e saj shpesh sigurohet përmes praktikave jo-diskrete dhe jo-transparente. Të dhëna të përpikta për dalshmërinë e qytetarëve romë nuk ka dhe më tej komplikohen mes divergjencës të votuesve të regjistruar dhe atyre të banorëve sipas regjistrimit të popullësisë në 2001.<sup>129</sup>

**93) Të mundësohet që votuesit romë të mund të bëjnë zgjidhje të lirë dhe të informuar gjatë zgjedhjeve.**

Votuesit romë shpesh votojnë për partitë rome, zakonisht duke i shprehur preferencat e tyre për koalicionet të cilave partitë rome ju bashkangjiten,<sup>130</sup> ose kandidatët romë në rast të zgjedhjeve lokale. Gjerësisht njihet se fushatat në komunitetin rom kanë shumë pak të bëjnë me promovimin e programeve të detajuara dhe më shumë në ofrimin e të mirave materiale. Nivelet e ulta të arsimit, disiluzioni nga iniciativat e kaluara politike dhe brengat nga nevojat më të shpejta materiale e parandalojnë elektoratin rom për tu angazhuar në çështjet politike dhe që të bëjnë zgjidhje të informuara gjatë votimit të tyre.

Veprimet bindëse gjatë ushtrimit të drejtë për votim janë të rralla.

Programet për rritjen e vetëdijes të votuesve romë për të drejtën e tyre të votës dhe për rregullat ligjore kryesisht organizohen nga vepruesit ndërkombëtar. NDI në veçanti është aktiv gjatë fushatave elektorale në shpërndarjen dhe botimin e materialeve për praktikën votuese. Sa u takon zgjedhjeve të 2008 dhe 2009, fushata mediale e NDI përfshiu materiale edukuese në gjuhën rome dhe vizita në komunat rome. OSBE-ja shumë pak është përfshirë, më së shumti përmes fushatës, *Romë, jepni votën tuaj me urtësi*, e cila sytonte kryesisht gratë e elektoratit rom.

**94) Të ndërmerren masa për ti garantuar të drejtat e barabarta votuese për gratë, duke e ndaluar të ashtuquajturin “votim familjar”.**

Rregullat dhe procedurat sa u takon vend votimeve në ditën e zgjedhjeve janë qartësisht të përcaktuara dhe mbikqyrësit janë adekuatish të trajnuar për ta parandaluar votimin familjar.<sup>131</sup>

<sup>128</sup> Ministri pas resor, Nexhdet Mustafa.

<sup>129</sup> Të dhëna për pjesëmarrjen në zgjedhje sipas komunave janë të disponueshme në ueb-faqen e Komisionit shtetëror zgjedhor (Drzavna Izborna Komisija, www.sec.mk).

<sup>130</sup> Koalicioni aktual në qeveri i përfshin pesë partitë kryesore rome: Unioni i romëve në Maqedoni, Partia e bashkuar për emancipim, Partia për integrimin e romëve, Unioni demokratik i romëve, Partia për emancipim të plotë të romëve.

<sup>131</sup> OJQ ‘Most’ organizoi trajnim për mbikqyrësit lokal.

Raste ku gratë rome janë parandaluar që ta ushtrojnë të drejtë e tyre të votës në mënyrë të fshehtë u raportuan në zgjedhjet e fundit.<sup>132</sup>

Në aspekt të parregullësive në zgjedhjet parlamentare të 2008, OSBE-ja prodhoi një spot televiziv për ti inkurajuar gratë rome për të votuar lirshëm në mars të 2009, gjegjësisht në zgjedhjet presidenciale dhe lokale. NDI pohon se familjet rome zakonisht i zbatojnë kërkesat e mbikqyrësve lidhur me rregullat detyruese, edhe pse kërkesat e tilla jo gjithmon bëhen.<sup>133</sup> Shteti nikoqir mund të luaj një rol më të madh në inkurajimin e mbikqyrësve që ti zbatojnë më rreptësisht rregullat detyruese në vend votimet dhe në promovimin e programeve për barazi gjinore në përgjithësi.

***95) Të inkurajohen romët dhe sintit për tu përfshirë më aktivisht në shërbimin publik, përfshirë edhe kur është e nevojshme përmes inicimit të masave të posaçme për të promovuar pjesëmarrjen e tyre në shërbimin civil.***

Parimi i përfaqësimit të drejtë është mekanizmi kryesor ekzistues për të siguruar nivele më të mëdha të punësimit të qytetarëve romë në shërbimin publik. Tendenca e punësimit të romëve në shërbimin publik është pozitive edhe pse është me e ulët se përqindja e paraparë prej 2.66% nga numri i përgjithshëm.<sup>134</sup> Siqë theksohet në Rec. 48, disa nga masat të cilat promovojnë pjesëmarrjen e romëve në shërbimin civil po zbatohen. Rritja e nivelit të arsimit tek popullata rome, qëllim të cilin shteti nikoqir është i zotuar për ta arritur, gjithashtu paraqet një mjet kyç për angazhimin e qëndrueshëm të qytetarëve romë në shërbimin civil.

***96) Të inkurajohet përfaqësimi i romëve dhe sintive në pozitat e zgjedhura dhe të emruara në të gjitha nivelet e qeverisë.***

Pas OFA, përfaqësimi i pakicave në pozita të zgjedhura dhe të emruara në të gjitha nivelet e qeverisë, domethënë është rritur. Në nivel qendror, zgjedhjet e fundit parlamentare rezultuan në 2 deputetë romë. Njëri prej tyre pas një kohe u emrua si Ministër pa resor. Anëtarë të komunitetit rom janë emruar në pozita kyçe brenda institucioneve publike (p.sh. Zëvendës ministri për drejtësi, Drejtori i Drejtoratit për zhvillimin e arsimit në gjuhën e komuniteteve, Udhëheqësi i Departamentit për koordinim dhe asistencë të MPPS, Drejtori i Drejtoratit për mbrojtje dhe shpëtim).

Përfaqësimi i romëve në pushtetin lokal është i kufizuar, por jo edhe i anëshkaluar. Rreth 20 qytetarë romë janë zgjedhur si përfaqësues në këshillet lokale në 2009. 14 prej tyre janë të vendosur në Këshillin komunal të Shuto Orizares, ndërsa pjesa tjetër në komunat e tjera (kryesisht në Gostivar, Kërçovë, Dibër, Prilep, Maxhari, qyteti i Shkupit dhe Kumanovë). Disa komuna ku popullata rome përbën më tepër se 2% të banorëve lokal nuk kanë përfaqësues të zgjedhur romë. Shuto Orizareja është kryesuar nga kryetarë të përkatësisë etnike rome që nga viti 1996. Gati të gjithë romët e përzgjedhur veprojnë në partitë etnike rome dhe mbesin të nën-përfaqësuar në ato kryesoret.<sup>135</sup>

***97) Të përforcohen dhe të integrohen individët romë dhe sinti në proceset e vendim-marrjes të kombëtare dhe lokale dhe vendbanimeve, si përfaqësues të zgjedhur të komuniteteve të tyre dhe si qytetarë të atyre shteteve.***

<sup>132</sup> International Election Observation Mission, Early Parliamentary Elections – FYROM, “Statement on Preliminary Findings and Conclusions”, 1 June 2008.

<sup>133</sup> Chris Henshaw, NDI, i intervistuar më 9 nëntor 2010.

<sup>134</sup> REF, “Advancing Education of Roma in Macedonia”, 2007, f. 18.

<sup>135</sup> Një përjashtim është këshilltari rom lokal në Kumanovë.

Përfshirja efektive e përfaqësuesve romë në proceset e vendim-marrjes mbetet ende për tu përforcuar. Kontributi i tyre pengohet nga mungesa e eksperincës dhe kapacitetit në sferat e administratës publike dhe politikës. Vepruesit ndërkombëtar, përfshirë edhe OSBE-në, kanë organizuar trajnime bazike për qeverisje dhe administratë [Shih Rec. 88] si dhe për advokim, lobim dhe angazhim politik.

Me qëllim që të sigurojnë përfshirje më efektive në sjelljen e vendimeve në ardhmëri, partitë politike rome ngadal kanë filluar që të përfshijnë anëtarë të rinj romë të arsimuar në pozita këshilldhënëse. Një gjeneratë e aktivistëve romë po integrohet në proceset e vendim-marrjes. Profesionalizimi i tyre mund të përkrahet përmes programit trajnues të NDI për aktivistët e rinj romë (që nga 2007), ose përmes përfshirjes të studentëve romë si moderues në trajnimet për këshilltarë (projekt i OSBE-së *Përkrahje për romët etnik në komunën e Shuto Orizares*, 2007).

**98) Të promovohet pjesëmarrja e grave rome në jetën publike dhe politike; gratë rome duhet të kenë mundësi që të marrin pjesë në nivel të barabartë me burrat në mekanizmat konsultative dhe ato të tjera të dizenuara për ta rritur qasjen e të gjithëve në jetën publike dhe politike.**

Edhe përpos të miratimit të Panit të parë për veprim për përmirësimin e statusit të grave rome (2008-2010), nuk ka progres të dukshëm në përforcimin e pjesëmarrjes të grave rome në jetën publike dhe politike. Aktivitetet e planifikuara nuk janë financuar. Shembujt e grave aktiviste dhe nëpunëse shtetërore nuk janë të rralla por janë të kufizuara.

Rolet tradicionale familjare rezultojnë në ndjekshmëri më të ulët shkollore të vajzave, punësim më të ulët tek gratë dhe si pasojë shpëputje nga jeta publike dhe politike, në plotësim të diskriminimit të dyfishtë në bazë të racës dhe gjinisë.<sup>136</sup> Tendencat e njëjta ndodhin edhe mes komuniteteve të tjera edhe përpos të miratimit të Ligjit për mundësi të barabarta.

Projektet e OJQ-ve dhe organizatave ndërkombëtare të cilat synojnë në veçanti pjesëmarrjen politike të grave janë të rralla. Projekti i OSBE-së, *Përforcimi politik i grave rome*, në vitin 2006 është një përjashtim i dukshëm i cili ishte në përfitim të 20 grave rome. Projekti kishte për qëllim ta inkurajojë pjesëmarrjen e këtyre grave në proceset e vendim-marrjes organizuese dhe në komunitet dhe për tu angazhuar në jetën politike.

---

<sup>136</sup> 2010 EU Progress Report, f. 18. MPPS Sektori për mundësi të barabarta dhe UNIFEM, "Even if I complain, there will be no effect", 2009.

## **Kapitulli VII i PV – Romët dhe sintit në kriza dhe situara pas krizas**

***107) Të konsultohet popullata rome dhe sinti gjatë përcaktimit të situatave krizore me qëllim që të mundësohen procedura adekuate dhe të identifikohen vendet specifike gjeografike nga të cilat refugjatët dhe personat të zhvendosur brenda vendit braktisen, si dhe të mundësohet adresim i situatës specifike të romëve dhe sintive.***

Regjioni i Evropës jug-lindore ka qenë i prekur nga zhvendosja e mijërave romë të arratisur nga Kosova (1999-2000). Rreth 2,000 refugjatë romë<sup>137</sup> të numëruar nga shteti nikoqir në fund të 2004,<sup>138</sup> kanë mbetur këtu deri më sot. UNHCR raporton se ka 1,559 raste të personave të cilët kërkojnë azil, refugjatë, persona nën mbrojtje subsidiare dhe persona të cilët gjenden në situata si refugjatët<sup>139</sup> (definicionet e UNHCR). Rreth 90% e tyre janë romë nga Kosova. Situata adekuatshëm trajtohet nga institucionet shtetërore të cilat bashkëpunojnë me UNHCR-ën që nga fillimi i krizës. Meqenëse kushtet për tu kthyer në Kosovë nuk janë krijuar, MPB ka treguar fleksibilitet për tu dhënë status *qëndrim tolerantë* shumë romëve nga Kosova.

***108) Të mundësohet që popullatat rome dhe sinti të cilat gjenden në gjendje të shpërnguljes së detyruar (refugjatë dhe IDP-ët) të regjistrohen në kohë dhe të paisen me dokumentet relevante.***

Shteti nikoqir ka miratuar ligje të përshtatshme për azil dhe mbrojtje të përkohshme, si dhe rregulla për ti paisur refugjatët me dokumentet relevante të cilat janë në pajtim me statusin e tyre të qeniurit refugjat, persona nën mbrojtje subsidiare ose persona të cilët janë në gjendje të ngjajshme si refugjatët. Pas procedurave ligjore dhe intervistave, refugjatët u paisën me kartela për identifikim të cilat përtrihen çdo vit.

Njerëzit, qëndrimi i të cilëve toleroheshte, mirëpo nuk kualifikoheshin si refugjatë, u paisën me kartela të verdha, ku janë shënuar të dhënat bazike personale dhe me të cilat kanë qasje në shërbimet e disponueshme, të cilat ripërtrihen çdo katër muaj. Procedura për fitimin e dokumenteve nuk parashihte që romët të dorëzojnë dokumente personale: një deklaratë ishte e mjaftueshme për regjistrim. Sipas UNHCR-ës, ripërtirja e dokumenteve është e thjeshtë dhe e qasëshme. Procedura për romët e zhvendosur në gjendje të ngjajshme si ajo e refugjatëve, aplikacionet e të cilëve për azil janë rrefuzuar ose të cilat duan që të fitojnë leje për qëndrim të përkohshëm është pak më e gjatë dhe më e vështirë. Zyra e cila merret me kërkesat për dokumente hapet një herë në javë në Vizbegovë, afër Shuto Orizares, ku edhe shumica e romëve nga Kosova jetojnë. UNHCR dhe OJQët partnere nëpër shtet ju mundësojnë asistencë juridike falas të gjithë atyre *personave në çështje*.

---

<sup>137</sup> Ky term përdoret lirshëm këtu për ti emruar romët nga Kosova pavarësisht të statusit të tyre. Këto janë njerëz të cilët UNHCR i emron si ‘persona në çështje’.

<sup>138</sup> Të dhëna nga “Strategjia kombëtare për romët në Republikën e Maqedonisë” dhjetor 2004, f. 67. Ky numër gjithashtu përfshin njerëz të cilët e deklarojnë veten si egjiptian dhe ashkali. UNHCR jep të dhëna të grumbulluara.

<sup>139</sup> Kjo kategori përfshin: personat të cilëve nuk ju është dhënë azil, prezenca e të cilëve tolerohet në shtet; persona të cilët kanë krijuar relacione me shtetatsit lokal, por të cilët nuk i kanë dokumentet e nevojshme për të fituar leje rezidence.

**109) Shtetet anëtare duhet të mundësojnë programe të cilat promovojnë zgjidhje të informuar lidhur me vendimin e refugjatëve romë dhe sinti, si dhe të IDP-ve lidhur me zgjidhjet e qëndrueshme për situatat e tyre, përfshirë edhe realizimin e të drejtës së tyre për një kthim të sigurt, denjshëm dhe të qëndrueshëm. Programet e tilla duhet të japin informata konkrete për secilën temë e cila i brengos refugjatët dhe IDP-ët dhe duhet të jenë të disponueshme në gjuhën relevante.**

Nuk ka programe të strukturuar për promovimin e zgjidhjeve sa i takon çështjes së kthimit. Nuk ka riatdhesim të detyruar. Deri tani UNHCR ka dhënë informata për mundësitë të cilat janë në disponim për romët e zhvendosur. Riatdhesim vullnetarë dhe i lehtësuar në Kosovë dhe Serbi ka ndodhur në 2010 me një numër të 86 personave, mirëpo nuk ka të dhëna për përkatësinë e tyre etnike.<sup>140</sup>

Në Shuto Orizare ka programe të cilat i informojnë refugjatët dhe IDP-ët për çështjet në interes të tyre. Qendra e komunitetit e cila mundëson informata dhe paisje për grumbullim ka edhe personel të Kryqit të kuq. Nga ana e UNHCR gjithashtu shpërndahen informata për çështje të tjera, në veçanti të ndërlidhura me shëndetin, zakonisht gjatë shpërndarjes së pakove higjienike përmes medijuesve romë (që nga 2009) ose tek ambulanca në Shuto Orizare. Këtu refugjatët përfitojnë nga paisjet e deidkuara për ta. Në çdo katër muaj brenda komunitetit rom shpërndahen fletushka në gjuhën rome.

Brenda komunitetit është krijuar ndonjë lloj i organizimit/advokimit: edhe përpos të qenit jo-efektiv dhe dobët të organizuar, komitetet spontane të refugjatëve gjithashtu shpërndajnë informata dhe janë të zëshëm për brengat e komunitetit.

**110) Të sigurohet trajtim në pajtim me normat relevante ndërkombëtare dhe standardet për mbrojtje dhe në një mënyrë jodiskriminuese për refugjatët romë dhe sinti.**

Në përgjithësi trajtimi i refugjatëve është në përputhshmëri me normat dhe standardet ndërkombëtare. UNHCR raporton se ka një fleksibilitet të rëndësishëm nga ana e shtetit për të siguruar mbrojtjen e romëve të zhvendosur.<sup>141</sup> Diskriminimi në baza etnike ndaj refugjatëve romë nuk dallon nga ai i përjetuar nga qytetarët e përkatësisë etnike rome.

Në disa raste janë shprehur brenga për trajtimin e romëve nga Kosova të cilët janë në situata të ngajshme me refugjatë.<sup>142</sup> Nuk sfidohet prezenca e tyre në shtet, mirëpo qasja e tyre në shërbime (punësim, shëndetësi, banim, arsim) është e kufizuar dhe mbështetet në UNHCR-ën (përmes Kryqit të kuq maqedonas). UNHCR parasheh një rol më të madh të qeverisë në mundësimin dhe financimin e shërbimeve për refugjatët dhe personat nën mbrojtje subsidiare nga fillimi i pranverës në vitin 2011. Gjithashtu e ka inkurajuar qeverinë që t'ju japë të gjithë personave në pyetje staus të vlefshëm legal, për t'ju siguruar qasje deri tek shërbimet bazike të gjithë romëve të zhvendosur nga Kosova.<sup>143</sup>

---

<sup>140</sup> UNHCR Statistics for The Former Yugoslav Republic of Macedonia, të dhëna nga personeli i UNHCR, 18 nëntor 2010.

<sup>141</sup> Intervistë me Vladimir Vasilevski, UNHCR program asistent, 4 nëntor 2010, dhe Tihomir Nikolovski, UNHCR asistent juridik, 18 nëntor 2010.

<sup>142</sup> EU Progress Report 2010, f. 22.

<sup>143</sup> Intervistë me Vladimir Vasilevski, 4 nëntor 2010.

***111) Të përdoret roli i ODIHR-ës në parandalimin e konflikteve dhe identifikim të fushave për intervenim të hershëm dhe të plotësohet eksperinca OSBE HCNM në këtë aspekt.***

Sot, shteti nikoqir ballafaqohet ende me situatën e personave romë të cilët janë arratisur nga Kosova përpara 10 viteve. Duhet që fokusi t'ju kushtohet më tepër zgjidhjeve të qëndrueshme dhe afat gjata se sa intervenimeve të hershme. Qasjet regjionale koordinohen nga BE-ja, ndërsa OSBE/ODIHR ofron përkrahje shtesë.

***112) Tu kushtohet vëmendje e posaçme nevojave të grave dhe fëmijëve romë dhe sinti në situata të krizës dhe pas krizës, në veçanti duke ju mundësuar atyre qasje në kujdesin shëndetësor, banim dhe arsim.***

Gratë dhe fëmijët në situata të krizës dhe post-krizës nuk kanë përfitim nga programet speciale. Për shumicën e refugjatëve romë, mundësohet kujdes shëndetësor bazik në Shuto Orizare nga personeli i Kryqit të kuq, i cili ripaguhet nga UNHCR. Ky i fundit gjithashtu i mbulon shpezimet për barna dhe i pais me pako higjienike. Gjithashtu, e inkurajon personelin e Kryqit të kuq që të kontribuojë në rritjen e vetëdijes për kujdesin shëndetësor para lindjes dhe pas lindjes.

Pas inicimit të Strategjisë për integrimin e të huajve, për personat me rezidencë të përkohëshme në 2008, asistencë e kujdesit shëndetësor duheshite të futet në sistemin kombëtar dhe në këtë mënyrë të financohet nga shteti. UNHCR identifikoi disa mangësi në zbatim, të cilat i korrigjoi me resurset e veta. Shpreson që të ketë përfshirje më të madhe nga shteti në pranverë të 2011. Edhe pse shteti do të sigurojë qasje të barabartë në kujdes shëndetësor për të gjithë refugjatët me status legal, participimi në para si dhe shpenzimet për barna nuk do të anulohen. UNHCR pret që të ketë rënie të kualitetit të kujdesit shëndetësor për romët dhe përfshirje të vazhdueshme nga ana e tyre për ti plotësuar mungesat dhe për të siguruar qasje në kujdesin shëndetësor bazik për të gjithë.

Sa u takon nevojave të fëmijëve, atyre ju mundësohet arsimi. Fëmijët e zhvendosur romë zakonisht regjistrohen në shkollat fillore në Shuto Orizare, të cilat më kanë mungesë të kapacitetit dhe janë të përplota. UNHCR i përkrah ato me shërbime parashkollore, materiale shkollore, mentorim dhe asistencë gjuhësore në Qendrën e komunitetit. Imunizimi i fëmijëve zakonisht bëhet në institucionet arsimore.

Banimit është një problem i posaçëm. Familjet refugjate, paraprakisht të vendosura në njësi brenda qendrave kolektive, jetonin në vendbanime të marra me qira. Qirat dhe paisjet, ishën kryesisht të financuara nga UNHCR. Edhe përpos të pritjeve se amandmanet e 2010 të Ligjit për mbrojtje sociale, do të mundësojnë refugjatët që të aplikojnë tek qendrat për punë sociale për asistencë dhe banim, ka mungesa të dukshme në zbatim. Çështjet e legalitetit të ndërtimeve dhe pronave e parandalojnë shtetin që t'ju mundësojë financim. Bashkëpunimi mes shtetit dhe UNHCR-ës duhet të rezultojë në banime sociale dhe projekte për banim të vetëndihmuar, të cilat do të mundësojnë akomodim për 60 familje deri në mars 2011.



### III. MËSIMET E MËSUARA DHE PRIORITET PËR TË ARDHMEN

#### Çka ka ndihmuar dhe çka ka penguar zbatimin

Analiza më lartë nënvizoi rezultatet dhe dobësitë në zbatimin e Planit veprues (PV) të OSBE-së në shtetin nikoqir. Masat dhe aktivitetet e ndërmarra për t'iu qasur çdo çështjeje janë të ndryshme. Sido që të jetë, mund të nxjerren disa mësimet të mësuara të zbatueshme në sferat e të gjitha çështjeve. Identifikimi i faktorëve kyç të cilët ndihmojnë ose pengojnë zbatimin e politikave dhe projekteve që kanë për qëllim përmirësimin e situatës së popullsisë romë në shtetin nikoqir do të lehtësojnë planifikimin efektiv të aktiviteteve të ardhshme.

#### Faktorët që nxisin progres

##### 1. Përfshirja e të gjitha palëve të interesuara në dizejnimin e politikës/projektit

Përfshirja e të palëve kyçe të interesuara në dizejnimin e politikave që kanë të bëjnë me Romët nxit bashkëpunim dhe dialog mes aktorëve. Kjo garanton se informatat shpërndahen, programet e reja nuk hasin në kundërshtim nga institucionet relevante dhe se shqetësimet e të gjitha palëve të interesuara janë marrë seriozisht në konsideratë.

Puna me vizion të përbashkët për një qëllim të përbashkët kontribon në zbatimin e suksesshëm të politikave dhe në fuqi efektive për të ndikuar në agjendën shtetërore mbi çështjet e romëve.

Aktiviteti i grupit përfshirës punues i obliguar për projektimin e Planit veprues për Dekadën e përfshirjes së romëve në vitin 2005 dhe koordimi pauses i aktiviteteve brenda trupit Koordinues kombëtar deri në vitin 2007 janë shembuj të praktikave të mira (në përputhje me Rekomandimet e PV nr. 4, 88 dhe 90). Konsultimet gjatë procesit të projektimit të ligjit për antidiskriminim paraqesin poashtu praktikë pozitive. (Rec. 8).

##### 2. Caktimi i romëve në pozicione nga të cilat mund të ndikojnë në politika

Zotërimi i politikave që ndikojnë romët (rek. 4) dhe mundësia për të lobuar për to, duke u siguruar në mënyrë konstante se çështjet e romëve janë të përfshira në agjendën nacionale përfitojnë nga prezenca e përfaqësuesve romë në role kryesore përbrenda institucioneve shtetërore.

Krijimi i pozicionit të ministrit, i ngarkuar me çështjet romë ka potencial për të çuar drejt progresit të madh, duke iu falënderuar qasjes së tij në mbledhjet qeveritare dhe diskutimet buxhetore. (Rec. 90 dhe 96). Shembull pozitiv se si caktimi i qytetarëve të aftë romë në role relevante institucionale mund të determinojë progres mund të gjendet në sferën e arsimit (Rec. 68).

##### 3. Inkurajimi nga aktorët ndërkombëtarë dhe partneriteti në dizejnimin, zbatimin dhe vlerësimin e programit/projektit

Përvoja e aktorëve ndërkombëtarë dhe donatorëve në identifikimin e nevojave, dizejnimin e programeve dhe vlerësimin e rezultateve luan rol pozitiv në asistimin e institucioneve shtetërore

dhe OJQ-ve. Inkurajimi i autoriteteve shtetërore për tu fokusuar në dobësitë e identifikuar dhe prioritetet të reja mund të çojnë drejt angazhimit më të lartë të shtetit nikoqir me këto çështje.

Përpjekjet e zgjeruara në fushën e arsimit parashkollor vijnë nga FOSIM, USAID dhe inputet e OSBE-së (MC dhjetor 6/08 dhe 8/09). Presioni ndërkombëtar, në veçanti nga UNHCR dhe UNICEF, për aksion proaktiv në fushën e dokumentimit rezultoi me progres të rëndësishëm (Rec. 87 dhe 108). Partneriteti dhe aktivitetet për ndërtimin e kapaciteteve në mes aktorëve ndërkombëtar dhe atyre kombëtar poashtu nxisin rezultate pozitive në zbatim në pajtim me rekomandimet e PV (p.sh. Aktivitetet e PDD, Rec. 26 dhe 28). Ndërtimi i kapaciteteve të partnerëve zbatues (p.sh. Sumnal, AHRPR) kanë qasje të vlefshme nga ana e Misionit të OBSE-së.

#### 4. Vëmendja e pëkushtuar për Romët në politikat dhe projektet e përgjithshme

Kushtimi i vëmendjes ndaj çështjeve romë dhe përfshirja e romëve si grup i prekshëm nga ana e politikave dhe projekteve shtetërore garanton se ata nuk janë negativisht të prekur dhe se hendeuku mes tyre dhe pjesës tjetër të popullsisë nuk zgjerohet. Përfshirja e romëve në programet sociale përfshirëse duhet të jetë komplementare me programet e targetuara sesa të zëvendësojë ato. Progresi për këtë target grup nuk duhet të bëhet qëllim sekondar kur çështjet romë janë përfshirë si politika të përgjithshme. Në këtë kontekst, involvimi i ekspertëve për çështje të minoriteteve dhe OJQ-ve nga komuniteti rom është rrënjësor për të garantuar zbatim adekuat të projekteve dhe për impakt pozitiv të tyre tek popullsia romë.

Shembuj të praktikave të mira mund të shihen në reagimet ndaj Rec. 45 (strehim social), 48 (punësim publik) dhe 58 (mbulesa e sigurimit shëndetësor)

#### 5. Aktivitete terrenike (grass-root activities)

Ngritja e vetëdijës, aktivitete derë më derë dhe involvimi direkt i organizatave të shoqërisë civile me popullsinë romë në masë të madhe kontribuojnë për tu siguruar se kushtet që shtojnë progres në politikat që kanë të bëjnë me romët në vend janë të mundësuar. Paraqitja e ndërmjetësve në arsim dhe shëndetësi, për shembull, nxiti progres. (Rec. 61, 69, 77).

#### 6. Bashkëpunimi rajonal

Shpërndarja e informative, përvojat e praktikave të mira dhe mësimet e mësuara mund të ofrojnë kahëzime për shtetin nikoqir. Nëse zbatohen, projekti për medijues në shëndetësi mund të përfitojë nga konsultimet me autoritetet bullgare të cilat zbatojnë aktivitete të ngjajshme (Rec. 61).

Poashtu, qasja rajonale dhe bashkëpunim ndërkufitar janë relevante në kontekst të refugjatëve romë dhe IDP-ve, si dhe furnizimit me dokumente të qytetarëve romë.

Programet për bashkëpunim ndërkufitar të IPA ofrojnë edhe më shumë mundësi për kolaborim dhe përkrahje të ndërsjelltë me qëllim të zhvillimit ekonomik dhe kohezionit social.

### **Faktorët që pengojnë zbatimin**

#### 1. Grumbullimi i të dhënave dhe menaxhimi me to

Të gjitha dimenzionet (zbatimi i ligjit dhe diskriminim, situata socio-ekonomike, arsimi) dhe çështjet e ndërlidhura (gjinia, varfëria, fëmijët, dokumentacioni) janë negativisht të ndikuara nga mungesa e të dhënave të besueshme. Prandaj, progresi me kalimin e kohës, identifikimi i zonave për veprim të mëtejshëm, hendeqet rajonale dhe nevojat e komuniteteve të ndryshme romë në vend

janë rëndë për tu matur. Transparenca dhe llogaridhënia janë të dobësuar. (Shih Rec. 9, 10, 15, 43, 52, 63, 73, 75, 77, 79, 87, 92).

## 2. Mbikqyrja dhe vlerësimi

Mangësitë e rëndësishme në mbikqyrjen transparente dhe efektive pengojnë vlerësimin e politikave, pëcaktimin e prioriteteve dhe planifikimin. Mekanizmat e vlerësimit të institucionalizuar dhe preciz mungojnë, të ndikuara edhe nga mungesa e koordinimit mes aktorëve dhe disponueshmëria e kufizuar me të dhëna të besueshme (Shih posaçërisht Rec. 11, 50, 84)

## 3. Korniza institucionale

Mandati i paqartë dhe mosbesimi i ndërsjellë mes institucioneve kryesore të ngarkuara me politika që kanë të bëjnë me romët (Kabineti i ministrit pa resor dhe Njesisë për zbatimin e Strategjisë kombëtare dhe Planin veprues të Dekadës) pengon promovimin efikas dhe efektiv të politikave dhe çështjeve që kanë të bëjnë me romët. Dyfishimi i përpjekjeve dhe pamjet konfliktuoze zbehin imazhin e lidërshiptit rom, pengojnë zhvillimin e qasjeve gjithëpërfshirëse dhe të koordinuara dhe rezultojnë në disperzimin e energjisë dhe zvarritjen e iniciativave për të bërë organizimin institucional më efektiv. Studimet e përkrahura nga aktorë të jashtëm për të shqyrtuar kapacitetin e secilit nga të dy institucionet nuk kontribuan në promovimin e dialogut mes tyre. (Shih Rec. 90-91)

## 4. Koordinimi

### a. Mes institucioneve shtetërore

Organet institucionale përgjegjëse për çështjet e romëve nuk arrijnë të bashkëpunojnë në mënyrë efektive. Trupi koordinues kombëtar, i ngarkuar me koordinimin e aktiviteteve dhe qasje të plotë që përfshin të gjitha ministritë relevante, nuk është operativ. Pozicioni relativisht i ulët i anëtarëve të tij brenda ministrive pengon ata për të marrë vendime dhe për të kontribuar në mënyrë proaktive në hartimin e politikave. Mekanizmat e konsultimeve të rregullta janë të dobëta.

Zbatimi i angazhimeve kombëtare kundrejt romëve, për më tepër, kërkon përpjekje të përbashkëta të të gjitha institucioneve publike. Organi këshillimor i zëvendësministrave dhe grupeve të punës në nivel ministror në përgjithësi janë të paefektshëm në shkaktimin e qasjeve gjithëpërfshirëse dhe praktike.

### b. Mes aktorëve shtetërorë dhe jo-shtetërorë

Konsultimet ndodhin vetëm mes institucioneve shtetërore dhe disa aktorë lokal mirë të etabluar. Edhe pse është e vetëdijshme për aktivitetet e OJQ-ve tjera, Njësia brenda MPPS dhe institucioneve tjera relevante nuk përfiton nga konsultimet e rregullta dhe të institucionalizuara me të gjithë aktorët që zbatojnë projekte të targetuara për romët. Kjo rezulton në mundësi të humbura për sinergji dhe dyfishim të përpjekjeve.

### c. Mes nivelit kombëtar dhe atij lokal

Koordinimi mes niveleve të ndryshme të pushtetit është edhe më shumë i rëndësishëm, duke pasur parasysh procesin e decentralizimit në vend dhe kompleksitetin e problemeve sociale. Prandaj, është i nevojshëm reagim i përbashkët dhe qasje e koordinuara në mënyrë adekuate mes aktorëve kombëtar dhe komunal. Strategjitë e integruara të cilat definojnë rolet e të gjithë aktorëve dhe renditja e prioriteteve duhet të formulohen në bazë të rregullt, me vëmendje të veçantë në

buxhetim dhe involvim efektiv të të gjitha komuniteteve. Komitetet për marrëdhënie mes bashkësive etnike mund të përdoret si mjet për përfshirjen e shqetësimeve dhe prioriteve të të gjitha komuniteteve, duke përfshirë edhe ato që janë pak të përfaqësuara në këshillat komunale. Përkatësia partiake përcakton bashkëpunimin mes komunave dhe nivelit qendror të qeverisë. Kjo ndikon në veçanti mbi situatën në Shuto Orizari, për shkak të divergjencave mes udhëheqësisë lokale dhe liderët politikë romë në nivel kombëtar. Mungojnë mekanizma për koordinim dhe konsultim, andaj edhe është evident disparitet i madh i situatës së komuniteteve romë në vende të ndryshme të shtetit. (Shih veçanërisht Rec. 88-91).

#### 5. Kapacitetet

Kapaciteti i dobët në çështjet politike dhe menaxheriale të përfaqësuesit romë, veçanërisht në nivel lokal, pengon promovimin efektiv të politikave që targetojnë romët, si dhe zbatimin e projekteve. Decentralizimi edhe më shumë ka theksuar këtë problem, pasi që komunat u detyruan të ndërmarrin rol më të madh. (Shih Rec. 88 dhe 97).

#### 6. Finansimi

Finansimi i kufizuar për çështjet romë është njëri ndër faktorët më të mëdhenj që ngadalëson progresin në përmirësimin e situatës së popullsisë romë. Edhe pse mjetet e disponueshme në shtetin nikoqir nuk janë ekstremisht të larta, një lobim më efektiv nga ana e aktorëve relevantë romë dhe autoriteteve ndërkombëtare mund të kontribuoj për të sjellur çështjen e romëve në një nivel më të lartë në agjendën shtetërore. Përkushtim më i madh do të garantonte finansim më të madh shtetëror, i cili dy vitet e fundit arrin rreth 390.000 € p.a.. Dështimi i ministrive për të harxhuar mjetet e alokuara ka rezultuar në uljen e mjeteve të alokuara për vitin e ardhshëm, duke dobësuar kështu përpjekjet për të vënë në prioritet politikat për çështjen romë.

#### 7. “Qasja nga poshtë-lartë”

Anashkalimi i rëndësisë së krijimit të një mjedisi më të favorshëm për zbatim efektiv të politikave paraqet një pengesë të pastër. Qëndrueshmëria e programeve që targetojnë popullsinë romë mund të sigurohet përmes “qasjes nga poshtë-lartë: ngritja e vetëdijes, shpërndarje e informatave dhe fuqizimi i komunitetit janë hapat e nevojshëm për progres afatmesëm dhe afatgjatë. (Shih Rec. 61, 77, 89, 93 dhe 98)

#### 8. Dështimi në targetimin e jo-romëve

Qëllimet që supozojnë integrimin dhe përmirësimin e perceptimit të romëve nga shoqëria në masë të madhe kërkojnë aksione që targetojnë popullsinë jo-romë. Kjo vlen posaçërisht për çështje të lidhura me diskriminimin dhe përfshirjen në arsimin e përgjithshëm. Zbatimi i legjislacionit është me rëndësi të veçantë, por shpesh është i dobët.

#### 9. Anashkalimi i qëndrueshmërisë afatmesme dhe afatgjate

Progresi në një varg të tillë të gjerë të çështjeve të ndërlidhura nuk mund të bëhet brenda natës. Në vend të kësaj, kjo kërkon një angazhim të zgjatur. Financimi i kufizuar në dispozicion dhe nivelet më pak se optimale të angazhimit parandalojnë shumicën e aktorëve të involvuar në projekte që targetojnë romët të elaborojnë plane afatmesme dhe afatgjate. Donatorët të cilët finansojnë projekte të ndara në vend të fokusimit në masat për ndërtimin e kapaciteteve efektive dhe afatgjate poashtu pengojnë qëndrueshmërinë e përmirësimeve.

### **Si të vazhdohet më tej?**

Raporti i statusit për zbatimin e PV të OSBE-së nënvizoi sfidat dhe fushat kryesore të cilat meritojnë përpjekje të shtuara, fokus më të madh dhe mekanizma të përmirësuar të zbatimit për progres në të ardhmen.

Përpjekjet e shtuara janë të nevojshme për përforcimin e zbatimit të legjislacionit, veçanërisht në sferën e anti-diskriminimit, si dhe për nxitjen e participimit efektiv të romëve në jetën publike dhe politike.

Fokus më i madh është i nevojshëm në qasjet gjithëpërfshirëse dhe aktiviteteve fillestare. Involvim i përforcuar i popullsisë romë, veçanërisht në nivel lokal, duke rritur pajtueshmërinë e qytetarëve me politikat që ndikojnë në ta, do të siguronte integrim më të mirë të komuniteteve të romëve në jetën sociale dhe ekonomike në vend.

Mekanizmat e përmirësuar të zbatimit kërkojnë koordinim më të mirë mes palëve të interesuara, angazhim proaktiv nga ana e institucioneve, mbikqyrje efektive dhe mekanizma për vlerësim.

## IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

### Konkluzione

Në kohë kur pjesa më e madhe e zonës së mbuluar nga OSBE ballafaqohet me pasojat e politikave të papërshtatshme për popullatën romë, shteti nikoqir shfaqet para shumicës së shteteve në përkushtimin për qasje të çështjeve që kanë të bëjnë me Planin veprues të OSBE-së. Mburret me faktin që është shteti i parë që ka përfshirë romët në kushtetutë, si popull kushtetues dhe që ka kryetarin e vetëm rom të komunës në botë. Në nivel formal, shteti nikoqir është padyshim mes pionierëve të shoqërive miqësore ndaj romëve.

Që fjalët të shndërrohen në vepra nevojitet përkushtim i fortë nga udhëheqësia dhe prania e kushteve të nevojshme në nivelin bazë. Prej vitit 2003 dhe veçanërisht rreth vitit 2005 shteti përparoi dukshëm në përcaktimin e strategjive dhe planeve të aksionit për popullatën romë. Nisja e Dekadës së Përfshirjes së Romëve krijoi dinamizëm dhe eufori që së shpejti u zbehën. Ka pasur përparim deri në ditën e sotme, sa i përket legjislaturës, arsimit dhe pjesëmarrjes politike të popullatës romë në shtet. Kjo ka të bëjë edhe me inkurajimin ndërkombëtar, perspektivën e BE-së dhe rekomandimet e OFA.

Aktivitetet janë sporadike, mungon sistematizimi dhe mbikqyrja, si dhe ka neglizhencë sa i përket pikëpamjes afatgjate. Veç kësaj, udhëheqësia politike e romëve është tepër e ndarë që të promovon në mënyrë efektive interesin e komunitetit të tyre. Përfundimisht, nuk është bërë ajo që është e nevojshme për mobilizimin dhe fuqizimin e qytetarëve romë si dhe nuk është rritur vetëdija e tyre mbi çështjet që kanë të bëjnë me ato. Qasja nga lartë-poshtë për përmirësimin e gjendjes së romëve në shtetin nikoqir do të duhet të përputhet me vepra në nivel komunal. Vetëm atëherë mund të arrihet zhvillim i qëndrueshëm.

Dekada e përfshirjes së romëve (2005-2015) tash është në stadin e mesëm. Shteti nikoqir do të merr presidencën rrotulluese (korrik 2011). Shteti ka një ministër rom i cili është përgjegjës për çështjet romë. Është formuar një elitë e romëve të ri dhe të arsimuar. Janë identifikuar pikat e forta dhe të dobëta të veprimeve të mëparshme dhe janë marr përfundime. Mundësia për të kapitalizuar mbi gjendjen momentale dhe përforcim të qasjes së shtetit ndaj politikave për popullatën romë nuk duhet të humben.

Shteti nikoqir duhet të lufton kur incersisë nëpërmes udhëheqësisë romë dhe bashkëpunimit efikas me shoqatën civile. Duhet të jetë proaktive në qasjen ndaj gjithë aktorëve të rëndësishëm dhe partnerëve ndërkombëtar me plane strategjike dhe operative mirë të organizuara, gjithëpërfshirëse dhe të baraspeshuara.

Komuniteti ndërkombëtar duhet të përkrah një qasje të tillë. OSBE dhe organizatat tjera mund të luajnë rol kyç në inkurajimin e përparimit të mëtutjeshëm, të dukshëm dhe të qëndrueshëm të situatës së romëve në shtet. Inkurajimi publik nga OSBE SMMS, në bashkëpunim me aktorët tjerë ndërkombëtar dhe përfshirja e vazhduar e ODIHR në nivel ndër-qeveritar janë fundamentale.

Duhet të përkushtohet më tepër vëmendje mbi statusin e dyfishtë të shtetit si nikoqir i Misionit të OSBE-së dhe si shtet pjesëmarrës në OSBE. Me këtë status, duhet të theksohen përkushtimet për të mbështetur dokumentet ndërkombëtare siç është PV i OSBE-së. Ky projekt në përgjithësi dhe bashkëpunim me MPPS-në në veçanti kanë kontribuar për të bërë dokumentin më të njohur. Për të përforcuar këtë moment pozitiv, OSBE mund të kontribojë për përmirësimin e një shoqërie të vërtetë multi-kulturore, në të cilën gjithë popujt përbërës janë përfshirë në mënyrë të barabartë në jetën shoqërore, ekonomike dhe politike.

## Rekomandimet

### Mmbikqyrja, vlerësimi dhe koordinimi

Rekomandohet që shteti nikoqir:

- Të rrit përkushtimin e vet dhe përpjekjet për të grumbulluar, mirëmbajë dhe të bëjë të gatshme për publikun të dhënat e besueshme, të shpërndara sipas përkatësisë etnike dhe komunës, për të mundësuar mbikqyrje të tendencave, rezultateve të politikave dhe identifikimin e nevojave për veprim të mëtutjeshëm
  - Regjistrimi i vitit 2011 mund të përdoret sikur një mundësi për të përfituar me të dhëna
  - Enti shtetërorë statistikor duhet të koordinojë procesin e grumbullimit të dhënave dhe menaxhimin e tyre. Duhet të delegojë detyra specifike për grumbullimin e të dhënave Ministrive relevante dhe institucioneve
  - Mbështetje e fuqishme nga qeveria është e nevojshme për të treguar përkushtimin dhe të sigurojë zbatimin e aktiviteteve të ndërmarra
  
- Të themelojë mekanizma të rregullta dhe standardizuar për mbikqyrjen e zbatimit dhe rezultateve të projekteve për romët në nivelin qendror<sup>144</sup>
  - MPPS, MASH, MSH, MTL dhe Ministria e Kulturës duhet të dorëzojnë raporte tremujore dhe raporte të konsoliduar vjetore për rezultatet e projekteve të financiar nga buxheti shtetëror për Dekadën. Datat e dorëzimit duhet të merren vesh çdo vit dhe duhet pajtjetër të respektohen
  - Raportet duhet të përfshijnë detaje për dizenjimin e projektit, zbatimin dhe vlerësimin. Sfidat e zbatimit të projektit duhet të theksohen dhe analizohen, në kuptim të eksperiencave të bashkëndara me ministrinë tjera dhe të planifikohen veprimet e ardhshme në mënyrë më efektive
  - Raportet duhet të grumbullohen dhe përpilohen në një dokument nga Njësia pranë MPPS-së pa asnjë vonesë. Me rëndësi është që procedura e standardizuar të zbatohet, që hartimi i rregullt dhe me kohë i dokumenteve të grumbulluara mund më lehtë të zbatohet nga secili punonjës
  - Raportet dhe materiali relevant duhet të arkivohet mirë në formë elektronike dhe të jetë lehtë qasëse nga gjithë punonjësit e Njesisë pranë MPPS
  - Dokumenti duhet të dërgohet edhe në Kabinetin e ministrit pa Resor dhe të bëhet publike pa asnjë vonesë
  - Ministri duhet të sigurojë zbatimin e mekanizmave të tilla për mbikqyrje dhe vlerësim, duke ngritur vetëdijen e ministrave tjerë për nevojën e pajtimit me aksionet e ndërmarra
  
- Të organizojë mbledhje të rregullta për të diskutuar progresin dhe të planifikojë veprimet e ardhshme pas secilit tremujor
  - Trupi koordinues kombëtar (ose revizioni, në tekstin më poshtë) duhet të takohet për çdo tre muaj menjëherë pas përpilimit të raportit. Rendi i ditës dhe

---

<sup>144</sup> Rekomandimet në këtë pjesë janë bazuar në rregullimin momental të institucioneve.

- procesverbali i mbledhjeve duhet të përpilohen në mënyrë të qartë dhe të qarkullohen në gjithë institucionet relevante
- Tryeza të rrumbullakët të organizuar dhe kryesuar nga ministri pa resor në të cilën marrin pjesë ministrat e Dekadës relevant (ose zëvendësit e tyre) dhe ministri i financave duhet të organizohen pas secilit raport tremujor. Ministri mund të shfrytëzojë këto momente të llojë për vëmendje më të madhe dhe financim të programeve për romët.
  - Të formojë mekanizma për mbikqyrjen e aktiviteteve në nivelin lokal
    - Përfaqësuesit e zgjedhur romë në nivelin lokal duhet të përfshihen në vlerësimin e rregullt dhe mekanizmat për konsultim, të kryesuar nga ministri pa resor dhe në pjesëmarrje të përfaqësuesve të Njësisë në sajë të MPPS-së
    - RIC-ët duhet të intensifikojnë aktivitetet e tyre për mbikqyrje, duke raportuar MPPS-së për iniciativat komunale. RIC-ët duhet të shkëmbejnë informata dhe njohuri për ligjet dhe rregulloret e reja të kapitujve që gjenden në Strategjinë për romët
    - RIC-ët duhet të përpilojnë raporte mujore precize dhe me kohë për aktivitetet e tyre. Formati i raporteve do të jetë i standardizuar. Duhet të theksohen aktivitetet sipas çështje-fushë, të identifikojnë sfidat dhe nevojat specifike të komuniteteve lokale të cilat gjenden nën kompetencën e tyre
  - Duhet të merr parasysh studimet për vlerësimin e nevojave dhe të veprojë sipas rekomandimeve të dhëna nga partnerët ndërkombëtar, përfshirë edhe OSBE

Rekomandohet që aktorët ndërkombëtar:

- Të inkurajojnë në mënyrë publike shtetin nikoqir të ndërmerr qasje proaktive gjatë grumbullimit të dhënave të nevojshme për identifikimin e rezultateve dhe nevojat e mëtutjeshme të politikave të synuara për romët
- Të ndihmojnë shtetin nikoqir për skicimin e situatës dhe nevojat e komunitit rom, në koordinim me gjithë aktorët relevant. OSBE SMMS mund të përfshijë edhe qëllime të qarta mbi romët gjatë angazhimit të saj për të ndihmuar shtetet në procesin e decentralizimit
- Të ndihmojnë shtetin nikoqir, nëse paraqitet nevoja dhe në koordinim me aktorët tjerë ndërkombëtar, siç është Delegacioni i BE-së, për të elaboruar forma të standardizuara të raportimit dhe mbikqyrjes të progresit mbi aktivitetet e lidhura me Dekadën
- Të ndihmojnë shtetin nikoqir për caktimin e aktiviteteve prioritare, duke inkurajuar shpërndaje resurse përkatëse për projektet e planifikuara
- Të inkurajojnë dhe ndihmojnë përfaqësuesit romë dhe institucionet relevante shtetërore të bashkëpunojnë dhe diskutojnë në një ambient pozitiv të dialogut konstruktiv
  - OSBE dhe aktorët tjerë ndërkombëtar në shtetin nikoqir duhet të dërgojnë mesazhe të fuqishme duke synuar gjithë përfaqësuesit romë. Komuniteti ndërkombëtar duhet të bashkohet në thirrjet që liderët romë të tejkalojnë ndarjet e tyre personale dhe politike, fillimisht për gjithë diskutimet teknike



- Misioni i OSBE dhe aktorët tjerë ndërkombëtare mund të angazhohen në projekte që synojnë udhëheqësinë e romëve me të cilat do të mirëmbahet krijimi i besimit, dialogut dhe profesionalizmi. Projekte të tilla mund të përfshihen në mesin e aktiviteteve të departamentit për Qeverisje të mirë të Misionit, duke ndjekur rrjedhën e projekteve të kaluara të sektorit për ngritje të kapacitetit. Duhet të planifikohen aktivitete të shpeshta për të siguruar qëndrueshmërinë e projektit dhe rezultatet e tij. OSBE duhet të koordinojë aktivitetet e saja me NDI dhe aktorë tjerë për të shmangur duplikimin e përpjekjeve dhe mundit
- Të koordinojë, me anë të takimeve të rregullta, përfshirjen e tyre në programe të lidhura me romët në shtet, me qëllim të ndarjes së përgjegjësisë duke u bazuar në fuqitë e tyre relative dhe duke shmangur duplikimin e përpjekjeve

### **Përforcimi i institucioneve përgjegjëse për çështjet e romëve**

Rekomandohet që shteti nikoqir:

- Të sqarojë rolin e secilit aktor të përfshirë në politikat e lidhura me romët, posaçërisht Ministri pa resor dhe kabineti i tij dhe Njësia për zbatimin e Strategjisë kombëtare dhe Planet e vepruese të Dekadës për përfshirjen e romëve
  - Një dialog konstruktiv është më se i nevojshëm, me qëllim të sigurimit të ndarjes përkatëse të kompetencave dhe koordinimit efektiv në të mirë të popullatës rome brenda shtetit
  - Avantazhi krahasimor i secilit institucion duhet të merret parasysh gjatë kërkimit të zgjedhjeve të mundshme: planifikimi afatgjatë dhe qëndrueshmëria; resurset njerëzore dhe financiare; kapaciteti dhe njohuritë; qasja në institucionet e niveleve të larta; lidhje me aktorët lokal
- Pasi të përcaktohen kompetencat dhe nevojat e ministrit dhe kabinetit të tij si dhe njësisë, në fund tu drejtohet institucioneve ndërkombëtare dhe lokale për të zhvilluar trajnime ose ndihmë tjetër për përforcimin e kapacitetit
- Duke shqyrtuar rekomandime nga studime profesionale dhe organizata ndërkombëtare në lidhje me punësimin dhe/ose trajnimin e stafit të kualifikuar brenda institucioneve relevante

Rekomandohet që aktorët ndërkombëtar:

- Të inkurajojnë shtetin nikoqir mos të vonojë më procesin e ri-përcaktimit të rregullimit institucional për politikat e romëve
- Të ndihmojnë shtetin nikoqir në procesin e përcaktimit të kompetencave për secilin institucion
  - OSBE duhet të sigurojë që të gjendet zgjedhje e qëndrueshme sipas parimit “Për romët, me romët, nga romët”. Përkushtimi i udhëheqësisë rome për të përvetësuar një zgjidhje të zbatueshme është kryesore për sigurimin e legjitimitetit dhe qëndrueshmërisë së rregullimit të ri institucional

- OSBE dhe komuniteti ndërkombëtar duhet të përmbahet më shumë nga propozimi i zgjidhjeve në pajtim me dëshirat e dy palëve, ministrat pa resor ose njësisë në kuadër të MPPS-së
  - OSBE duhet të inkurajojë dialog mes institucioneve, të ofrojë këshillim teknik dhe të shkëmbejë shembujt e praktikave të mira
- Të ofrojë ndihmë dhe të shpërndajë njohuritë e saja për përforsimin e kapacitetit dhe efektivitetit të institucioneve, në bashkëpunim me organizatat tjera relevante

## **Rekomandime për zbatimin e PV të e OSBE-së**

### Lufta kundër racizmit dhe diskriminimit

Shteti nikoqir rekomandohet:

- Të rritë angazhimin e tij për të zbatuar legjislacionin në fushën e antidiskriminimit, duke u nisur nga ambienti i volitshëm i krijuar pas miratimit të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi
  - Kjo duhet të zbatohet në të gjitha fushat, përfshirë shërbimet publike, edukimin, shëndetësinë dhe mediat
  - Nevojitet zbatimi i legjislacionit, procedurave dhe sanksioneve të parapara në mënyrë që të shihet se legjislacioni mund të veprojë si frenues i veprimeve diskriminuese (AP Rec. 8, 17; MC.DEC 8/09)
- Të sigurojë punë efektive të Komisionit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe ta furnizojë atë me burimet e nevojshme
  - Komisioni duhet të ketë rol proaktiv për të nisur hetime
  - Komisioni duhet të punojë në mënyrë transparente, të gjithanshme dhe të saktë, dhe të raportojë rregullisht tek institucionet relevante
  - Që në ditët e tij të para Komisioni duhet të zhvillojë një mekanizëm të mbledhjes sistematike të të dhënave, të mbikëqyrjes dhe të vlerësimit të tyre (AP Rec. 11)
- Të kujdeset që nga Ligji për ndihmë ligjore falas të përfitojnë të gjithë personat në rrezik që kanë nevojë për ndihmë ligjore falas, duke i bërë parimet kualifikuese të qasshme dhe të qarta (AP Rec. 18)
- Të sigurojë që publiku, përfshirë popullatën romë, të jetë i mirinformuar për të drejtat dhe procedurat në fushë të antidiskriminimit (AP Rec. 8-10, 18-19)
- Të përvetësojë veprime gjithëpërfshirëse për të luftuar diskriminimin dhe për të kundërshtuar paragjykimet ndaj romëve, duke i futur çështjet e diskriminimit në strategji dhe projekte relevante (p.sh.: varfëria, arsimit) (AP Rec. 8, 36, 58, 61, 67, 73, 76, 110; MC.DEC 6/08)
- Të mbështesë bashkëpunimin mes policisë, përfaqësuesve të romëve dhe OJQ-ve që të ndërtohen ura komunikimi mes policisë dhe qytetarëve. Qëllimi duhet të jetë që policia ta ruajë rolin e saj si institucion që është në shërbim të qytetarëve (AP Rec. 26, 28, 30, 31)
- Të inkurajojë formimin dhe punësimin e gazetarëve romë në mënyrë që të nxitet pluralizmi dhe të kundërshtohen stereotipat në media (AP Rec. 37)
- Të theksohet përdorimi i mediave në gjuhën romë në mënyrë që nëpërmjet tyre të komunikohen informacione dhe të rritet vetëdija e romëve për çështje që kanë ndikimi mbi

ta (p.sh.: regjistrimi, antidiskriminimi, legjislacioni, mundësitë për fitimin e bursave, përdorimi i shërbimeve ) (AP Rec. 36, 61, 92)

Aktorët ndërkombëtarë rekomandohet:

- Ta inkurajojnë shtetin nikoqir që nëpërmjet deklaratave publike të rritë përpjekjet e tij për të zbatuar legjislacionin kundër diskriminimit
- Të mbikëqyrin, sidomos në fazën fillestare, zbatimin e legjislacionit kundër diskriminimit si dhe veprimtarinë e Komisionit, duke pasur si objektiv që shtetit nikoqir t'i japin ndihmën e duhur gjatë përpjekjeve për të tejkaluar dobësitë e mundshme që shfaqen në stadin e hershëm (AP Rec. 21-22)
- Të vazhdojnë dhe të zgjerojnë përfshirjen e tyre në veprimtari të suksesshme që rritin besimin mes policisë, bashkësive rome dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile. Inkurajohet një angazhim i vazhdueshëm i PDD-së së OSBE-së mbi diskutimet CAG-ve dhe LPC-ve (AP Rec. 33)
- Të forcojnë angazhimin e tyre gjatë trajnimit për etikën dhe të drejtat e njeriut dhe që lidhet me patrullimin e policisë si dhe të rritin angazhimin e tyre në ndërhyrjet te rastet e dhunës kundër popullatës rome
- Të kontribuojnë në rritjen e profesionalizimit dhe kapaciteteve të mediave në gjuhën rome, sidomos në redaksinë në gjuhën rome të televizionit publik RTVM, me qëllim që të rritet efikasiteti i saj për të tejçuar informacionet te popullata rome për çështje që e prekin atë (AP Rec. 42)

### Çështje socio-ekonomike

Shteti nikoqir rekomandohet:

- Të miratojë programe gjithëpërfshirëse që merren me çështje të ndërlidhura me banimin, punësimin, shëndetësinë dhe arsimin. Duhet të nxitet koordinimi dhe sinergjia mes aktorëve të përfshirë në çështjet si varfëria dhe përfshirja shoqërore. Shteti nikoqir duhet të fokusohet veçanërisht te bashkëpunimi mes aktorëve në këto fusha
  - Imunizimi dhe arsimimi
  - Sektori i shëndetësisë (nëna dhe fëmija) dhe regjistrimi/dhënia e dokumenteve për identifikim
  - Edukimi dhe punësimi
- Të forcojë kapacitetet e strehimoreve të të pastrehëve në Lubanci dhe Çiçino Sello dhe të zhvillojë programe merren në mënyrë adekuate me çështjet që i prekin përdoruesit (dhuna në familje, trafikimi i qenieve njerëzore, kriminaliteti, shëndetësia, edukimi etj.)
- Të kërkojë zgjidhje të qëndrueshme për çështje që lidhen ne kushtet poshtë standardeve të banesave dhe familjeve të pastreha (AP Rec. 43, 46)

- Të vazhdojë të promovojë parimet e përfaqësimit të drejtë në punësimet publike, duke bërë të mundur që të përfshihen edhe qytetarët romë që i plotësojnë kushtet (AP Rec. 46, 95)
- Të marrë parasysh mënyra që kur të krijohen programe/projekte punësimi, të synohen romët:
  - Të mund të hiqet dorë nga disa kushte (p.sh.: të kenë të mbaruar arsimin fillor) në rast se jehona për kurse trajnimi është tepër e vogël
  - Të krijojë fushata për të shpërndarë informacione mbi programet e punësimit dhe të rritë vetëdijen mbi çështjet e punësimit
  - Të zhvillojë projekte punësimi që synojnë të punësojnë gratë romë ose t'i përfshijnë ato në projektet kryesore për punësimin e grave (AP Rec. 51)
- Të zhvillojë veprimtari themelore për t'i përfshirë romët në projekte që merren me legalizimin e bizneseve në të zezë (AP Rec. 52)
- Të sigurojë që propozim-ligji për sigurimin shëndetësor i propozuar në nëntor 2010 të mos i prekë negativisht grupet më të rrezikuara, përfshirë këtu edhe romët (AP Rec. 58)
- Të sigurojë që të ndahen financime përkatëse për zbatimin e programeve kryesore në fushën e shëndetësisë në vitin 2011 ( p.sh.: medijuesit shëndetësor romë ) :
  - Të shqyrtohen në kohë mungesat në krijimin dhe zbatimin e programeve që sjellin mospërdorimin e fondeve, por edhe të fondeve tjera të ndërfutura në veprimtari tjera që janë të dobishme për romët (AP Rec. 61)
- Me ndihmën e aktorëve ndërkombëtarë, të krijojë baza të dhënash që të sigurohet mbikëqyrja dhe regjistrimi i gjendjes së imunizimit të qytetarëve
  - Ndërmjetësit romë do të duhet ta ndihmojnë Ministrinë e shëndetësisë që të mundësohet gjetja dhe vaksinimi i romëve, sidomos i fëmijëve romë. Një theks i veçantë duhet të vihet mbi fëmijët e rrugës, fëmijët pa dokumente dhe pa sigurim shëndetësor të cilët nuk janë të regjistruar nëpër shkolla

Aktorët ndërkombëtarë rekomandohet :

- Ta inkurajojnë shtetin nikoqir të miratojë qasje gjithëpërfshirëse për çështjet socio-ekonomike që prekin popullatën romë
- Ta inkurajojnë shtetin nikoqir të rritë angazhimin e tij për ngritjen e vetëdijes, si dhe për veprimtaritë themelore me qëllim që të krijohen kushte për një zbatim të suksesshëm të programeve që fokusohen tek përfshirja shoqëror
- Të inkurajojnë miratimin e propozim-ligjit për legalizimin e ndërtimeve pa leje, i cili duhet të përfshijë masa përkatëse që do të merren për çështjen e vendbanimeve romë
- Të rritin kapacitetet e komunave që të konkurrojnë dhe të menaxhojnë projektet nga të cilat do të përfitojnë bashkësitë romë
- Të vazhdojnë të ndihmojnë shtetin nikoqir në zbatimin e ndërmarrjeve të OFA-s të cilat merren me përfaqësimin e drejtë në administratën publike

## Edukimi

Shteti nikoqir rekomandohet:

- Të zhvillojë masa gjithëpërfshirëse por reale, për të përmirësuar qasjen e fëmijëve romë në të gjitha nivelet e arsimit dhe edukimit, duke pasur gjithnjë ndërmend përmasën socio-ekonomike që ka mundësia e edukimit dhe arsimit (AP Rec. 77)
- Të njohë gjendjen e tanishme në të cilën ndodhet arsimimi i fëmijëve romë i cili karakterizohet me një numër të madh fëmijësh që nuk shkojnë në shkollë dhe/ose që braktisin shkollën, dhe të zhvillojë programe gjithëpërfshirëse që trajtojnë këtë çështje me prioritet duke i përfshirë të gjithë aktorët e rëndësishëm vendorë dhe ndërkombëtar (AP Rec. 69, 75, 77, 80)
- Të miratojë masa që do të rritin numrin e fëmijëve romë që vazhdojnë shkollën dhe të zvogëlojnë numrin e atyre që braktisin shkollën në të gjitha nivelet e arsimit-edukimit formal, duke mos anashkaluar as vitet e fundit të arsimit fillor (AP Rec. 69, 75, 77, 80)
- Të trajtojë një strategji gjithëpërfshirëse dhe urgjente që merret me çështjen e fëmijëve në rrugë
  - Të rritë kapacitetet e qendrave të kujdesit ditor, të cilat duhet të përfshijnë punonjës social profesional dhe ndërmjetës romë me orar dhe angazhim të plotë; të zhvillojë programe që integrojnë fëmijët në arsimimin formal dhe të kujdeset që ta vazhdojnë atë; t'i trajtojë të gjitha çështjet shoqërore, arsimuese, psikologjike dhe shëndetësore me të cilat përballen këta fëmijë
  - Të krijojë qasje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme që do të pengojnë këtë dukuri dhe pasoja e saj, duke bërë fushata përkatëse edukuese mes prindërve, fëmijëve dhe të gjitha institucioneve shtetërore, (AP Rec. 75, 77, 78)
- Të rishqyrtojë mekanizmat e Komisionit përgjegjës për përcaktimin e transferimit të fëmijëve nëpër shkolla dhe klasa për fëmijët me nevoja speciale edukimi
  - Përfshirja e mësuesve, pedagogëve ose punonjësve socialë romë që do të garantojë një përcaktim sa më të saktë të nevojave reale të fëmijës për edukim
  - Duhet të futet një mekanizëm për riezaminimin e nevojave speciale për edukim të fëmijës. Përdorimi i mekanizmave të tillë duhet të jetë i rregullt duke pasur gjithnjë parasysh riintegrimin e fëmijës në procesin e arsimit të rregullt nëse nuk ka më nevojë për lehtësira edukuese speciale (AP Rec. 67, 73)
- Të sistematizojë ndihmën gjuhësore për fëmijët romë në klasën e parë të shkollës fillore (AP Rec. 75-76)
- Të vazhdojë të fokusohet në edukimin parashkollor duke u angazhuar në gjithë territorin e vendit (AP Rec. 75; MC.DEC 6/08 and 8/09)
- Të përmirësojë zbatimin në kohë të programeve të veta (mungesa e bashkërenditjes në disa komuna, vonesat administrative etj) (AP Rec. 75, 84)
- Të bashkërendojë programet e veta me OJQ-t dhe donatorët që të shmangët mundi i dyfishtë, që të identifikohen të gjithë bamirësit e mundshëm dhe të ndajnë mes veti dijet dhe praktikat më të mira
  - Krijimi i një mekanizmi që të informohen dhe të evidentohen pjesëmarrës tjerë mbi veprimtaritë dhe rezultatet e tyre. Mbajtja nga Drejtorati e një mbledhjeje bashkërenduese periodike mund të jetë një zgjidhje përkatëse
- Të forcojë kapacitetin dhe autoritetin e Drejtoratit, i cili mund të kryejë funksione bashkërenduese, mbikëqyrëse dhe këshilluese për edukimi shumëkulturore

- Të përfshijë përfaqësues romë në këshilltarët e Njësisë gjuhësore brenda Drejtoratit, në ZZHA dhe në Inspektoratin shtetëror të arsimit (AP Rec. 68)
- Të miratojë veprime vendimtare që synojnë përmirësimin e edukimit për multikulturalizëm, duke i detyruar mësuesit që të promovojnë respekt të ndërsjellë dhe të trajtojnë në klasë episode diskriminimi, segregimi dhe stereotipizimi (AP Rec. 71, 75)
- Të fokusohet në zhvillimin e arsimit të integruar në sistemin arsimor
  - Të përfshijë në planet mësimore të detyrueshme për të gjithë elemente nga planet mësimore zgjedhore, sidomos nga kultura e bashkësisë dhe tema të lidhura me historinë, ndërsa studimet e gjera mbi këto tema dhe komponentin gjuhësor t'i lërë si lëndë zgjedhore (AP Rec. 71)
- T'i nxitë të diplomuarit romë të punojnë si mësues, ndërsa mësuesit që punojnë t'i nxitë të përdorin teknika të reja mësimi (AP Rec. 75)

Aktorët ndërkombëtarë rekomandohen:

- Të inkurajojnë shtetin nikoqir që nëpërmjet deklaratave publike dhe këshillimit programor, të zhvillojë një edukim shumëkulturore të vërtetë, i cili i kushton një vëmendje më të madhe tek të kuptuarit të ndërsjellë, të drejtave të njeriut dhe anëve pozitive të përbërjes shumetnike të vendit
- Të inkurajojnë shtetin nikoqir që të përmirësojë menaxhimin dhe zbatimin në kohë të programeve dhe angazhimeve të tij
- T'u bëjnë të qasshme dijet e tyre institucioneve relevante që janë të përfshira në sektorin edukativ të shtetit nikoqir (AP Rec. 86)
- Të vazhdojnë angazhimin e tyre me veprimtaritë stërvitëse të mësuesve përpara se të fillojnë punën nëpër shkolla
- Të mbështetin shtetin nikoqir gjatë mbledhjes, furnizimit dhe mbikëqyrjes së të dhënave për edukimin sipas përkatësisë etnike

Pjesëmarrja në jetën publike dhe politike

Shteti nikoqir rekomandohet:

- Të jetë proaktiv gjatë regjistrimit dhe dhënies së dokumenteve personale të popullatës rome
  - Regjistrimi i popullsisë i vitit 2011 mund të jetë një mundësi e mirë për të ngritur vetëdijen për regjistrimin mes popullatës rome dhe për të identifikuar ata që nuk kanë dokumente
  - Rekomandimet e dhëna nga grupi punues i multi-agjencisë për parandalimin dhe zgjidhjen e rasteve pa letërnjoftim (p.sh.: heqja e taksave dhe gjobave, roli i institucioneve) duhet të merren parasysh pa asnjë ngurrim dhe vonesë (AP Rec. 87)
- Të zbatojë rregullat që parandalojnë praktikën e jashtëligjshme gjatë zgjedhjeve, si gjatë fushatës ashtu edhe në vendet e votimit (AP Rec. 92-94)

- Të inkurajojë një ambient dhe klimë bashkëpunimi mes përfaqësuesve politike të ndryshme në të gjitha nivelet qeverisëse (AP Rec. 88, 90-91)
- Të rritë bashkërenditjen mes niveleve qeverisëse vendore (lokale) dhe kombëtare, duke zhvilluar strategji të integruara të cilat i përkufizojnë qartazi prioritetet afatshkurtra, financimin dhe përgjegjësitë e secilit nga aktorët në politikat socio-ekonomike që prekin popullatën romë. (AP Rec. 88, 91)
- Të inkurajojë dialogun mes komisioneve ndëretnike komunale, duke pasur parasysh prioritetet dhe brengat e bashkësive të cilat janë të përfaqësuara pamjaftueshëm nëpër këshillat komunal (AP Rec. 88)
- Të përshtijë OJQ-ët që janë aktive në nivelet vendore në këshillimet e rregullta, në nxitjen e shkëmbimit të praktikave të mira dhe sidomos në vënien në shënjestër të përfaqësimit bashkësive të ndryshme romë brenda shtetit (AP Rec. 88, 89, 91)

Aktorët ndërkombëtarë rekomandohen:

- Të inkurajojnë shtetin nikoqir të miratojë një strategji proaktive që popullatës romë t'i jepen dokumentet personale (AP Rec. 99)
- Në bashkërenditje me të gjithë aktorët relevantë, të vazhdojnë dhe të rritin përpjekjet e tyre gjatë vëzhgimit të zgjedhjeve, duke mundësuar që fushata të jetë e drejtë dhe transparente (AP Rec. 103)
- Të forcojnë veprimtaritë për edukimin e votuesve duke u kujdesur që popullata romë të jetë e vetëdijshme për dobitë afatgjata që kanë zgjedhjet e lira dhe të drejta për fuqizimin e bashkësisë së tyre (AP Rec. 101)
- Të shtojnë veprimtaritë që synojnë ndërtimin e kapaciteteve të partive politike romë si dhe të partive etnike tjera që mund të kenë nevojë për ndihmë duke iu mundësuar pjesëmarrje efektive gjatë vendimmarrjes dhe duke respektuar parimet demokratike të cilat ua transmetojnë popullatës së vet (AP Rec. 105)
- Të nxitin dialogun mes përfaqësuesve romë të përkatësive politike dhe ndasive personale të ndryshme, duke e theksuar karakterin institucional të pozitës që bartin
  - Veprimtaritë për ndërtimin e kapaciteteve, të ngjashme me trajnimet e OSBE-së dhe NDI-së të mbajtura në të kaluarën, mund të jenë ngjarje përkatëse për të ndërtuar ura dhe ballafaqime paqësore mes përfaqësuesve të zgjedhur romë

Romët në krizë dhe në situata pas krizash- refugjatët

Shteti nikoqir rekomandohet:

- Të marrë përsipër përgjegjësi akoma të mëdha për t'u marrë me refugjatët dhe të zhvendosurit e përkohshëm, duke mësuar nga përvojat e UNHCR-së dhe duke vënë theksin mbi gjetjen e qasjeve të qëndrueshme të kësaj çështjeje edhe për të ardhmen (AP Rec. 109, 112)
- Të zotohet që personave romë nga Kosova t'i ofrojë të njëjtin nivel të shërbimeve që iu ka ofruar deri tash UNHCR-ja
- Të bashkëpunojë me UNHCR-në dhe aktorët tjerë relevantë për dhënien e statusit dhe të dokumenteve përkatëse të personave romë të zhvendosur (AP Rec. 107)

- Të forcojë bashkëpunimin me shtetet tjera të rajonit dhe, nëse lind nevoja, të kërkojë ndihmën e ODIHR-it dhe aktorëve tjerë, që të inkurajojë shtetet fqinje që të kujdesen për kthimin e sigurt të refugjatëve si dhe gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme për çështjen e refugjatëve romë nga Kosova (AP Rec. 109)

Aktorët ndërkombëtarë rekomandohen:

- Të inkurajojnë dhe të koordinojnë qasjet rajonale që të krijohen zgjidhje afatgjata dhe të qëndrueshme për çështjen e romëve refugjatë nga Kosova, dhe jo vetëm kthimin e tyre të sigurt (AP Rec. 114, 116)



## Referencat:

Kushtetuta e Republikës së Maqedonia, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 52/91

Regjistrimi i popullsisë në Republikën e Maqedonisë, viti 2002, në dispozicion në:  
[http://www.stat.gov.mk/english/glavna\\_eng.asp?br=18](http://www.stat.gov.mk/english/glavna_eng.asp?br=18)

Këshilli i Evropës, të dhëna të disponueshme në:  
[http://www.coe.int/t/dg3/romatravellers/archive/documentation/strategies/statistiques\\_en.asp](http://www.coe.int/t/dg3/romatravellers/archive/documentation/strategies/statistiques_en.asp)

UNHCR, Konventa ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor, në dispozicion në: <http://www2.ohchr.org/english/law/cerd.htm>

Ligji për antidiskriminim i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 50/2010

Ligji mbi ndryshimet dhe plotësimet e Kodit penal të Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare nr. 114/2009

UN OHCHR (2007), Observime përfundimtare – Shqyrtim i Raporteve të paraqitura nga palët-shtete sipas Nenit 7 të Konventës: Republika Ish-Jugosllave e Maqedonisë, CERD/C/MKD/CO/7.

Gjykata evropiane për të drejtat e njeriut, rasti JASAR v. THE FORMER YUGOSLAV REPUBLIC OF MACEDONIA (Application no. 69908/01); rasti ULEJMANOV v. THE FORMER YUGOSLAV REPUBLIC OF MACEDONIA (Application no. 69875/01); rasti DZELADINOV AND OTHERS v. THE FORMER YUGOSLAV REPUBLIC OF MACEDONIA  
[http://www.coe.int/t/DGHL/Monitoring/Execution/Themes/Roms/Roma\\_en.asp](http://www.coe.int/t/DGHL/Monitoring/Execution/Themes/Roms/Roma_en.asp)

Roma Rights Forum Arka (2010), Roma Monitor – Situata e të drejtave të romëve në Maqedoni 2009-2010, <http://www.arka.org.mk/Final%20Raport%20print%20form.pdf>

OSCE, Community Policing Survey 2010.

Ministria e punës dhe politikës sociale (2005), “Strategjia për romët në Republikën e Maqedonisë”, në dispozicion në: [http://www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/strategjia\\_romi.pdf](http://www.mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/strategjia_romi.pdf)

Instituti shoqëria e hapur (2010), “S’ka date – S’ka progres, Mbledhja e të dhënave në shtetet që participojnë në Dekadën e përfshirjes së romëve 2005-2015”, në dispozicion në:  
[http://www.edumigrom.eu/sites/default/files/field\\_attachment/news/node-17841/OSI\\_No-data-no-progress-country-reports\\_2010.pdf](http://www.edumigrom.eu/sites/default/files/field_attachment/news/node-17841/OSI_No-data-no-progress-country-reports_2010.pdf)

Komisioni i komuniteteve evropiane (2009), Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Raporti i Progresit 2009, në dispozicion në:  
[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2009/mk\\_rapport\\_2009\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2009/mk_rapport_2009_en.pdf)

Departamenti i Shtetit (2010), Raporti i të drejtave njerëzore 2009: Maqedonia. Në dispozicion në:  
<http://www.state.gov/g/drl/rls/hrrpt/2009/eur/136044.htm>

Avokati i popullit të Republikës së Maqedonisë (2009), Raporti vjetor 2009, në dispozicion në:  
[http://www.ombudsman.mk/comp\\_includes/webdata/documents/Annual%20Report-2009.pdf](http://www.ombudsman.mk/comp_includes/webdata/documents/Annual%20Report-2009.pdf)

Komisioni Evropian (2010), Raporti mbi progresin e Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë. Në dispozicion në:  
[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2010/package/mk\\_rapport\\_2010\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2010/package/mk_rapport_2010_en.pdf)

Iniciativat rome-Instituti shoqëria e hapur (210), Rrugët drejt Progresit? Unioni Evropian dhe përfshirja e romëve në Ballkanin perëndimor. Në dispozicion në:  
<http://pdc.ceu.hu/archive/00006297/01/pathways-progress-20100402.pdf>

Instituti shoqëria e hapur (2007), Programi i BE-së për mbikqyrje dhe përkrahje

Agjencioni për nëpunës shtetëror në Republikën e Maqedonisë, informata të disponueshme në:  
[www.avrm.gov.mk](http://www.avrm.gov.mk)

Avokati i popullit të Republikës së Maqedonisë (2010), Studim mbi implementimin e rekomandimeve për përfaqësim të drejtë dhe adekuat dhe mbi diskriminimin.

UNICEF and State Statistical Office (2007), Multiple Indicator Cluster Survey 2005-2006.  
Available at: [http://www.childinfo.org/files/MICS3\\_Macedonia\\_FinalReport\\_2005\\_Eng.pdf](http://www.childinfo.org/files/MICS3_Macedonia_FinalReport_2005_Eng.pdf)

Ministria për arsim dhe shkencë, Drejtorati për zhvillimin dhe promovimin e arsimit në gjuhët e bashkësive (2010), Gjendja aktuale në arsimin fillor e nxënësve që iu përkasin bashkësive etnike në Republikën e Maqedonisë.

Ministria për arsim dhe shkencë (2009), Hapa drejt arsimit të integruar në arsim në Republikën e Maqedonisë.

OBSE, Moshë, Kontakti, Perceptimet: Si shkollat ndërtojnë marrëdhëniet mes bashkësive. Në dispozicion në: [http://www.osce.org/skopje/item\\_11\\_42650.html](http://www.osce.org/skopje/item_11_42650.html)

Donald Bisson (2010), Vlerësimi i kapacitetit të Qendrave informative rome për të ofruar ndihmë juridike falas për komunitetin rom

UNICEF (2009), Multikulturalizmi dhe marrëdhëniet ndëretnike në arsim. Në dispozicion në:  
[http://www.unicef.org/tfyrmaqedonia/Study\\_ENGsm.pdf](http://www.unicef.org/tfyrmaqedonia/Study_ENGsm.pdf)

UNICEF, Fëmijët romë – Studim për barrierat në arritjen deri te arsimit në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Në dispozicion në: [http://www.unicef.org/ceecis/Roma\\_Children.pdf](http://www.unicef.org/ceecis/Roma_Children.pdf)

Fondacioni instituti shoqëria e hapur Maqedoni (2010), Analizë e implementimit të gjuhës dhe kulturës rome si lëndë zgjedhore. Në dispozicion në:  
<http://soros.org.mk/dokumenti/FIOOM-Jazik-i-kultura-na-Romite-ANG.pdf>

National Roma Centrum (2010), Doracak për preventimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi në sistemin arsimor në Republikën e Maqedonisë

Fondi rom për arsim (2007), Avansimi i arsimit të romëve në Maqedoni – Vlerësim i shtetit dhe drejtimit strategjike të fondit rom për arsim. Në dispozicion në:  
[http://www.romaeducationfund.hu/documents/Macedonia\\_report.pdf](http://www.romaeducationfund.hu/documents/Macedonia_report.pdf)

Joanna Laursen Brucker, Fëmijët romë – Studim i barrierave në arritjen deri te arsimit në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë (UNICEF Paper Series, “Out of school children in Central and Eastern Europe and the Commonwealth of Independent States”)

Këshilli i Evropës, Romët dhe udhëtarët. Në dispozicion në:  
[http://www.coe.int/t/dg3/romatravellers/archive/documentation/strategies/statistiques\\_en.asp](http://www.coe.int/t/dg3/romatravellers/archive/documentation/strategies/statistiques_en.asp)

Komisioni qendror zgjedhor, informata të disponueshme në [www.sec.mk](http://www.sec.mk)

UNDP (2006), Raporti kombëtar mbi grupet e prekshme në Maqedoni

OSCE/ODIHR (2008), Misioni ndërkombëtar për mbikqyrjen e zgjedhjeve, Zgjedhjet e parakohshme parlamentare – FYROM, Qëndrim mbi të zbulimet preliminare dhe konkluzione

Instituti për ndryshim social (2010), MK Decade Watch 2010. Në dispozicion në:  
[http://www.insoc.org.mk/publications/DW\\_MK\\_2010\\_EN\\_1.pdf](http://www.insoc.org.mk/publications/DW_MK_2010_EN_1.pdf)

Ministria e punës dhe politikës sociale, Sektori për mundësi të barabarta dhe UNIFEM (2000), Edhe nëse ankoem, nuk do të ketë efekt!

Heidrun Ferrari dhe Samia Liaquat Ali Kahn (2010), Asistenca financiare e BE-së në Ballkanin Perëndimor: Shqyrtim i CARDS dhe IPA me fokus në pakicat, Minority Rights Group International

Bulgaria-FYROM IPA Programi për bashkëpunim ndërkufitar 2007-2013. Në dispozicion në:  
<http://europa.eu/rapid/pressReleasesAction.do?reference=MEMO/09/38&format=HTML&aged=0&language=EN&guiLanguage=en>. (Accessed on 18 December 2010).

## Giorgia Demarchi

Pas diplomimit në Marrëdhënie ndërkombëtare dhe histori në Shkollën për Ekonomi dhe Shkenca Politike në Londër (2003-2006), ku edhe thelloi interesin e saj në historinë dhe politikën e Evropës Juglindore, Giorgia Demarchia ndërmorri një trajnim në Delegacionin e Komisionit Evropian në OSBE në Vjenë. Atje, ajo u njohua me strukturat dhe politikat e marrëdhënieve të jashtme të BE-së, misionin dhe punën e OSBE-së dhe çështjet e demokratizimit dhe të drejtat e njeriut, veçanërisht në Ballkan. Qëndrimi i saj në Kosovë ku iu bashkangjiti një grupi ekspertësh (*think tank*) për një projekt velëruës afatshkurtër për grupet e prekshme (gratë dhe bashkësitë rurale) ishte një hap i ardhshëm para hyrjes në hulumtime të mëtejshme akademike.

Ajo pastaj u kthye në Mbretërinë e Bashkuar ku magjistroi në Studime Ruse dhe të Evropës Lindore me fokus në Evropën Juglindore, në Universitetin e Oksfordit (St Antony's College, 2009). Tezat mbi çështjen e statusit të Kosovës dhe dispozitat që kanë të bëjnë me të drejtat e pakicave, së bashku me hulumtimin mbi zgjerimin e BE-së në Ballkanin Perëndimor, përforcuan kompetencat e saja në analizë politike lidhur me sferën gjeografike, si dhe njohuritë për gjuhët lokale. Kjo bëri që ajo fillimisht t'i bashkangjitet Institutit për marrëdhënie ndërkombëtare në Zagreb si analist-vizitor dhe më pastaj të botojë artikull akademik në një botim të BE-së lidhur me pranimin e Kroacisë në BE (dhjetor 2010).

Në Misionin e OSBE-së në Shkup, detyra e saj e parë kishte të bëjë me çështjet rome, gjatë së cilës ajo tërhoqi kuptim solid të gjendjes sociale dhe politike në rajon, si dhe në hulumtim dhe aftësi analitike të fituara në arsimin dhe punët e saja të mëparshme.